



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
K R Y E T A R I

Adresa: Rruga Rruga "Abdi Toptani" Nr. 1 Tiranë. E-mail: klsh.org.al; www-site:www.klsh.org.al

Nr. 1005 / __Prot.

Tiranë, më 19.12.2018

V E N D I M

Nr. 211, Datë 19/12/2018

P Ë R

AUDITIMIN E USHTRUAR NË 21 SUBJEKTE TË AUDITUARA PËR VERIFIKIMIN E ZBATIMIT TË REKOMANDIMEVE TË LËNA NË AUDITIMET E USHTRUARA NË TREMUJORIN E IV-T TË VITIT 2017, NGA DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË NJËSIVE TË VETËQEVERISJES VENDORE, RESPEKTIVISHT NË BASHKITË: SHKODËR, KUKËS, KUKËS (ish Komunat), DROPULL, FINIQ, ROSKOVEC, KRUIË, KRUIË (ish komunat), DURRËS, DURRËS (Auditim Financiar), DURRËS (ish Komunat), DIVJAKË, DELVINË, VLORË (Auditim Financiar), NË INSTITUCIONIN E PREFEKTIT TË QARKUT DURRËS, VLORË, ELBASAN DHE NË AGJENCINË E PARQEVE DHE REKREACIONEVE, DREJTORIA NR. 1 E PUNËTORËVE TË QYTETIT TIRANË DHE 2 SUBJEKTE TË EVADUARA NË VITIN 2018 BASHKIA FIER DHE VLORË”

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, mendimin për cilësinë e auditimit nga Drejtori i Drejtorisë së Standardeve dhe Sigurimit të Cilësisë, vlerësimin mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të Auditimit të mësipërm dhe Drejtori i Përgjithshëm, në mbështetje të neneve 10, 15 dhe 30, të ligjit 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”,

V E N D O S A:

I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit “*Mbi Verifikimin e zbatimit të detyrave dhe masave të rekomanduara në auditimin e kryer në Tremujorin e IV të vitit 2017*”, të ushtruar në 21 Subjekte, respektivisht Bashkitë: **Shkodër, Kukës, Kukës (Ish Komunat), Dropull, Finiq, Roskovec, Krujë, Krujë (Ish Komunat), Durrës, Durrës (Auditim Financiar), Durrës (Ish Komunat), Divjakë, Delvinë, Vlorë (Auditim Financiar), në Institucionin e Prefektit të Qarkut Durrës, Vlorë, Elbasan Dhe në Agjencinë e Parqeve dhe Rekreacioneve, Drejtoria Nr. 1 e Punëtorëve të Qytetit Tiranë dhe 2 subjekte të Evaduara në Vitin 2018 Bashkia Fier dhe Vlorë**, sipas programit të auditimit Nr. 1005 Prot., datë 01.09.2018, të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit.

II. Të miratoj rekomandimet e përcaktuara dhe të kërkoj marrjen e masave, për sa vijon:

a-Mbi kthimin e përgjigjes të zbatimit të rekomandimeve të KLSH brenda afatit 20 ditor, hartimi i Plan veprimeve (programeve) të punës dhe raportimi në KLSH mbi ecurinë e zbatimit rekomandimeve brenda afatit 6 mujor.

Nga 21 subjektet e verifikuara, në përgjithësi Subjektet kanë kthyer përgjigje KLSH-së, brenda afatit ligjor prej 20 ditëve, duke hartuar edhe planet e veprimit (programet e punës), por vetëm 5 subjekte Bashkia Durrës, Bashkia Durrës (ish komunat), Bashkia Durrës (Auditim Financiar), Bashkia Dropull dhe Krujë, kanë raportuar në KLSH me shkrim mbi ecurinë e zbatimit rekomandimeve brenda afatit 6 mujor, në kundërshtim me pikën 2, neni 30 i ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, ku përcaktohet se: “Subjekti i audituar, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, i raporton Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna”.

b-Mbi raportimin rregullisht në Këshillin Bashkiak të ecurisë të zbatimit të rekomandimeve të KLSH, siç përcaktohet në nenin 50 -Auditimi i jashtëm, pika 5, të ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”.

Nga verifikimi rezultoi se nga subjektet e audituara, detyrimin për të raportuar në Këshillin Bashkiak nuk e kanë zbatuar Bashkitë: **Shkodër, Kukës, Finiq, Durrës dhe Bashkia Vlorë**. Nuk është raportuar rregullisht në këshillin e njësisë (këshillin Bashkiak), kundërshtim me ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Neni 50-Auditimi i jashtëm ku përcaktohet se: 5. *Për të gjitha raportet e auditimit të jashtëm, të kryera nga Kontrolli i Lartë i Shtetit apo auditues të tjerë ligjorë, kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore përgatit një plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve të raportit të auditimit dhe raporton rregullisht në këshillin e njësisë.*

Realizimi i zbatimit të rekomandimeve sipas llojit të tyre paraqitet si më poshtë:

A. MASA ORGANIZATIVE:

Nga auditimi i realizuar në 21 subjektet e verifikuara për zbatimin e detyrave dhe masave të rekomanduara në auditimin e kryer në Tremujorin e IV të vitit 2017 rezultoi një nivel i pranueshëm zbatueshmërie në **masën 100%, nga 301 masa organizative** të rekomanduara janë pranuar të **301** masat. Nga masat e pranuar janë zbatuar plotësisht 138 masa ose në masën 46 %, nuk janë zbatuar 32 masa në masën 11 %, ndërsa 131 masa në masën 43 % janë në proces zbatimi, pra në një total prej 301 masash organizative. Subjektet të cilat nuk kanë zbatuar masat organizative të rekomanduara nga KLSH përmendim: *Bashkia Finiq 8 masa, Prefektura Durrës 5 masa, Prefektura Vlorë 5 masa organizative, etj.*

(Në mënyrë të detajuar realizimi i masave organizative paraqitet ne Aneksin nr. 1, bashkëlidhur këtij Vendimi)

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI:

Në 21 subjektet e audituara për zbatimin e detyrave dhe masave të rekomanduara në auditimin e kryer në Tremujorin e IV të vitit 2017, konstatohet se nga vlera e rekomanduar për 153 masa shpërblim dëmi prej **330,370 mijë lekë** të cilat janë pranuar në masën 78% prej tyre janë në proces gjyqësor apo kanë dalë urdhrat e ekzekutimit, pra janë në proces zbatimi 80 masa në vlerën **170,282 mijë lekë**, në masën 52 %, duke mos u pranuar apo pa mundësi arkëtimi 70 masa shpërblim dëmi në vlerën prej **147,938 mijë lekë, respektivisht:**

-**vlera prej 23,013 mijë lekë** i përket Bashkisë Durrës për ish komunat nga e cila vlera prej **16,031 mijë lekë**, rekomandime të cilat përfaqësojnë mos zbatimin e procedurave për arkëtimin e detyrimit të qerasë së plazheve dhe pjesa tjetër me detyrimin për mosrealizim punimesh të shoqërisë “V [REDAKTUAR]” Shpk.

-**vlera prej 42,419,059 lekë**, i përket Bashkisë Kukës, rekomandime të cilat përfaqësojnë shkeljet në 12 procedura prokurimi me dëm ekonomik, të cilat Bashkia Kukës nuk i ka pranuar me arsyetimin se shkeljet i janë referuar Prokurorisë të Rrethit Gjyqësor Kukës.

- **vlera 13,968 mijë lekë**, i përket Bashkisë Kukës për ish komunat, vlerë e cila përfaqëson detyrimin e ngarkuar antarëve të KVO me dëm ekonomik në pjesën më të madhe, vlera prej 4,187 mijë lekë i përket pagesave për udhëtime dieta për punonjësit e administratës dhe Kryetarëve në ish/Komunat për të cilat janë njoftuar personat por nuk është kryer asnjë arkëtim i kësaj shume.

- **vlera 11,279 mijë lekë**, i përket Bashkisë Finiq, vlerë prej 7,399 mijë lekë e cila përfaqëson detyrimin e ngarkuar BOE "M [REDAKTUAR] "A [REDAKTUAR]" shpk për vonesa në realizimin e punimeve, vlera prej 2,619 mijë lekë i përket detyrimit të qerasë ndaj shoqërive “V [REDAKTUAR]” dhe “Pl [REDAKTUAR]” etj.

(Në mënyrë të detajuar realizimi i masave për shpërblim dëmi paraqitet në Aneksin nr. 1, bashkëlidhur këtij Vendimi)

C.MASAT DISIPLINORE DHE ADMINISTRATIVE

Në 21 subjektet e verifikuara për zbatim të rekomandimeve nga KLSH janë rekomanduar masa administrative apo masa për fillimin e procedurave disiplinore për **328 masa, nga të cilat** nuk ka masa të papranuara, duke u pranuar **328 masa** të cilat janë shqyrtuar në komisionet disiplinore apo APP dhe prej tyre janë zbatuar **280 masa** ose në nivelin **85 %**, duke mos u zbatuar **48 masa** ose në nivelin **15 %**, prej tyre rreth 18 masa i përkasin Bashkisë Finiq.

(Në mënyrë të detajuar realizimi i masave disiplinore dhe administrative paraqitet në Aneksin nr. 1, bashkëlidhur këtij Vendimi)

Ndërsa realizimi i rekomandimeve për secilin nga 21 subjektet në mënyrë të detajuar paraqitet si më poshtë:

1.BASHKIA SHKODËR:

- Nga verifikimi rezulton se KLSH ka dërguar në Bashkinë Shkodër rekomandimet e auditimit me shkresën e saj nr 491/15, datë 30.11. 2017, protokolluar në Bashkinë Shkodër me nr. 7802/109, datë 04.12.2017, ndërsa nga Bashkia Shkodër për zbatimin e rekomandimeve të KLSH është kthyer përgjigje me shkresën e saj nr.7802/110, datë 21.12.2017, protokolluar në KLSH me shkresën nr. 491/16, datë 26.12.2017.

- Nga verifikimi rezulton se përfundimet e auditimit i janë dërguar subjektit të audituar Bashkisë Shkodër, me shkresën e Kryetarit të KLSH nr. 491/15, datë 30.11. 2017, dhe duhet të raportonte në KLSH brenda 6 muajve ose brenda datës 30.05.2018. Bashkia Shkodër me shkresën nr. 10633, datë 03.07.2018 “Raportim mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga raporti përfundimtar për auditimin e rregullshmërisë dhe përputhshmërisë”, ka raportuar pranë KLSH-së për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së, pra ka raportuar me 1 muaj vonesë.

A. MASA ORGANIZATIVE:

Nga KLSH i janë rekomanduar Bashkisë Shkodër 34 masa organizative, janë zbatuar plotësisht 12 masa, janë në proces zbatimi 21 masa dhe nuk është zbatuar 1 masë organizative për të cilën rikërkojmë zbatimin e masës si vijon:

1.7. Gjetje nga auditimi: Në Bashkinë Shkodër dhe në ish Komunat nuk është mbajtur në rregull protokollin i mbledhjeve të Këshillit duke mos evidentuar saktësisht prezencën e këshilltarëve

ndërkohë që listë prezenca për pagesat e ish këshilltarëve është nënshkruar rregullisht në çdo muaj nga Sekretari dhe Kryetari i Këshillit pa mungesa duke u paguar në mënyrë jo mirë të dokumentuar vlera prej **9,255,291 lekë**. Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me nenin 37 pika 2 germa “a” dhe nenin 29 e 31 të ligjit nr.8652 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” (Trajtuar hollësisht në faqet nr. 24-28 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.7.1 Rekomandim: Njësia e Auditimit të Brendshëm në Bashkinë Shkodër, në bazë të një programi tematik auditimi të miratuar nga Titullari i Bashkisë, të verifikojë të gjithë dokumentacionin mbi të cilin është bërë pagesa e këtyre këshilltarëve. Pas verifikimit dhe saktësimin të këtyre pagesave, **i lihet në kompetencë Kryetarit të Bashkisë**, të përcaktojë masat përkatëse në lidhje me vlerën e dëmit që duhet të kthejnë në buxhet këshilltarët.

Detyrimi për mos llogaritjen e tatimit mbi pagë duhet të paguhet, pasi rrjedh nga kërkesat e kreut II-të, neni 8 “E ardhur e tatueshme” shkronja “g”, neni 33 “Mbajtja në burim e tatimit mbi të ardhurat”, të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar me ligjin nr. 83/2014 datë 17.07.2014 dhe 156/2014 datë 27.11.2014.

Menjëherë

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI:

Nga verifikimi rezultoi se nga vlera e rekomanduar nga KLSH prej..... **12,638,793 lekë**
-Deri më datën 30.09.2018 janë arkëtuar**4,279,224 lekë**
Kanë mbetur pa u arkëtuar vlera prej..... **8,359,569 lekë**

Nga të cilat:

-Në proces arkëtimi 2 rekomandime në vlerën.....**248,564 lekë**
-Në proces gjyqësor 5 rekomandime në vlerën.....**8,111,005 lekë**

Në mënyrë tabelore rekomandimet,arkëtimet dhe natyra e rasteve të mos realizimit paraqiten në pasqyrën e mëposhtme:

Në mënyrë të detajuar masat shpërblim dëmi rikërkojmë si më poshtë:

1.1. Gjetje nga auditimi: Në ish Komunën Guri i Zi Shkodër nga auditimi i njëpasnjëshëm i dokumentacionit të veprimeve të kryera me arkë, u konstatua se në disa raste mandat arkëtimet e të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore nuk janë regjistruar e azhurnuar sistematikisht në librin e arkës dhe në regjistrin e të ardhurave vendore.

Gjatë auditimit nga burime të ndryshme grupi i auditimit administroi si provë materiale 8 (tetë) kopje të mandat arkëtimeve të vulosura me vulën e ish Komunës Guri i Zi Shkodër nga të ardhurat vendore në vlerën **80,060 lekë** gjithsej dhe 2 (dy) vërtetime për shlyerje të detyrimeve të biznesit të lëshuara nga ish titullari i Komunës Guri i Zi, z. M. [] L. [] të cilat nuk janë pasqyruar në librin dhe ditarin e arkës, në kontabilitet dhe në likuidimin e detyrimeve përkatëse të tetë personave. Veprimet e mësipërme në administrimin dhe dokumentimin e vlerave monetare, janë abuzive të shkaktuara me qëllim përfitimi dhe bien në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, neni 12 pika 3, neni 16 pika 2 dhe neni 23 pika 5 të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe Kreu IV pika 80 të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” dhe ngarkojnë me përgjegjësi z. M. [] L. [], me detyrë ish Kryetar i Komunës Guri i Zi, zj. A. [] M. [] me detyrë ish përgjegjëse e sektorit të financës dhe z. V. [] M. [] me detyrë ish specialist finance, arkëtar (Trajtuar hollësisht në faqet nr. 40-41 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1.1 Rekomandim: Bashkia Shkodër të marrë masa për arkëtimin e vlerës **80,060 lekë** si arkëtime të ardhura vendore të pa evidentuara për llogari të debitorëve, nga ish Kryetari i Komunës Guri i Zi Shkodër z. M. [] L. [] në vlerën 26,687 lekë, ish përgjegjësi i financës zj. A. [] M. [] në vlerën 26,687 lekë dhe ish arkëtar V. [] M. [] në vlerën 26,687 lekë.

Menjëherë

2.2. Gjetje nga auditimi: Në objektin “*Blloku i pallateve Vau i Dejës*” Shkodër, nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të punimeve të ndërtimit të administruara në dosjen teknike rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në vlerën **4,442,862 lekë pa t.v.sh** si pasojë e likuidimit të punimeve të kryera në fakt. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. - prot., datë 24.07.2014 të lidhur mes Titullarit të Autoritetit Kontraktor Bashkia Shkodër dhe BOE “B [REDACTED]” sh.p.k dhe “K [REDACTED]” sh.p.k, kontratën e mbikëqyrjes së punimeve nr. - prot., datë 24.07.2014 si dhe me kontratën e kolaudimit të punimeve nr. – prot. datë 15.12.2014 (*Trajtuar më hollësisht në faqet nr.73-99 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

2.2.1 Rekomandim: Nga Bashkia Shkodër të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **4,442,862 lekë pa t.v.sh** nga bashkimi i operatorëve ekonomik “B. [REDACTED]” sh.p.k dhe “K [REDACTED]” sh.p.k, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën nr. - prot., datë 24.07.2014 me objekt “*Blloku i pallateve Vau i Dejës*” Shkodër, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore si rrjedhojë e likuidimit të punimeve të pakryera në fakt.

Menjëherë

3.3. Gjetje nga auditimi: Në objektin “*Rikonstruksion rrugë dytësore grupi i III-të*” Shkodër, nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të punimeve të ndërtimit të administruara në dosjen teknike rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në vlerën **1,355,002 lekë pa t.v.sh** si pasojë e likuidimit të punimeve të kryera në fakt. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. - prot., datë 15.06.2015 të lidhur mes Titullarit të Autoritetit Kontraktor Bashkia Shkodër dhe OE “C [REDACTED] R [REDACTED] K [REDACTED]” sh.p.k, kontratën e mbikëqyrjes së punimeve nr. - prot., datë 15.06.2015 si dhe me kontratën e kolaudimit të punimeve nr.– prot. datë 11.11.2015 (*Trajtuar më hollësisht në faqet nr.73-99 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

3.3.1 Rekomandim: Nga Bashkia Shkodër të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **1,355,002 lekë pa t.v.sh** nga “C [REDACTED] R [REDACTED] K [REDACTED]” sh.p.k, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën nr. - prot., datë 15.06.2015 me objekt “*Rikonstruksion rrugë dytësore grupi i III-të*” Shkodër, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore si rrjedhojë e likuidimit të punimeve të pakryera në fakt.

Menjëherë

4.4. Gjetje nga auditimi: Në objektin “*Rikonstruksion rrugë dytësore grupi i IV-të*” Shkodër, nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të punimeve të ndërtimit të administruara në dosjen teknike rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në vlerën **1,829,238 lekë pa t.v.sh** si pasojë e likuidimit të punimeve të kryera në fakt. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. - prot., datë 15.06.2015 të lidhur mes Titullarit të Autoritetit Kontraktor Bashkia Shkodër dhe OE “C [REDACTED] R [REDACTED] K [REDACTED]” sh.p.k, kontratën e mbikëqyrjes së punimeve nr. - prot., datë 15.06.2015 si dhe me kontratën e kolaudimit të punimeve nr. – prot. datë 11.11.2015 (*Trajtuar më hollësisht në faqet nr. 73-99 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

4.4.1 Rekomandim: Nga Bashkia Shkodër të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **1,829,238 lekë pa t.v.sh** nga “C [REDACTED] R [REDACTED] K [REDACTED]” sh.p.k, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën nr. - prot., datë 15.06.2015 me objekt “*Rikonstruksion rrugë dytësore grupi i IV-të*” Shkodër, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore si rrjedhojë e likuidimit të punimeve të pakryera në fakt.

Menjëherë

5.5. Gjetje nga auditimi : Në objektin “*Mirëmbajtje e rrugëve e trotuareve të qytetit 2013*” Shkodër, nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të punimeve të ndërtimit të administruara në dosjen teknike rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në vlerën **275,220 lekë pa t.v.sh** si pasojë e likuidimit të punimeve të kryera në fakt. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. - prot., datë 03.07.2013 të lidhur mes Titullarit të Autoritetit Kontraktor Bashkia Shkodër dhe OE “K [REDACTED]”

K██████████” sh.p.k (Trajtuar më hollësisht në faqet nr.73-99 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

5.5.1 Rekomandim: Nga Bashkia Shkodër të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **275,220 lekë pa t.v.sh** nga OE “K██████████ K██████████” sh.p.k, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën nr. - prot., datë 03.07.2013 me objekt “Mirëmbajtje e rrugëve e trotuareve të qytetit 2013” Shkodër, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore si rrjedhojë e likuidimit të punimeve të pakryera në fakt

Menjëherë

6.6. Gjetje nga auditimi: Në objektin “Mirëmbajtje e rrugëve e trotuareve të qytetit 2014” Shkodër, nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të punimeve të ndërtimit të administruara në dosjen teknike rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në vlerën **106,400 lekë pa t.v.sh** si pasojë e likuidimit të punimeve të kryera në fakt. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. - prot., datë 11.06.2014 të lidhur mes Titullarit të Autoritetit Kontraktor Bashkia Shkodër dhe OE “K██████████ K██████████” sh.p.k (Trajtuar më hollësisht në faqet nr. 73-99 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

6.6.1 Rekomandim: Nga Bashkia Shkodër të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **106,400 lekë pa t.v.sh** nga OE “K██████████ K██████████” sh.p.k, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën nr. - prot., datë 11.06.2014 me objekt “Mirëmbajtje e rrugëve e trotuareve të qytetit 2014” Shkodër, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore si rrjedhojë e likuidimit të punimeve të pakryera në fakt

Menjëherë

7.7. Gjetje nga auditimi: Në objektin “Mirëmbajtje e rrugëve e trotuareve të qytetit 2015” Shkodër, nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të punimeve të ndërtimit të administruara në dosjen teknike rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në vlerën **67,760 lekë pa t.v.sh** si pasojë e likuidimit të punimeve të kryera në fakt. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. - prot., datë 01.01.2015 të lidhur mes Titullarit të Autoritetit Kontraktor Bashkia Shkodër dhe OE “K██████████ K██████████” sh.p.k (Trajtuar më hollësisht në faqet nr. 73-99 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

7.7.1 Rekomandim: Nga Bashkia Shkodër të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **67,760 lekë pa t.v.sh** nga OE “K██████████ K██████████” sh.p.k, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën nr. - prot., datë 01.01.2015 me objekt “Mirëmbajtje e rrugëve e trotuareve të qytetit 2015” Shkodër, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore si rrjedhojë e likuidimit të punimeve të pakryera në fakt

Menjëherë

8.8. Gjetje nga auditimi: Në objektin “Mirëmbajtje e rrugëve e trotuareve të qytetit 2016” Shkodër, nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të punimeve të ndërtimit të administruara në dosjen teknike rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në vlerën **166,221 lekë pa t.v.sh** si pasojë e likuidimit të punimeve të kryera në fakt. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. - prot., datë 09.06.2016 të lidhur mes Titullarit të Autoritetit Kontraktor Bashkia Shkodër dhe OE “K██████████ K██████████” sh.p.k (Trajtuar më hollësisht në faqet nr. 73-99 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

8.8.1 Rekomandim: Nga Bashkia Shkodër të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **166,221 lekë pa t.v.sh** nga OE “K██████████ K██████████” sh.p.k, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën nr. - prot., datë 09.06.2016 me objekt “Mirëmbajtje e rrugëve e trotuareve të qytetit 2016” Shkodër, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore si rrjedhojë e likuidimit të punimeve të pakryera në fakt

Menjëherë

9.9. Gjetje nga auditimi: Në objektin “Zbatim rikualifikim Urban Blloqe Banimi Qemal Dracini (pallati me Hark)” Shkodër, nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit, mbikëqyrjes dhe

kolaudimit të punimeve të ndërtimit të administruara në dosjen teknike rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në vlerën **457,216 lekë pa t.v.sh** si pasojë e likuidimit të punimeve të kryera në fakt. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 12579/15 prot., datë 12.12.2016 të lidhur mes Titullarit të Autoritetit Kontraktor Bashkia Shkodër dhe OE “L███████” sh.p.k, kontratën e mbikëqyrjes së punimeve me nr. 5491/15 prot., datë 12.01.2016 si dhe kontratën e kolaudimit të punimeve datë 28.02.2017 (*Trajtuar më hollësisht në faqet nr. 73-99 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

9.9.1 Rekomandim: Nga Bashkia Shkodër të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **457,216 lekë pa t.v.sh** nga OE “L███████” sh.p.k, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën nr. 12579/15 prot., datë 12.12.2016 me objekt “Zbatim rikualifikim Urban Blloqe Banimi Qemal Draçini (pallati me Hark)” Shkodër, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore si rrjedhojë e likuidimit të punimeve të pakryera në fakt.

Menjëherë

10.10. Gjetje nga auditimi: Në objektin “Rikualifikim urban i ambienteve të jashtme të Katedrales së Shën Shtjefnit” Shkodër, nga auditimi i dokumentacionit teknik të hartimit të preventivit të punimeve rezultoi një rritje e fondit limit 1,926,173 lekë pa tvsh nga të cilat vlera **127,883 lekë pa tvsh** përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore. Këto veprime janë në kundërshtim me Vendimi Nr.514, datë 15.08.2007 “Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit, ndryshuar me vendim nr. 664, datë 26.09.2012 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 514, datë 15.08.2007 të Këshillit të Ministrave “Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit”, pikat 2, 3 dhe 9 (*Trajtuar më hollësisht në faqet nr. 73-99 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

10.10.1. Rekomandim: Nga Bashkia Shkodër, të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **127,883 lekë pa tvsh** nga L███████ P███████ në cilësinë e hartuesit të preventivit të punimeve për objektin “Rikualifikim urban i ambienteve të jashtme të Katedrales së Shën Shtjefnit”.

Menjëherë

CI. PËRDORIM JO ME EFIKTIVITET, EFICENCË DHE EKONOMICITET I SHPENZIMEVE NË FUSHËN E PROKURIMEVE PUBLIKE.

1. Gjetje nga auditimi: Bashkia Shkodër, me kontratën nr. 6325/9, datë 14.06.2016, lidhur me subjektin “L███████ 2███████” shpk, ka kontraktuar investimin “Shërbimi pastrimit të mbetjeve urbane, Njësia administrative Velipojë”, për vlerën 11,389,518 lekë me tvsh me afat përfundimi deri në datë 10.09.2016 për (89 ditë kalendarike) dhe e likuiduar në masën 100%. Kontrata është lidhur 20 % mbi kontratën bazë, por pa zbatuar afatet kohore pasi kontrata bazë rezulton e lidhur për 36 muaj, ndërsa shtesë kontrata për 3 muaj, kur afati i shërbimit shtesë duhet të ishte 7.2 muaj (36muaj x 20%) ose deri më datë 20.12.2016.

Referuar parashikimit të nenit 4 të Kushteve të kontratës bazë dhe duke vlerësuar faktin se, subjekti “L███████ 2███████” shpk është likuiduar me shumën 9,758,551 lekë për afatin 4.33 muaj, rezulton se vlerë e përfituar nga subjekti duhej të ishte likuiduar deri në datën 20.12.2016.

Nga mos zbatimi i kushteve të kontratës dhe mos prokurimi i shërbimit, si dhe referuar në shpjegimet paraqitura nga NJP, personi i ngarkuar për ndjekjen e zbatimit e kontratës, por dhe materialeve mbështetëse të dërguara me Projektraportin e Auditimit, subjekti “L███████ 2███████”, ka vazhduar të kryej shërbimin e pastrimit të mbetjeve urbane deri në fund të vitit 2016.

Likuidimi në formën e pagesës paradhënie, pa procedura prokurimi për këtë shërbim, i ka shkaktuar buxhetit të bashkisë mospërdorim me *efektivitet, eficencë dhe ekonomicitet* të fondeve publike në vlerën **9,758,551 lekë** (*Trajtuar më hollësisht në faqet 54-56 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandim: Bashkia Shkodër, të analizojë e nxjerrë përgjegjësinë për shpenzimet lidhur me kontratën e shërbimit të pastrimit nr. 6325/9, datë 14.06.2016, lidhur me subjektin “L███████ 2███████”shpk, lidhur deri më 10.09.2016 dhe vazhduar edhe në vitin 2017, duke marrë masa që të mos përsëritet një situatë e tillë në të ardhmen.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Bashkia Shkodër, ka kryer shpenzime me blerje të vogla ne shkelje të disiplinës financiare jo në përputhje me parimet e Ekonomicitetit, Eficiencës dhe Efektivitetit, të cilat për 3 raste në vlerën prej **60,938 lekë**, kanë sjellë efekte negative financiare në shpenzimet për mirëmbajtje dhe pajisje ambiente zyresh (*urdhër shpenzimeve nr. 133 datë 19.03.2014; nr. 136 datë 19.03.2014 dhe nr. 620 datë 28.10.2014*), ku komisioni i blerjeve me vlera të vogla ka s'kualifikuar dhe nuk ka zgjedhur drejt ofertat, në kundërshtim me pikën 1/c kreu II të VKM nr. 1 datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar, Udhëzimin APP nr. 2, datë 28.03.2013 “Për procedurën e prokurimit me vlera të vogla”, të ndryshuar (*Trajtuar hollësisht në faqet nr. 43-45 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

2.1 Rekomandim: Bashkia Shkodër, të analizojë e nxjerrë përgjegjësinë për shpenzimet me blerje të vogla jo në përputhje me parimet e Ekonomicitetit, Eficiencës dhe Efektivitetit, të cilat kanë sjellë efekte negative financiare në shpenzimet për mirëmbajtje ambientesh dhe pajisje zyresh në vlerën prej **60,938 lekë**, si dhe të evidentoj përgjegjësinë e anëtarëve të Komisionit me blerje të vogla.

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi: Në ish Komunën Dajç, janë konstatuar **21 raste pagesash** të kryera me bankën, për blerjet me vlera të vogla, për mallra dhe shërbime, të cilat janë kryer me shkelje procedurash, në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, ndryshuar me ligjin 131/112 dhe VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për Rregullat e Prokurimit Publik”, si dhe Udhëzimit nr. 7, datë 20.12.2012, “Për zhvillimin e prokurimeve me vlerë të vogël në sistemin elektronik” (*Trajtuar hollësisht në faqet nr. 147-156 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

3.1 Rekomandimi: Bashkia Shkodër, Sektori i Auditimit të Brendshëm të kryejnë një mision auditimi në ish komunën (NJA) Dajç për periudhën 01.01.2013 deri më datën 30.06.2015, lidhur me ligjshmërinë e kryerjes të pagesave nëpërmjet veprimeve të bankës, përfshirë edhe 21 raste pagesash të konstatuara nga KLSH, duke nxjerrë edhe përgjegjësitë ndaj personave përkatës.

Menjëherë

C. MASA DISIPLINORE:

Mbështetur në ligjin “Për statusin e Nëpunësit Civil”, nenin 37, të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Kontratën individuale të punës, i rikërkohet Kryetarit të Bashkisë, fillimin e procedurës për dhënien e masës disiplinore si më poshtë:

C.1. Për punonjësit që janë pjesë e shërbimit civil.

LNë mbështetje të shkronjës (c) neni 15 -*Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së* të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, në zbatim të nenit 58, “*llojet e masave disiplinore*” të ligjit nr. 152/2013 datë 30.5.2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil” **KLSH i ka rekomanduar** Kryetarit të Bashkisë Shkodër, që t'i kërkojë Komisionit disiplinor fillimin e procedurave për dhënien e masës disiplinore, “**Vërejtje**” e parashikuar në nenin 58, germa “a” deri në masën “**Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në 1 vit**” e parashikuar në nenin 58, germa “c”, për **12 punonjës**. Nga verifikimi rezultoi se nga 12 rekomandime për marje masa disiplinore janë zbatuar vetëm 3 masa disiplinore “**Vërejtje**”, ndërsa ndaj 9 punonjësve të tjerë Komisioni Disiplinor pasi ka filluar ecurinë disiplinore, në përfundim ka vendosur që për 9 punonjësit të “**Ndërpritet ecuria disiplinore**” **për të cilët rikërkojmë fillimin e procedurave për** dhënien e masës disiplinore, “**Vërejtje**” e parashikuar në nenin 58, germa “a” deri në masën “**Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në 1 vit**” e parashikuar në nenin 58, germa “c” për punonjësit si mëposhtë:

1-z.Z. ■■■ U ■■■ me detyrë Përgjegjës, Sektori i Menaxhimit dhe Mbrojtjes së Pyjeve, Drejtoria e Mjedisit, Pyjeve dhe Menaxhimit të Ujërave.

- 2-z.V [REDACTED] B [REDACTED], me detyrë Specialist, Sektori i Ndjekjes së Investimeve, Drejtoria e Shërbimeve Publike, Ndjekjes së Investimeve të Infrastrukturës.
- 3-z.S [REDACTED] Z [REDACTED], me detyrë Përgjegjës, Sektori i Lejeve të Ndërtimit dhe Kontrollit mbi Territorin, Drejtoria e Kontrollit të Zhvillimit të Territorit.
- 4-z.N [REDACTED] D [REDACTED], me detyrë Specialist, Sektori i Koordinimit të Investimeve Bashkiake, Drejtoria e Studimeve, Planifikimit dhe Koordinimit të Investimeve.
- 5-z. K [REDACTED] K [REDACTED], me detyrë Drejtor, Drejtoria e Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit.
- 6-z. B [REDACTED] G [REDACTED], me detyrë Drejtor, Drejtoria e të Ardhurave.
- 7-z.A [REDACTED] K [REDACTED], me detyrë Drejtor, Drejtoria e Studimeve, Planifikimit dhe Koordinimit të Investimeve.
- 8-z.A [REDACTED] L [REDACTED], me detyrë Drejtor, Drejtoria e Shërbimeve Publike, Ndjekjes së Investimeve të Infrastrukturës.
- 9-znj.A [REDACTED] Sh [REDACTED], me detyrë Drejtor, me detyrë Drejtor, Drejtoria e Mjedisit, Pyjeve dhe Menaxhimit të Ujërave.

Menjëherë

2.BASHKIA KUKËS:

- Nga verifikimi rezulton se KLSH ka dërguar në Bashkinë Kukës rekomandimet e auditimit me shkresën e saj nr.1005/6, datë 31.12.2017, ndërsa nga Bashkia Kukës për zbatim e rekomandimeve të KLSH është kthyer përgjigje me shkresën e saj nr. 233, datë 25.01.2018, protokolluar në KLSH me shkresën nr. 774/22 datë 29.01.2018.
- Nga verifikimi rezulton se përfundimet e auditimit i janë dërguar subjektit të audituar Bashkisë Kukës, me shkresën e Kryetarit të KLSH nr.1005/6, datë 31.12.2017 dhe duhet të raportonte në KLSH brenda 6 muajve ose brenda datës 30.06.2018 Ndërkohë nga Bashkia Kukës nuk është raportuar brenda afatit.

A. MASA ORGANIZATIVE:

Nga KLSH janë rekomanduar Bashkisë Kukës 18 masa organizative, janë zbatuar plotësisht 5 masa, janë në proces zbatimi 11 masa dhe nuk janë zbatuar 2 masa organizative për të cilat rikërkojmë zbatimin e masave si vijon:

1.6-Gjetja nga auditimi: Janë mbajtur procesverbale dhe janë nxjerrë vendime për prishje të objekteve, ndërsa nuk janë ekzekutuar dhe nuk janë shoqëruar me gjobë për 8 subjekte edhe pse janë konstatuar shkelje ligjore, konkretisht në subjektet: Daut Hallaçi për “Rrethim me zgarë”, Dashnor Duraku për “Rrethim me zgara dhe shkalle”, Rexhep Zela për “Rrethim muri, platform”, Kastriot Sulaj për “Mur guri xokël”, Ismet Matmuja për “Mur me blloqe”, Adil Sopi për “Mur rrethues”, Lishë Uka për “Gardh teli”, Luan Brati për “Rrjet Teli”, veprime në mospërputhje me pika 8, gërma (a), neni 82 të ligjit nr. 10119, datë 23.04.2009 “Për planifikimin e territorit” i ndryshuar me ligjin nr .110/2013 dhe ligji nr. 107/2014, datë 31.7.2014 “Për Planifikimin e Zhvillimin Urban”, neni 52, pika 1, germa “e”. (Trajtuar hollësisht në faqen nr.279-292 të Raportit të Auditimit).

1.6.1-Rekomandimi: Të merren masa nga Inspektorati Ndërtimor Urbanistik Vendor (INUV) që në bashkëpunim me Zyrën e Urbanistikës të evidentojë ndërtimet pa leje, **duke aplikuar gjoba ndaj** subjektet ndërtuese të kundraligjshme me qëllim mbajtjen nën kontroll, administrimin dhe zhvillimin e territorit.

Menjëherë

2.16-Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi në arkivin e institucionit i dokumentacionit të vendimeve të miratuara në Këshillin e Bashkisë Kukës, për periudhën objekt auditimi rezultoi se për 6/mujori **parë viti 2015 janë marrë 39 vendime nga këshilli Bashkiak** për tjetërsim e parcelave ndërtimore, trojeve prona të Bashkisë Kukës si dhe privatizim falas të apartamenteve që shfrytëzohen nga banorë të Kukësit. Shitja e këtyre pronave do të bëhej kundrejt çmimeve të tregut, proces ky që i ngarkohej Drejtorisë Juridike. Nga këto VKB janë materializuar 9 procedura

për të cilat janë përgatitur dosjet tekniko-ligjor, janë kryer pagesat dhe janë lidhur kontratat. Në rastet e tjetërsimit të parcelave ndërtimore dhe trojeve nuk janë përcaktuar nëse janë sheshe apo troje, ku janë bërë ndërtime ose janë dhëne leje ndërtimi, kategori këto që klasifikohen të tjetërsueshme, çka bën marrjen e VKB për këto raste si dhe rastet e ekzekutimit të tyre veprime në mospërputhje me ligjin nr. 7980 datë 27.07.1995 “Për shitblerjen e trojeve” me ndryshime, neni 1 dhe 4. Ndërsa në VKB për dhënie pa pagesë të apartamenteve në 4 raste nuk përcaktohet për çfarë arsye, kjo banesë privatizohet pa pagesë në kundërshtim me nr. 7652 datë 23.12.1992 “Për privatizimin e banesave shtetërore” me ndryshime neni 7 i cili përcakton kategoritë e banorëve që përfitojnë falas privatizimin e banesës dhe dokumentacioni shoqërues për klasifikimin në një nga kategoritë e miratuar me këtë ligj. (Trajtuar hollësisht në faqe nr. 292-299 të Raportit të Auditimit).

2.16.1-Rekomandimi: Nga Bashkia Kukës të merren masa për rishikimin dhe anulimin e VKB të marra dhe të pa ekzekutuara për tjetërsimin e trojeve dhe parcelave ndërtimore, si dhe privatizimin falas të banesave, ku për këto të fundit të përcaktohen kategoria e personave që e përfitojnë banesën falas nëse janë pjesë e klasifikimit të përcaktuar në ligj.

Menjëherë

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI:

Nga verifikimi rezultoi se vlera e rekomanduar është kontabilizuar dhe pasqyruar në llogarinë 468 –debitorë të Pasqyrave Financiare vlera prej 16,691,582 lekë, nuk është kontabilizuar në blinac vlera e papranuar nga Bashkia Kukës në shumën 42,419,059 lekë.

Nga verifikimi rezultoi se nga vlera e rekomanduar nga KLSH prej..... **59,110,641** lekë

-Deri më datën 30.09.2018 është arkëtuar shuma prej108,000 lekë

Kanë mbetur pa u arkëtuar vlera prej..... 59,002,641 lekë

Nga të cilat:

-Në proces arkëtimi 1 rekomandim në vlerën..... 495,655 lekë

-Janë nisur njoftimet për 11 rekomandime por ende nuk kanë filluar arkëtimet. 16,096,859 lekë

-Nuk janë pranuar 12 rekomandime në vlerën.....42,419,059 lekë

Në mënyrë të detajuar masat shpërblim dëmi rikërkojmë si më poshtë:

1.1-Gjetje nga auditimi: Bashkia Kukës me projekt strukturën e miratuar nga Kryetari e kthyer në vendim nga Këshilli Bashkiak, në 8 raste ka kryer pagesa të paligjshme për punonjësit në shumën **606,323 lekë**, ndërkohë që vendi i punës kërkon punonjës me diplomë të integruar DIND, DND ose Master Shkencor; ku janë vendosur punonjës me diplomë Bachelor e barazvlefshme me DNP, veprime në mospërputhje me pika 12, paragrafi V, lidhjet 2 e 7, të VKM nr.1619, datë 02.07.2008 “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësisve të qeverisjes për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të punonjësve të njësisve të qeverisjes vendore” i ndryshuar, me VKM nr.518, datë 16.08.2012 dhe VKM nr.586, datë 17.07.2013 i ndryshuar me VKM nr.165, datë 02.03.2016 “Për grupimin e njësisve të vetëqeverisjes vendore, për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur të emëruar, të nëpunësve civilë të punonjësve administrativë të njësisve të vetëqeverisjes vendore”. (Trajtuar hollësisht në faqe nr.63-99 të Raportit të Auditimit).

1.1.1-Rekomandimi: Nga Bashkia Kukës të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme për arkëtimin e vlerës **606,323 lekë** për pagesa të paligjshme nga 8 punonjësit si me poshtë:

1-M [REDACTED] S [REDACTED] në vlerë 27,819 lekë.

2-A [REDACTED] Sh [REDACTED] në vlerë 84,876 lekë.

3-V [REDACTED] G [REDACTED] në vlerë 47,275 lekë.

4-P [REDACTED] E [REDACTED] i në vlerë 55,713 lekë.

5-K [REDACTED] K [REDACTED] në vlerë 199,148 lekë.

6-H [REDACTED] B [REDACTED] në vlerë 177,372 lekë.

- 7-H [REDACTED] H [REDACTED] në vlerë 11,600 lekë (bonus).
8-L [REDACTED] Gj [REDACTED] në vlerë 2,520 lekë (pa dokumente).

Menjëherë

2.2-Gjetje nga auditimi: Në mospërputhje me shkronja (dh), (ë) të nenit 12, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, si dhe nenit 35/b 36, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, janë të pa argumentuara me dokumente konsumi për 926 litra naftë nga dy autoveturat të administratës së Bashkisë me efekt financiar negative në dëm të buxhetit të bashkisë në vlerën **132,404 lekë** (Trajtuar hollësisht në faqe nr. 63-99 të Raportit të Auditimit).

2.2.1-Rekomandim: Nga Bashkia Kukës të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme për arkëtimin e vlerës **132,404 lekë** nga 4 punonjësit si me poshtë;

- 1-E [REDACTED] H [REDACTED] në vlerë 40,132 lekë.
2-R [REDACTED] Sh [REDACTED] në vlerë 3,318 lekë.
3-B [REDACTED] D [REDACTED] në vlerë 44,477 lekë.
4-M [REDACTED] C [REDACTED] në vlerë 44,477 lekë

Menjëherë

3.3-Gjetje nga auditimi: Me urdhër-shpenzimin nr. 148/1, datë 15.06.2015 është bërë pagesë në shumën **360,000 lekë** OE “F [REDACTED]”shpk për shpenzime transporti për administratën e Bashkisë Kukës në bazë të urdhër prokurimit nr. 47, datë 18.12.2014 dhe faturës nr. 05, datë 31.12.2014. Objekti i prokurimit nuk është i plotë, pasi nuk përcaktohet destinacioni i udhëtimit dhe nuk ka program se për çfarë është kryer ky udhëtim. Nuk ka argumentim të nevojës së blerjes së këtij shërbimi dhe të fondit limit. Fatura nuk përcakton çmimin për njësi. Udhëtimi turistik për administratën e bashkisë nuk është pjesë e funksioneve të njësisë vendore. Veprime në mospërputhje me UMF nr. 2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” në zbatim të ligjit organik të buxhetit, Kreu II, pika (3) “Buxheti vendor” i ndryshuar pika (113), me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 4/24, 10, 11. 12 dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aseteve në sektorin publik”, pika (35), (36) me pasojë **dëmi ekonomik në shumën 360,000 lekë**. (Trajtuar hollësisht në faqe nr. 63-99 të Raportit të Auditimit).

3.3.1-Rekomandim: Bashkia Kukës të marrë masat dhe të ndjekë procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e shumës **360,000 lekë** nga KPVV në mënyrë solidare sa më poshtë:

- 1-L [REDACTED] D [REDACTED] ish-Drejtor Ekonomik në shumën 120,000 lekë.
2-F [REDACTED] T [REDACTED] ish-Drejtor i Shërbimeve në shumën 120,000 lekë.
3-B [REDACTED] B [REDACTED] ish-Drejtor Juridik në shumën 120,000 lekë.

Menjëherë

4.4-Gjetje nga auditimi: Me urdhër/shpenzimi nr. 720, datë 13.10.2016 është kryer pagesa në shumën 5,000,000 lekë për transferim fondi i Qendrës së Studimeve Arkeologjike për financimin e projektit shkencor “Kalaja e Pecës-Kukës, rivlerësim i gërmimeve të viteve 1985-1989 dhe krijimi i hartës së zonifikimit arkeologjik”. Për realizimin e këtij projekti nga Bashkia është lidhur kontrata nr. 668, datë 25.09.2016 me afat 9 muaj, ndërsa nuk është përcaktuar vlera e kontratës, përveç vlerës prej 5,000,000 lekë e cila duhet të derdhej menjëherë pas lidhjes së kontratës. Për këtë vlerë nga Qendra e Studimeve Arkeologjike është hartuar preventivi i projektit, ku ndër zërat e tjerë ka përcaktuar 20% të vlerës për “punime të paparashikuara”, zë i situacionit për të cilën nuk ka analiza dhe argumentim, veprim në mospërputhje me UKM nr. 2, datë 08.05.2003 “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit” në zbatim të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” neni 7 dhe 12 me pasojë **dëmi ekonomik në shumën 715,000 lekë**(Më hollësisht në faqe nr. 63-99 të Raportit të Auditimit).

4.4.1-Rekomandim: Nga Bashkia Kukës të marren masat dhe të ndjekë procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e shumës **prej 715,000 lekë**, nga Qendra e Studimeve Arkeologjike përfituar tepër për punime të pakryera.

Nga verifikimi rezultoi se për rekomandimet nga numri rendor 5 deri në numrin 16 nuk është pranuar në 12 raste dëmi ekonomik i rekomanduar nga KLSH në vlerën prej **42,419,059 lekë**, i cili përfaqëson dëmin ekonomik i konstatuar në shkëlqen e rregullave të prokurimit publik me arsyetimin se: Argumentet e parashtruara në raportin përfundimtar nga administrata e Bashkisë Kukës janë paraqitur observacione dhe përsa i perket zbatimit të procedurave dhe çështjeve të trajtuara nga KLSH nuk mund të ngarkohemi me përgjegjësi ligjore pasi për këto raste është referuar në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Kukës.

Për të cilat i **rikërkojmë** edhe njëherë zbatimin e tyre nga Bashkia Kukës si më poshtë:

5.5-Gjetje nga auditimi: Në tenderin e zhvilluar me objekt “*Mirëmbajtje e rrjetit rrugor rural, Bashkia Kukës*”, **dëmi ekonomik** total i shkaktuar Buxhetit të Shtetit dhe buxhetit të Bashkisë Kukës është **1,922,606 lekë**, pasi është kryer shpenzim i paligjshëm, shkaktuar si rezultat i vlerësimit në kundërshtim me nenin 53/3 të LPP. (*Trajtuar hollësisht në faqe nr.99-264 të Raportit të Auditimit*).

5.5.1-Rekomandimi: Nga Bashkia Kukës të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme për arkëtimin e vlerës **1,922,606 lekë**, nga Z.B. [REDAKTUAR] Sh [REDAKTUAR], Z.I [REDAKTUAR] K [REDAKTUAR], Z.E [REDAKTUAR] L [REDAKTUAR] dhe Z. A [REDAKTUAR] V [REDAKTUAR].

Menjëherë

6.6-Gjetje nga auditimi: Në tenderin e zhvilluar me objekt “*Rikonstruksion i Qendrës Sociale, Kukës*”, **dëmi ekonomik** total i shkaktuar Buxhetit të Shtetit dhe buxhetit të Bashkisë Kukës është **4,100,826 lekë**, pasi është kryer shpenzim i paligjshëm, shkaktuar si rezultat i vlerësimit në kundërshtim me nenin 53/3, 56 të LPP. (*Trajtuar hollësisht në faqe nr. 99-264 të Raportit të Auditimit*).

6.6.1-Rekomandimi: Nga Bashkia Kukës të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme për arkëtimin e vlerës **4,100,826 lekë**, nga Z.B [REDAKTUAR] Sh [REDAKTUAR], Z.A [REDAKTUAR] V [REDAKTUAR], Z.H [REDAKTUAR] M [REDAKTUAR], Z.E [REDAKTUAR] L [REDAKTUAR].

Menjëherë

7.7-Gjetje nga auditimi: Në tenderin e zhvilluar me objekt “*Mirëmbajtje dhe pastrim i rrugëve nga dëborë*”, **dëmi ekonomik** total i shkaktuar Buxhetit të Shtetit dhe Bashkisë Kukës, është **398,400 lekë**, pasi është kryer shpenzim i paligjshëm, shkaktuar si rezultat i vlerësimit në kundërshtim me nenin 53/3 të LPP. (*Trajtuar hollësisht në faqe nr. 99-264 të Raportit të Auditimit*).

7.7.1-Rekomandimi: Nga Bashkia Kukës të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme për arkëtimin e vlerës **398,400 lekë**, nga Z.B [REDAKTUAR] Sh [REDAKTUAR], Z.A [REDAKTUAR] V [REDAKTUAR], Z.E [REDAKTUAR] L [REDAKTUAR], Z.A [REDAKTUAR] E [REDAKTUAR].

Menjëherë

8.8-Gjetje nga auditimi: Në tenderin e zhvilluar me objekt “*Rikonstruksion i rrugës M. Mamëz-vend depozitimi mbetjeve + ndërtimi rrethimit të jashtëm*”, **dëmi ekonomik** total i shkaktuar Buxhetit të Shtetit dhe buxhetit të Bashkisë Kukës, është **2,220,480 lekë**, pasi është kryer shpenzim i paligjshëm, shkaktuar si rezultat i vlerësimit në kundërshtim me neni 53/3, 56 të LPP. (*Trajtuar hollësisht në faqe nr. 99-264 të Raportit të Auditimit*).

8.8.1-Rekomandimi: Nga Bashkia Kukës të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme për arkëtimin e vlerës **2,220,480 lekë**, nga Z.B [REDAKTUAR] Sh [REDAKTUAR], Z.A [REDAKTUAR] V [REDAKTUAR], Z.A [REDAKTUAR] P [REDAKTUAR], Z.E [REDAKTUAR] L [REDAKTUAR].

Menjëherë

9.9-Gjetje nga auditimi: Në tenderin e zhvilluar me objekt “*Sistemim i shesheve të pallateve Nr.1, 2 dhe 3- Lagjia Nr.3, Bashkia Kukës*”, **dëmi ekonomik** total i shkaktuar Buxhetit të Shtetit dhe buxheti Bashkisë Kukës, është **3,650,920 lekë**, pasi është kryer shpenzim i paligjshëm,

shkaktuar si rezultat i vlerësimit në kundërshtim me nenin 53/3 të LPP. (Trajtuar hollësisht në faqe nr. 99-264 të Raportit të Auditimit).

9.9.1-Rekomandimi: Nga Bashkia Kukës të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme për arkëtimin e vlerës **3,650,920 lekë**, nga Z.B. [REDACTED] Sh [REDACTED], Z.A. [REDACTED] V [REDACTED], Z.A. [REDACTED] P [REDACTED], Z. E [REDACTED] L [REDACTED].

Menjëherë

10.10-Gjetje nga auditimi: Në tenderin e zhvilluar me objekt “*Rikonstruksion i qendrës sociale - Kukës*”, *shtesë kontrate, dëmi ekonomik* total i shkaktuar Buxhetit të Shtetit dhe buxhetit të Bashkisë Kukës, është **2,870,880 lekë** si shpenzim i paligjshëm për vlerë të pa dokumentuar dhe të pa argumentuar, në kundërshtim me nenin 33 të LPP. (Trajtuar hollësisht në faqe nr. 99-264 të Raportit të Auditimit).

10.10.1-Rekomandimi: Nga Bashkia Kukës të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme për arkëtimin e vlerës **2,870,880 lekë**, nga Z. B [REDACTED] Sh [REDACTED].

Menjëherë

11.11-Gjetje nga auditimi: Në tenderin e zhvilluar me objekt “*Mirëmbajtje dhe pastrim i rrugëve nga dëbora*” *shtesë kontrate, dëmi ekonomik* total i shkaktuar Buxhetit të Shtetit dhe buxhetit të Bashkisë Kukës, është **1,485,120 lekë**, si shpenzim i paligjshëm për vlerë të pa dokumentuar dhe të pa argumentuar, në kundërshtim me nenin 33 të LPP. (Trajtuar hollësisht në faqe nr. 99-264 të Raportit të Auditimit).

11.11.1-Rekomandimi: Nga Bashkia Kukës të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme për arkëtimin e vlerës **1,485,120 lekë**, nga Z.B [REDACTED] Sh [REDACTED].

Menjëherë

12.12-Gjetje nga auditimi Në tenderin e zhvilluar me objekt “*Mirëmbajtje e rrjetit rrugor rural të Bashkisë Kukës*”, *shtesë kontrate, dëmi ekonomik* total i shkaktuar Buxhetit të Shtetit dhe buxhetit të Bashkisë Kukës, është **767,868 lekë**, si shpenzim i paligjshëm për një vlerë të pa dokumentuar dhe të pa argumentuar, në kundërshtim me nenin 33 të LPP. (Trajtuar hollësisht në faqe nr.99-264 të Raportit të Auditimit).

12.12.1-Rekomandimi: Nga Bashkia Kukës të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme për arkëtimin e vlerës **767,868 lekë**, nga Z.B [REDACTED] Sh [REDACTED].

Menjëherë

13.13-Gjetje nga auditimi: Në tenderin e zhvilluar me objekt “*Ndërtimi i rrjetit të kanalizimeve të ujërave të zeza, Lagja Drinas, Kukës*”, *dëmi ekonomik* total i shkaktuar Buxhetit të Shtetit dhe buxhetit të Bashkisë Kukës, është **2,206,498 lekë**, pasi është kryer shpenzim i paligjshëm, shkaktuar si rezultat i vlerësimit në kundërshtim me nenin 53/3, 56 të LPP. (Trajtuar hollësisht në faqe nr. 99-264 të Raportit të Auditimit).

13.13.1-Rekomandimi: Nga Bashkia Kukës të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme për arkëtimin e vlerës **2,206,498 lekë** nga Z.B [REDACTED] Sh [REDACTED], Z.A [REDACTED] V [REDACTED], Z.A [REDACTED] P [REDACTED], Z.E [REDACTED] L [REDACTED].

Menjëherë

14.14-Gjetje nga auditimi: Në tenderin e zhvilluar me objekt “*Rehabilitimi i kanalit të uzinës, Kukës*”, *dëmi ekonomik* total i shkaktuar Buxhetit të Shtetit dhe buxhetit të Bashkisë Kukës, është **3,280,014 lekë**, pasi kjo vlerë përbën shpenzim të paligjshëm shkaktuar si rezultat i vlerësimit në kundërshtim me nenin 53/3 të LPP. (Trajtuar hollësisht në faqe nr. 99-264 të Raportit të Auditimit).

14.14.1-Rekomandimi: Nga Bashkia Kukës të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme për arkëtimin e vlerës **3,280,014 lekë**, nga Z.B [REDACTED] Sh [REDACTED], Z.A [REDACTED] V [REDACTED], Z.E [REDACTED] L [REDACTED], Z.G [REDACTED] Ç [REDACTED].

Menjëherë

15.15-Gjetje nga auditimi: Në tenderin e zhvilluar me objekt “*Sistemimi dhe asfaltimi i unazës veriore të qytetit Kukës, Karburanti vjetër–Stacioni për Morinë*” *dëmi ekonomik* total i shkaktuar Buxhetit të Shtetit dhe buxhetit të Bashkisë Kukës, është **19,084,914 lekë**, pasi kjo vlerë është shpenzim i paligjshëm i kryer nga Bashkia Kukës, si rezultat i vlerësimit të gabuar të

ofertave pjesëmarrëse, në kundërshtim të plotë me nenin 53/3 të LPP. (Trajtuar hollësisht në faqe nr. 99-264 të Raportit të Auditimit).

15.15.1-Rekomandimi: Nga Bashkia Kukës të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme për arkëtimin e vlerës **19,084,914 lekë**, nga Z.B. [REDACTED] Sh [REDACTED], Z.B. [REDACTED] M [REDACTED], Z.K [REDACTED] L [REDACTED], Z. E [REDACTED] L [REDACTED].

Menjëherë

16.16-Gjetje nga auditimi: Në tenderin e zhvilluar me objekt “Sistemim i Qendrës së fshatit Orgjost”, *shtesë kontrate, dëmi ekonomik* total i shkaktuar Buxhetit të Shtetit dhe buxhetit të Bashkisë Kukës, është **430,533 lekë**, pasi është shpenzim i paligjshëm ndaj shoqërisë “Grand Group”shpk e cila ka të drejtë të realizojë vetëm 10% të punimeve, sipas aktmarrëveshjes për bashkimin e përkohshëm të shoqërive, të nënshkruar midis operatorëve ekonomikë në prani të noterit, në kundërshtim të plotë me nenin 53/3 të LPP. (Trajtuar hollësisht në faqe nr. 99-264 të Raportit të Auditimit).

16.16.1-Rekomandimi: Nga Bashkia Kukës të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme për arkëtimin e vlerës **430,533 lekë**, nga Z.B. [REDACTED] Sh [REDACTED].

Menjëherë

17.17-Gjetje nga auditimi: Në tenderin e zhvilluar me objekt “Blerje pjesë ndërrimi, goma, vajra lubrifikante” *dëmi ekonomik* i shkaktuar për buxhetin e Bashkisë Kukës në shumën **389,340 lekë me tvsh**, pasi është kryer shpenzim i paligjshëm, shkaktuar si rezultat i kualifikimit të ofertës me vlerë me të lartë, në mospërputhje me nenin 52 “Hapja e ofertave” pikat (1); (6), nenin 53/3 “Shqyrtimi ofertave”, nenin 54 “Alternativat”, nenin 55 “Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese” të LPP. (Trajtuar hollësisht në faqe nr. 99-264 të Raportit të Auditimit).

17.17.1-Rekomandimi: Nga Bashkia Kukës të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme për arkëtimin e vlerës **389,340 lekë me tvsh**, nga Z.L [REDACTED] D [REDACTED], Z.A [REDACTED] D [REDACTED], Z.F [REDACTED] T [REDACTED], në cilësinë anëtar të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave

Menjëherë

18.18-Gjetje nga auditimi: Në objektin “Ndërtimi i rrjetit të kanalizimeve të ujërave të zeza, lagja Drinas”, Kukës, nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të punimeve të ndërtimit të administruara në dosjen teknike rezultoi se nuk janë aplikuar penalitetet për vonesa në përfundimin e punimeve në vlerën **295,076 lekë**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 26 prot., datë 13.04.2017 të lidhur mes Titullarit të Autoritetit Kontraktor Bashkia Kukës dhe BOE “O [REDACTED]” SHPK dhe “O [REDACTED]” SHPK. (Trajtuar hollësisht në faqe nr. 99-264 të Raportit të Auditimit).

18.18.1-Rekomandimi: Nga Bashkia Kukës të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **295,076 lekë** nga operatorët ekonomikë “O [REDACTED]” SHPK dhe “O [REDACTED]” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën nr. 26 prot., datë 13.04.2017 me objekt “Ndërtimi i rrjetit të kanalizimeve të ujërave të zeza, lagja Drinas”, Kukës, vlerë kjo e cila përfaqëson një penalitetin e pa aplikuar nga ana e Autoritetit Kontraktor Bashkia Kukës ndaj sipërmarrësit të punimeve për vonesa të pa justifikuara në përfundimin e punimeve.

Menjëherë

19.19-Gjetje nga auditimi: Në objektin “Rikonstruksion i 7 kanaleve ujitëse”, Kukës, nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të punimeve të ndërtimit të administruara në dosjen teknike rezultuan diferenca në volume pune të likuiduara por të pakryera në fakt në vlerën **113,320 lekë pa tvsh** si dhe mos aplikim i penalitetit për vonesa në përfundimin e punimeve në vlerën **359,689 lekë**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 26 prot., datë 18.05.2016 të lidhur mes Titullarit të Autoritetit Kontraktor Bashkia Kukës dhe OE “D [REDACTED]”shpk. (Trajtuar hollësisht në faqe nr. 99-264 të Raportit të Auditimit).

19.19.1-Rekomandimi: Nga Bashkia Kukës të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **113,320 lekë pa tvsh** nga operatori ekonomik “D [REDACTED]” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën nr. 26 prot., datë 18.05.2016 me objekt “Rikonstruksion i 7 kanaleve ujitëse”, Kukës, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore si rrjedhojë e

likuidimit të punimeve të pakryera në fakt apo prej mos ndryshimit të zërave në situacion sipas zërit faktit.

19.19.2-Rekomandimi: Nga Bashkia Kukës të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **359,689 lekë** nga operatori ekonomik “D [REDACTED]” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën nr. 26 prot., datë 18.05.2016 me objekt “*Rikonstruksion i 7 kanaleve ujitëse*”, Kukës, vlerë kjo e cila përfaqëson një penaltetin e pa aplikuar nga ana e Autoritetit Kontraktor Bashkia Kukës ndaj sipërmarrësit të punimeve për vonesa të pa justifikuar në përfundimin e punimeve.

Menjëherë

20.20-Gjetje nga auditimi: Në objektin “*Ndërtimi i rrjetit të KUZ (segmenti Kukës - Uzinë)*”, Kukës, nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit, mbikëqyrjes dhe kolaudit të punimeve të ndërtimit të administruara në dosjen teknike rezultuan diferenca në volume pune të likuiduara të pakryera në vlerë **237,430 lekë pa tvsh**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 31 prot., datë 25.05.2016 të lidhur mes Titullarit të Autoritetit Kontraktor Bashkia Kukës dhe OE “D [REDACTED]” SHPK. (Trajtuar hollësisht në faqe nr. 99-264 të Raportit të Auditimit).

20.20.1-Rekomandimi: Nga Bashkia Kukës të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **237,430 lekë pa tvsh** nga operatori ekonomik “D [REDACTED]” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën nr. 31 prot., datë 25.05.2016 me objekt “*Ndërtimi i rrjetit të KUZ (segmenti Kukës - Uzinë)*”, Kukës, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore si rrjedhojë e likuidimit të punimeve të pakryera në fakt apo prej mos ndryshimit të zërave në situacion sipas zërit faktit.

Menjëherë

21.21-Gjetje nga auditimi: Në objektin “*Mirëmbajtje dhe pastrim i rrugëve nga dëbora (15 dhjetor 2015–31 mars 2016)*”, Kukës, nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit dhe mbikëqyrjes së punimeve të administruara në dosje rezultuan diferenca në volume pune të likuiduara por të pakryera në fakt në vlerën **1,775,000 lekë pa tvsh**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 113 prot., datë 18.12.2015 të lidhur mes Titullarit të Autoritetit Kontraktor Bashkia Kukës dhe OE “G [REDACTED]” SHPK. (Trajtuar hollësisht në faqe nr. 99-264 të Raportit të Auditimit).

21.21.1-Rekomandimi: Nga Bashkia Kukës të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **1,775,000 lekë pa tvsh** nga operatori ekonomik “G [REDACTED]” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën nr. 113 prot., datë 18.12.2015 me objekt “*Mirëmbajtje dhe pastrim i rrugëve nga dëbora (15 dhjetor 2015-31 mars 2016)*”, Kukës, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore si rrjedhojë e likuidimit të punimeve të pakryera në fakt.

Menjëherë

22.22-Gjetje nga auditimi: Në objektin “*Mirëmbajtje e rrjetit rrugor rural të Bashkisë Kukës*”, nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit dhe mbikëqyrjes së punimeve të administruara në dosje rezultuan diferenca në volume pune të likuiduara por të pakryera në fakt në vlerën **2,700,000 lekë pa tvsh**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 36 prot., datë 17.06.2016 të lidhur mes Titullarit të Autoritetit Kontraktor Bashkia Kukës dhe BOE “R [REDACTED] C [REDACTED]” SHPK & “O [REDACTED]” SHPK. (Trajtuar hollësisht në faqe nr. 99-264 të Raportit të Auditimit).

22.22.1-Rekomandim: Nga Bashkia Kukës të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **2,700,000 lekë pa tvsh** nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “R [REDACTED] C [REDACTED]” SHPK & “O [REDACTED]” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën nr. 36 prot., datë 17.06.2016 me objekt “*Mirëmbajtje e rrjetit rrugor rural të Bashkisë Kukës*”, Kukës, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore si rrjedhojë e likuidimit të punimeve të pakryera në fakt.

Menjëherë

23.23-Gjetje nga auditimi: Në objektin “*Mirëmbajtje dhe pastrim i rrugëve nga dëbora*”, Kukës, nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit dhe mbikëqyrjes së punimeve të

administruara në dosje rezultuan diferenca në volume pune të likuiduara por pakryera në fakt në vlerën **9,008,000 lekë pa tvsh**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 78 prot., datë 30.11.2016 dhe kontratën shtesë sipas aktit me nr. 23 prot., datë 03.04.2017 të lidhur mes Titullarit të Autoritetit Kontraktor Bashkia Kukës dhe BOE “O [REDAKTUAR]” SHPK dhe “V [REDAKTUAR]” SHPK. *(Trajtuar hollësisht në faqe nr. 99-264 të Raportit të Auditimit).*

23.23.1-Rekomandim: Nga Bashkia Kukës të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **9,008,000 lekë pa tvsh** nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “O [REDAKTUAR]” SHPK dhe “V [REDAKTUAR]” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën nr. 78 prot., datë 30.11.2016 dhe kontratën shtesë sipas aktit me nr. 23 prot me objekt “*Mirëmbajtje dhe pastrim i rrugëve nga dëbora*”, Kukës, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore si rrjedhojë e likuidimit të punimeve të pakryera në fakt.

Menjëherë

3.BASHKIA KUKËS ish -komunat

- Nga verifikimi rezulton se KLSH ka dërguar në Bashkinë Kukës rekomandimet e auditimit me shkresën e saj nr. 1105/6 datë 31.12.2017 protokolluar në Bashkinë Kukës, ndërsa nga Bashkia Kukës për zbatim e rekomandimeve të KLSH është kthyer përgjigje me shkresën nr.233, datë 25.01.2018.

- Nga verifikimi rezulton se përfundimet e auditimit i janë dërguar subjektit të audituar Bashkisë Kukës, me shkresën e Kryetarit të KLSH nr. nr. 1105/6 datë 31.12.2017 dhe duhet të raportonte në KLSH brenda 6 muajve ose brenda datës 30.06.2018. Ndërkohë nga Bashkia Kukës nuk është raportuar brenda afatit.

A.MASA ORGANIZATIVE:

Nga KLSH janë rekomanduar Bashkisë Kukës 7 masa organizative, janë zbatuar plotësisht 3 masa, janë në proces zbatimi 3 masa dhe nuk është zbatuar 1 masë organizative për të cilën rikërkojmë zbatimin e masës si vijon:

1.1-Gjetje nga auditimi: Gjendja e llogarisë 202 “*Studime e kërkime*” më datë 31.12.2015 rezulton në vlerën 12,472,892 lekë e trashëguar nga ish/Komunat u konstatua se, nuk është bërë zbërthimi dhe listimi sipas objekteve të detajuara për investim, ndërsa për 4 ish/Komunat Malzi në 2 raste vlerën 222,000 lek, Bicaj në 2 raste vlerën 470,000 lekë, Shtiçen në 1 rast vlerën 360,000 lekë dhe Kolsh në 1 rast vlera 240,000 lekë, nuk janë kryer veprimet e kontabilizimit nga llogaria (230) AQ të patrupëzuara në proces, në llogarinë (202) AQ të patrupëzuar, veprime në kundërshtim me ligjin nr.9228, datë 29.04.2004 “*Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare*” i ndryshuar, VKM nr.783, datë 22.11.2006 “*Për përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabël*”. *(Trajtuar hollësisht në faqet 10-67 të Raportit të Auditimit).*

1.1.1-Rekomandimi: Bashkia Kukës, Drejtoria Ekonomike dhe Financës të marrin masat për zbërthimin e vlerës prej 12,47,892 lekë, për çdo objekt dhe të zbatojë kërkesat e standardit në pikën 12 në lidhje me transferimin e vlerës së çdo projekti, apo studimi në objektet për të cilat ka përfunduar projekti, studimi, apo kërkimi.

Menjëherë

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI:

KLSH rekomandon ndjekjen dhe vazhdimin e procedurave deri në arkëtimin e plotë të dëmit prej 13,968 mijë lekë. Për disa nga rekomandimet për shpërblim dëmi Bashkia Kukës me shkresën nr. 4334, datë 19.11.2018 “Dërgimi i aktverifikimit nr.03, datë 05.11.2018, për verifikimin e rekomandimeve të Raportit përfundimtar të KLSH, dërguar në KLSH më datën 19.11.2018, ka paraqitur komente dhe sqarime nga personat e ngarkuar për zhëmtim të cilët nuk e kanë pranuar këtë rekomandim me arsyetimin se shkeljet e konstatuara nuk qëndrojnë .

Në mënyrë të detajuar masat shpërblim dëmi rikërkojmë si më poshtë:

1.1-Gjetje nga auditimi: Janë kryer pagesa për shpenzime udhëtim e dieta me dokumentacion fiktiv, ose në mungesë dokumentesh autorizues dhe vërtetues, mbështetës e justifikues, si dhe për ditë pushim apo festë zyrtare për punonjësit e administratës e Kryetarë në ish/Komunat: Bicaj shuma 214,500 lekë, Topojan shuma 317,500 lekë, Ujmisht shuma 842,000 lekë, Malzi shuma 91,500 lekë, Zapod shuma 38,000 lekë, Shishtavec shuma 33,000 lekë, Bushticë shuma 227,000 lekë, Kolsh shuma 33,500 lekë, Shtiqen shuma 84,000 lekë, Surroj shuma 233,500 lekë, Arrën shuma 2,072,650 lekë, në kundërshtim me VKM nr.997, datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit” i ndryshuar pika I, III/3(b), V/2, me ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Per Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” neni 4/26, neni 8/5, neni 9/4, neni 12/3/(a) (dh) (f) me UMF nr.30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aseteve në sektorin publik” pika 35, 36, **me pasojë dëmi ekonomik në shumën 4,187,150 lekë** (Trajtuar hollësisht në faqet 10-67 të Raportit të Auditimit).

1.1.1-Rekomandimi: Bashkia Kukës të marrë masat dhe të ndjekë procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e shumës **4,187,150 lekë** të përfituar padrejtësisht nga punonjësit e administratës dhe ish/Kryetarët e Komunave sipas shumave përkatëse të paraqitura në tabelat e trajtuara në pikën 3/d të Projektraportit të Auditimit.

Menjëherë

2.2-Gjetje nga auditimi: Janë kryer pagesa në 3 raste në shumën 170,000 lekë për shpenzime të telefonisë celulare në formën e blerjes së kartave rimbushëse për ish-Kryetarët e ish/Komunat: Bicaj shuma 40,000 lekë, Ujmisht shuma 120,000 lekë dhe Kalis shuma 10,000 lekë, të cilët nuk barazohen në pagë me nivelet e kategorive të miratuara të klasifikuara për përfitimin nga buxheti për përballimin e këtij shpenzimi, në kundërshtim me pikën 9 dhe 11 të VKM nr.864, datë 23.7.2010 “Për Pajisjen me numër telefoni celular të personave juridikë, publikë”, **me pasojë dëmi ekonomik në vlerën 170,000 lekë** (Trajtuar hollësisht në faqet 10-67 të Raportit të Auditimit).

2.2.1-Rekomandimi: Bashkia Kukës të marrë masat dhe të ndjekë procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e shumës **170,000 lekë** e përfituar padrejtësisht nga:

1-z.A. [redacted] K [redacted] ish-K/Komunës Bicaj shuma **40,000 lekë**.

2-z.A. [redacted] D [redacted] ish-K/Komunës Ujmisht shuma **120,000 lekë**.

3-z.A. [redacted] Sh [redacted] ish-K/Komunës Kalis shuma **10,000 lekë**.

Menjëherë

3.3-Gjetje nga auditimi: Në vitin 2013 janë kryer pagesa në 2 raste në shumën 135,000 lekë përkatësisht nga ish-Komunat Kalis në shumën 63,000 lekë dhe Ujmisht në shumën 72,000 lekë, për shpërblim të punonjësve në fundvitin e vitit 2012 nga fondi i veçantë në kundërshtim me VKM nr.849, datë 06.12.2012 “Për një ndryshim në vendimin nr. 929, datë 17.11.2010 të këshillit të ministrave "Për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë", të ndryshuar” pika 1, **me pasojë dëmi ekonomik në shumën 135,000 lekë**. (Trajtuar hollësisht në faqet 10-67 të Raportit të Auditimit).

3.3.1-Rekomandimi: Bashkia Kukës të marrë masat dhe të ndjekë procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e shumës **135,000 lekë** nga punonjësit e ish-komunave Kalis dhe Ujmisht, përfitues me pa të drejtë të shpërblimit, sipas tabelave të paraqitura në pikën 3/d të Raportit të Auditimit.

Menjëherë

4.4-Gjetje nga auditimi: Janë kryer pagesa për qiramarrje nga ish/komunat: Kalis për kontrata qiramarrje ambientesh për shkollën CU Kodër Gështenjë Lagja Bodine në shumën 119,000 lekë, Ujmisht qiramarrje ambientesh për kopshtin në fshatin Malqene dhe Shkollën në fshatin Resk në shumën 207,000 lekë, Zapod në shumën 71,000 lekë, Malzi në shumën 37,800 lekë, Surroj për kontrata qiramarrje ambientesh për shkollën 9/vjeçare fshati Qinamak në shumën 139,400 lekë, për të cilat **nuk është kryer ndalesa tatim në burim, në masën 10% me vlerë 184,080 lekë** në kundërshtim me ligjin nr.8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", të ndryshuar neni 33 dhe ligji nr. 156/2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligji nr. 8438, datë 28.12.1998, "Për

tatimin mbi të ardhurat" neni 11 dhe në udhëzimin nr. 5, datë 30.1.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", të ndryshuar, pika 2 (Trajtuar hollësisht në faqet 10-67 të Raportit të Auditimit).

4.4.1-Rekomandim: Bashkia Kukës të marrë masat dhe të ndjekë procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e shumës **184,080 lekë** nga qiradhënësit të evidentuar në tabelat e paraqitura në në pikën 3/d të Raportit të Auditimit.

Menjëherë

5.5-Gjetje nga auditimi: Nga ish-Komuna Bushtricë është lidhur kontratë qiramarrje nr.1 datë 10.02.2013 me objekt: për marrjen me qira të *automjetin tip Benz me targë AA252AM kundrejt pagesës 25,000 lekë në muaj*” e cila nuk ka afat përdorimi. Për këtë kontratë është bërë pagesa paradhënie për 11 muaj në vlerën 275,000 lekë në kundërshtim me kontratën neni 3 pika 1.2. Për këtë automjet janë kryer 2 herë shpenzime në shumën 425,400 lekë (*shënuar për efekt qiraje 11.5muaj*), duke paguar përsëri 5 muaj paradhënie në vlerën 125,000 lekë. Në asnjë dokument nuk vërtetohet se automjeti është përdorur nga Komuna për periudhë 2 vjeçare. Për automjetin Tip Benz vlera e pagesës paradhënie e qirasë prej 400,000 lekë dhe vlera prej 425,400 lekë për riparim e pjesë këmbimi *me pasojë dëmi ekonomik në shumën 825,400 lekë*.

Po për periudhën 2013-2015 ish/Komuna Bushtricë ka kryer shpenzime për riparime dhe për një automjet tjetër tip “Toyota”, në 3 raste në shumën 424,000 lekë. Sipas procesverbaleve të vitit 2015 të mbajtura nga Bashkia Kukës për dorëzimin e automjeteve nga komunitat, bilancit të vitit 2013 e 2012. Komuna Bushtricë nuk disponon automjet, por në vitin 2014 janë kryer shpenzime për blerje 5,135 litra karburant dhe riparim e blerje pjesë këmbimi për dy automjete private, ndërkohë që është e panevojshme mbajtja e dy automjeteve për lëvizjen e administratës dhe kryerjen e shpenzimeve për to. Për konsumin e karburantit nuk ka dokumente justifikues dhe vërtetues fletë-udhëtime e procesverbale. *Për vitin 2014 vlera prej 950,000 lekë e blerjes së naftës dhe vlera prej 424,000 lekë për riparim e pjesë këmbimi për automjetin Toyota përbën dëm ekonomik në shumën 1,374,000 lekë*. Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 8 /5, neni 12, me ligjin nr.9643 “Për prokurimin publik” neni 1/2/a,b, me UMF nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aseteve në sektori publik” 34, 35, 36, 37 *me pasojë dëmi ekonomik në shumën 2,199,400 lekë* (Trajtuar hollësisht në faqet 10-67 të Raportit të Auditimit).

5.5.1-Rekomandimi: Bashkia Kukës të marrë masat dhe të ndjekë procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e shumës **2,199,400 lekë**, përkatësisht nga:

1-z.K **Gj** ish/Kryetar Komune shuma **1,099,700 lekë**.

2-z.I **D** ish-P/Finance shuma **1,099,700 lekë**.

Menjëherë

6.6-Gjetje nga auditimi: Nga ish/Komuna Bushtricë me Urdhër-shpenzimin nr.83, datë 09.08.2013 është bërë pagesë në shumën 457,600 lekë OE “K” shpk në bazë të kontratës nr.1, datë 25.01.2013 për blerje kancelerie të faturave të prapambetura nr.59, datë 12.11.2012 në vlerën 250,500 lekë me fletë-hyrjen nr.16 datë 11.08.2013 dhe faturën nr.66 datë 25.11.2012 në vlerën 207,100 lekë të bërë hyrje me fletë-hyrjen nr.17 datë 11.08.2013. Pra kontrata është lidhur 2 muaj pas faturës së furnitorit. Sipas ditarit të magazinës daljet janë kryer me fletë-daljet nr.7 datë 11.08.2013 pa përcaktuar destinacionin. Faturat janë bërë hyrje me vonesë rreth 9 muaj dhe dy ditë pas pagesës, ndërkohë që këto mallra janë konsumuar pa u bërë hyrje-dalje në magazinë. Këto mallra duke qenë në sasi të konsiderueshme, duhet të evidentoheshin me listë-shpërndarje në mënyrë që të dokumentohej destinacioni i tyre. Veprimet e magazinimit pas konsumit pa destinacion dhe 9 muaj vonesë janë fiktive në mospërputhje me ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” neni 4/26, neni 9/4, neni 12/3 me UMF nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aseteve në sektorin publik” pika 37, 42, 53, 54 me pasojë *dëmi ekonomik në shumën 457,600 lekë*. (Trajtuar hollësisht në faqet 10-67 të Raportit të Auditimit).

6.6.1-Rekomandimi: Bashkia Kukës të marrë masat dhe të ndjekë procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e shumës **457,600 lekë** nga z.I **D** ish P/Finance, në cilësinë nëpunësi zbatues.

Menjëherë

7.7-Gjetje nga auditimi: Nga ish-Komuna Shishtavec në 3 raste në procedurat e prokurimit me vlera të vogla për blerje mallrash dhe shërbimesh u konstatuan mangësi si: Në praktikën e blerjes me urdhër-shpenzimin nr.111 datë 16.06.2015 objekti i prokurimit nuk përputhet me ftesën për ofertë për një zë punimesh “rilevim i hapësirave të gjelbërta 360 m²” në vlerën 252,000 lekë, në blerjen e kryer me urdhër-shpenzimin nr.88 datë 26.05.2015 është përballuar kostoja në shumën 50,000 lekë e defektit të pompës kartepilar të fadromës të blerë 4 muaj më parë pa garanci, si dhe në blerjen e kryer me urdhër-shpenzimin nr.110 datë 16.06.2015 është përballuar shpenzimi për zërin e punimeve për mirëmbajtje rrugë të komunës: “Rrafshim dhe nivelim me fadromë orë 21 x 5100lekë/ora” në shumën 107,100 lekë, kur vetë komuna disponon fadromë në funksionim. Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar neni 1, neni 3/9, neni 23/4; me Urdhrin MF nr. 57 datë 12.06.2014 “Për Gjurmët standarde të auditit për prokurimin me vlerë të vogël dhe të lartë” tabela 1/3; VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 40; Udhëzimin e APP nr. 2, datë 28.03.2013 dhe nr.3 datë 27.01.2015 “Për procedurë prokurimit vlera të vogla” **me pasojë demi ekonomik në shumën 409,100 lekë.** (Trajtuar hollësisht në faqet 10-67të Raportit të Auditimit).

7.7.1-Rekomandimi: Bashkia Kukës të marrë masat dhe të ndjekë procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e shumës **409,100 lekë** përkatësisht nga;

1-z.D. N ish-K/Komune shuma **204,550 lekë.**

2-z.R. B ish-P/Finance shuma **204,550 lekë.**

Menjëherë

8.8-Gjetje nga auditimi: Nga ish-Komuna Bicaj janë kryer në 2 raste pagesash për shërbimin e pastrimit të mbetjeve urbane, OE fitues i prokurimit “S B”.

A. Në rastin e parë me urdhër-shpenzimin nr.301 datë 12.12.2014 në shumën 976,000 lekë në bazë të kontratës nr.2 datë 05.06.2014 me objekt: “Shërbime pastrimi, transporti,grumbullimi dhe sitemimi i mbetjeve urbane në fshatrat e Komunës Bicaj, fshati Canaj ,Nangë, Osmanaj” me vlerë 1,480,000 lekë pa TVSH, me afat deri me 30.04.2015 dhe dy situacione: 1. Tetor-Nentor 2014 në vlerën 272,000 lekë dhe 2 dhjetor 2014 - prill 2015 në vlerën 704,000 lekë. Në këtë praktikë u paraqitën parregullsi si:

-Fondi limit nuk është i argumentuar si në sasi dhe cmim, pasi NJHDT nuk ka paraqitur dokument se si janë përlloritur sasi të km të largësive fshat-venddepozitim, ditët e punës dhe kg e klorifikimit si dhe analizat e cmimeve për to.

-Situacionet e faturuara nuk janë referuar preventivit të ofertës në përcaktimin e zërave të punimeve, por janë ndryshuar njësitë dhe cmimet për njësi, duke vendosur njësi matëse në ton mbeturina dhe copë kazanësh me cmime të tjera në kundërshtim me nenin 10 “Preventiv” të kontratës.

-Mbikqyrja e shërbimit të pastrimit nuk është kryer sipas një grafiku dhërbimi ditor, (gjë që i mungon edhe kontratës) dhe evidentuar me relacion mujor, por janë hartuar procesverbale fiktive në datën e përfundimit të kontratës, i cili nuk vërteton punën e kryer.

-Pagesa është kryer 4.5 muaj paradhënie në vlerën 633,600 lekë në kundërshtim me kontratën neni 12 “Situacionet” pika 12.2 dhe neni 13 “pagesat”.

B. Në rastin e dytë me urdher-shpenzimi nr.87 datë 28.04.2015 ne vlerën 399,600 lekë është kryer pagesë në bazë të kontratës së shërbimit nr.2 datë 28.04.2015 me vlerë 399,600 lekë me TVSH, me afat deri me 31.07.2015. Edhe në këtë praktikë, mbikqyrja është dokumentuar me procesverbal fiktiv në datën e përfundimit të kontratës, i cili nuk vërteton punën e kryer, si dhe është bërë pagesa paradhënie 3 muaj para se të kryhej shërbimi në vlerën 333,600 lekë, në kundërshtim me kontratën neni 5 “pagesa” dhe neni 6 “Marrja ne dorezim e shërbimeve”.

Këto veprime janë në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin rregullave të prokurimit publik” Kreu II pika 2, Kreu VIII , pika 1/(d),2/a,b, me kontratat e lidhura të shërbimit, me ligjin nr.8094, datë 21.03.1996“Për largimin publik të mbeturinave”neni 14, dhe me UMF nr.2, datë 6.2.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit ”pika 147, me ligjin nr. 10296, datë 8.07.2010 “Per Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” neni 4/26,neni 9/4, neni 12/3,

me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aseteve në sektorin publik”, pika 61 *me pasojë dëmi ekonomik në shumën 967,200 lekë.* (Trajtuar hollësisht në faqet 10-67 të Raportit të Auditimit).

8.8.1-Rekomandimi: Bashkia Kukës të marrë masat dhe të ndjekë procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e shumës **967,200 lekë** përkatësisht nga:

1. z.A. K. ish-K/Komune, në cilësinë e kryetarit të AK e NA shumën **193,440 lekë**
2. z.I. M. ish-P/Finance, në cilësinë e nëpunësit zbatues shumën **193,440 lekë.**
3. z.Y. G. ish-specialist shërbimesh, si anëtar komis. mbikq. shumën **193,440 lekë.**
4. z.B. H. ish-mirëmbajtës, si anëtar komis. mbikqyrjes shumën **193,440 lekë.**
5. z.A. G. ish-teknik Komune, si anëtar i komis. mbikqyrjes shumën **193,440 lekë.**

Menjëherë

9.9-Gjetje nga auditimi: Nga ish/Komuna Malzi është kryer pagesë në 1 rast shuma 310,000 lekë me urdhër-shpenzimet nr.176 datë 19.12.2014 me objekt: Punime dhe riparime të shkollave, Komuna Malzi” me procedurën e prokurimit me vlera të vogla në mënyrë elektronike, ku KPVV ka skualifikuar ofertën më ekonomike të klasifikuar në vendin e parë prej 250,000 lekë nga sistemi elektronik i APP dhe ka kualifikuar ofertën më të lartë në vlerën 310,000 lekë të klasifikuar në vendin e pestë, pa argumentuar me procesverbal dhe me korespondencën me mesazhe në sistem me OE pjesëmarrës në konkurim, në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” Kreu i VI pikës 2/a, Udhëzimin e APP nr. 2, datë 28.03.2013 “Për procedurën e prokurimit me vlera të vogla”, me Urdhrin MF nr. 57, datë 12.06.2014 “Për Gjurmët standarte të auditit për prokurimin me vlerë të vogël dhe të lartë” tabela 1/3, *me pasojë dëmin ekonomik në shumën 60,000 lekë.* (Trajtuar hollësisht në faqet 10-67 të Raportit të Auditimit).

9.9.1-Rekomandimi: Bashkia Kukës të marrë masat dhe të ndjekë procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e shumës **60,000 lekë** në mënyrë solidare nga KPVV përkatësisht nga:

- 1-z.L. A. ish-P/Finance shuma **20,000 lekë.**
- 2-z.H. I. anëtar shuma **20,000 lekë.**
- 3-z.O. L. anëtar shuma **20,000 lekë.**

Menjëherë

10.10-Gjetje nga auditimi: Nga ish-Komuna Ujmisht për vitin 2013 janë bërë 4 pagesa në shumën 480,000 lekë me objekt shpenzimi: “Blerje dru zjarri 160 m³ x 3000 lekë/m³ për shkollat e Komunës Ujmisht për vitin 2013” dhe faturës nr.16, datë 29.01.2013, ku mungojnë fletë-hyrjet dhe daljet e magazinës. Në 3 raste urdhër-shpenzimet janë shoqëruar nga vërtetimet e hartuara nga komisioni për marrje në dorëzim të 14.6m³, 15m³, 65m³ dru zjarri. Ndërsa për urdhër/shpenzimi 4 nuk është paraqitur asnjë vërtetim për marrjen në dorëzim 65.4m³ dru zjarri nga komuna në vlerën 196,000 lekë.

Po me urdhër-shpenzimi nr.55, datë 20.04.2015 është bërë pagesë në shumën 200,000 lekë OE “Gj.” për blerjen dru zjarri 59.2m³ x 3378lekë/m³ në bazë të faturës nr.37, datë 20.04.2015 në mungesë të argumentimit të nevojës së blerjes dhe fondit limit. Për këtë mall nuk është prerë hyrje-dalje në magazinë. Ky mall në këtë kohë është i panevojshëm, për arsye se ka mbaruar periudha e dimrit dhe është në përfundim periudha e shkollës. Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar neni 1, neni 3/9, neni 23/4; UMF nr.30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aseteve në sektorin publik” pika 35,36,37,38, 42,43 dhe 44,52,54 me VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin rregullave të prokurimit publik” neni 40, *me pasojë dëmi ekonomik në shumën 396,000 lekë.* (Trajtuar hollësisht në faqet 10-67 të Raportit të Auditimit).

10.10.1-Rekomandimi: Bashkia Kukës të marrë masat dhe të ndjekë procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e shumës **396,000 lekë** përkatësisht nga:

- 1-z.A. D. ish-K/Komune shuma **198,000 lekë.**
- 2-z.I. D. ish-P/Finance shuma **198,000 lekë.**

Menjëherë

11.11-Gjetje nga auditimi: Nga ish/Komuna Ujmisht janë kryer shpenzime për riparim të automjetit kamion tip “Fiat Iveco ACL-75” në 4 raste në shumën 574,600 lekë, për periudhën kohore 7 mujore nga 01.11.2014 - 26.06.2015. Në dy raste të vitit 2015 në vlerën 199,700 lekë është tejkaluar blerja e shërbimeve dhe pjesëve të këmbimit me procedurën e prokurimit sipas formatit 5 me vlerë nën 100,000 lekë. Sipas procesverbalit nr.1, të datës 27.12.2015, të hartuar nga komisioni i Bashkisë për marrjen në dorëzim dhe vlerësimin teknik të automjeteve të NJA Ujmisht, ky mjet rezulton në gjendje jashtë funksionit dhe është transportuar me karrotrec nga NJA në vend grumbullimi pranë Bashkisë Kukës. Kryerja e shpenzimeve për një aktiv që është jashtë funksionit si dhe me procedurë të pa rregullt prokurimi është në kundërshtim me ligjin nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar neni 1/b dhe 12/a me ligjin nr.10296, datë 8.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” neni 4/26, neni 9/pika 4/ë, neni 11/pika 4 dhe neni 12/ pika 3, gërmat (dh,e,f), pika 23/g, f rubrika “Dokumentimi i lëvizjeve të aktiveve” pika 35, 36-40, me VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin rregullave të prokurimit publik” neni 40, **me pasojë dëmin ekonomik në shumën 574,600 lekë.** (Trajtuar hollësisht në faqet 10-67 të Raportit të Auditimit).

11.11.1-Rekomandimi: Bashkia Kukës të marrë masat dhe të ndjekë procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e shumës **574,600 lekë** përkatësisht nga:

1-z.A [REDAKTUAR] D [REDAKTUAR] ish-K/Komune shuma **287,300 lekë.**

2-z.I [REDAKTUAR] D [REDAKTUAR] ish-P/Finance shuma **287,300 lekë.**

Menjëherë

12.12-Gjetje nga auditimi: Nga ish/Komuna Ujmisht me urdhër shpenzimi nr.84, datë 26.06.2015 është bërë pagesë në shumën 72,000 lekë OE “për parkim automjeti (2 vite kalendarike) për 720 ditë x 100 lekë/dita” me urdhër prokurimin nr.13, datë 11.06.2015 dhe faturës nr.99, datë 12.06.2015. Kjo blerje është prokuruar pasi është kryer shërbimi. Shpenzimi nuk është i argumentuar, pasi shërbimi duhej kontraktuar për një periudhë kaq të gjatë. Faturimet dhe pagesa duhet të bëheshin periodike sipas datave të kryerjes së shërbimit, të cilat në fakt nuk janë përshkruar. Këto veprime e bëjnë këtë pagesë të kundraligjshme, pasi dokumentacioni i paraqitur nuk është dokumentacion financiar, që të vërtetojë veprimet e kryera në formën e një prove ligjore për to në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 8.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” neni 4/26, **me pasojë dëmi ekonomik në shumën 72,000 lekë.** (Trajtuar hollësisht në faqet 10-67 të Raportit të Auditimit).

12.12.1-Rekomandimi: Bashkia Kukës të marrë masat dhe të ndjekë procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e shumës **72,000 lekë** përkatësisht nga:

1-z.A [REDAKTUAR] D [REDAKTUAR] ish-K/Komune shuma **36,000 lekë.**

2-z.I [REDAKTUAR] D [REDAKTUAR] ish-P/Finance shuma **36,000 lekë.**

Menjëherë

13.13-Gjetje nga auditimi: Nga ish/Komuna Surroj me urdhër-shpenzim nr.107 datë 05.06.2015 është bërë pagesë në shumën 700,000 lekë OE “B [REDAKTUAR]” shpk me urdhër prokurimin nr.2, datë 09.04.2015 me objekt “Blerje karburant” me fond limit 500,000 lekë. Fatura e furnitorit nr.108, datë 05.06.2015 është prerë për 4000 litra me vlerë pa vsh 583,333 lekë, pra 83,333 lekë mbi fondin limit në mospërputhje me VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 40, **me pasojë dëmi ekonomik shuma 83,333 lekë.** (Trajtuar hollësisht në faqet 10-67 të Raportit të Auditimit).

13.13.1-Rekomandimi: Bashkia Kukës të marrë masat dhe të ndjekë procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e shumës **83,333 lekë** nga KPVV përkatësisht nga:

1-z.F [REDAKTUAR] S [REDAKTUAR] ish-P/Finance shuma **27,778 lekë.**

2-z.N [REDAKTUAR] L [REDAKTUAR] ish-P/Ndihmës e konomike shuma **27,778 lekë.**

3-z.M [REDAKTUAR] L [REDAKTUAR] ish-P/ZMMT e Urbanistikës shuma **27,778 lekë.**

Menjëherë

14.14.Gjetje nga auditimi: Në auditimi në lidhje me zbatimin e VK Komunës për shpërblimin e Kryepaqve të fshatrave rezulton se stafi drejtues ish/Komuna Arrën, nuk ka zbatuar VKK nr.1, datë 17.04.2013, nr, ska, datë 07.10.2014 dhe nr.5, datë 19.05.2015 në masën 8% të pagës së

Kryetarit, ndërkohë që janë shpërblyer me 10% për 30 muaj në vlerën **145,800 lekë, shumë e cila përbën detyrim për tu paguar** nga kryepleqtë e fshatrave (*Trajtuar hollësisht në faqet 10-67 të Raportit të Auditimit*).

14.14.1.Rekomandimi: Të bëhet kontabilizimi dhe të ndiqen të gjitha procedurat ligjore për shpërblimin e dëmit në vlerën **145,800 lekë** nga punonjësit përkatësisht;

- 1-A [REDACTED] D [REDACTED] vlera **29,160 lekë**.
- 2-A [REDACTED] C [REDACTED] vlera **29,160 lekë**.
- 3-z.I [REDACTED] M [REDACTED] vlera **29,160 lekë**.
- 4-H [REDACTED] K [REDACTED] vlera **29,160 lekë**.
- 5-z.A [REDACTED] P [REDACTED] vlera **29,160 lekë**.

Menjëherë

15.15.Gjetje nga auditimi; Në auditimin e dokumenteve të bankës për pagesën e këshilltarëve dhe kryepleqve të ish komunave Topojan, Surroi, Kolsh, Arrën, Shtiqën, Bicaç dhe Bushtricë u konstatua se tatimi mbi shpërblimin (në burim) për 6/mujori parë viti 2015, nuk është llogaritur në nivelin 15% por 10%, veprim në kundërshtim me nenin 28 “shkalla tatimore”, ligji nr.177/2013 “Për disa ndryshime në ligjin nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar, shoqëruar **me dëm ekonomik në buxhetin e shtetit vlera 375,571 lekë**, nga e cila;

1-ish Komuna Topojan vlera **26,400 lekë**.

2-ish Komuna Surroi vlera **18,870 lekë**.

3-ish Komuna Kolsh vlera **21,060 lekë**.

4-ish Komuna Arrën vlera **29,160 lekë**.

5-ish Komuna Shtiqën vlera **30,240 lekë**.

6-ish Komuna Bicaç vlera **41,388 lekë**.

7-ish Komuna Bushtricë vlera **208,453 lekë**.

8-Ish Komuna Bicaç rezulton të mos ketë llogaritur e ndalur tatimin në burim për vitin 2013 vlerën **58,320 lekë**, për vitin 2014 vlerën **96,228 lekë** dhe 6/mujori parë vitit 2015 vlerën **53,905 lekë** (*Trajtuar hollësisht në faqet 10-67 të Raportit të Auditimit*).

15.15.1.Rekomandimi: Bashkia Kukës të marr të gjitha masat, duke ndjekur procedurat ligjore për arkëtimin e vlerës **375,571 lekë** nga personat të evidentuar në anekset (nr.1, 2, 3, 4, 5,6,7 bashkëlidhur Raportit të Auditimit).

Menjëherë

NË ZBATIMIN E KONTRATAVE TË NDËRTIMIT.

Nisur nga gjetjet e konstatuara me shkelje në zbatimin e procedurave të prokurimit dhe në zbatimin e kontratave në punimet e ndërtimit të trajtuara në Raportin Auditimit, nga njësia administrative Bashkia Kukës (**për ish/Komunat**), të merren masa të menjëhershme për të kryer kontabilizimin dhe të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për arkëtimin dhe shpërblimin **e dëmit në buxhetin e bashkisë në shumën totale prej 3.551,882 lekë** në mënyrë analitike sa më poshtë:

16.16.Gjetje nga auditimi: Në objektin “*Rikonstruksion i kanaleve ujitës dhe ujësjellësve, Komuna Malzi*”, Kukës, nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të punimeve të ndërtimit të administruara në dosjen teknike rezultoi një dëm ekonomik në vlerën **481,696 lekë pa tvsh** si pasojë e likuidimit të punimeve të kryera në fakt. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 114 prot., datë 11.07.2014 të lidhur mes Titullarit të Autoritetit Kontraktor për Ish – Komunën Malzi dhe OE “O [REDACTED]”shpk. (*Trajtuar hollësisht në faqet 67-111 të Raportit të Auditimit*).

16.16.1-Rekomandimi: Nga Bashkia Kukës, për ish/Komunen Malzi, të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **481,696 lekë pa tvsh** nga operatori ekonomik “O [REDACTED]”shpk, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën nr.114 prot, datë 11.07.2014 me objekt “*Rikonstruksion i kanaleve ujitës dhe ujësjellësve, Komuna Malzi*”, Kukës, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik

ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore si rrjedhojë e likuidimit të punimeve të pakryera në fakt apo prej mos ndryshimit të zërave në situacion sipas zërit faktit.

Menjëherë

17.17-Gjetje nga auditimi: Në objektin “*Hidroizolim tarrace shkolla Xhaferraj*” Topojan, nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit, mbikëqyrjes dhe kolaudit të punimeve të ndërtimit të administruara në dosjen teknike rezultoi një dëm ekonomik në vlerën **934,986 lekë pa tvsh** si pasojë e likuidimit të punimeve të kryera në fakt. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. - prot., datë 22.12.2014 të lidhur mes Titullarit të Autoritetit Kontraktor për ish Komunën Topojan dhe OE “XH [REDACTED]”shpk. (Trajtuar hollësisht në faqet 67-111 të Raportit të Auditimit).

17.17.1-Rekomandimi: Nga Bashkia Kukës, për ish/Komunën Topojan, të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **934,986 lekë pa tvsh** nga operatori ekonomik “XH [REDACTED]”shpk, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën nr.-, datë 22.12.2014 me objekt “*Hidroizolim tarrace shkolla Xhaferraj*” Topojan, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore si rrjedhojë e likuidimit të punimeve të pakryera në fakt apo prej mos ndryshimit të zërave në situacion sipas zërit faktit.

Menjëherë

18.18-Gjetje nga auditimi: Në objektin “*Mirëmbajtje rrugë komunale*” Topojan, nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit, mbikëqyrjes dhe kolaudit të punimeve të ndërtimit të administruara në dosjen teknike rezultoi një dëm ekonomik në vlerën **2,135,200 lekë pa tvsh** si pasojë e likuidimit të punimeve të kryera në fakt. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. - prot., datë 20.12.2014 të lidhur mes Titullarit të Autoritetit Kontraktor për ish Komunën Topojan dhe OE “XH [REDACTED]”shpk. (Trajtuar hollësisht në faqet 67-111 të Raportit të Auditimit).

18.18.1-Rekomandimi: Nga Bashkia Kukës, për ish/Komunën Topojan, të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **2,135,200 lekë pa tvsh** nga operatori ekonomik “XH [REDACTED]”shpk, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën nr.- prot., datë 20.12.2014 me objekt “*Mirëmbajtje rrugë komunale*”, Topojan, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore si rrjedhojë e likuidimit të punimeve të pakryera në fakt .

Menjëherë

F- Për Njësinë e Auditit të Brendshëm Publik Bashkia Kukës.

Gjatë kryerjes së auditimit, nuk është vënë në dispozicion të KLSH një pjesë e konsiderueshme e dokumentacionit ekonomik dhe financiar të ish-Komunës Arrën Kukës. Disa prej këtyre dokumenteve origjinale kanë ardhur në KLSH pas përfundimit të veprimtarisë audituese në terren, me shkresën nr. 4233, datë 17.11.2017, datë 20.10.2017, si observacione vetëm për procesverbalin nr. 31, duke kufizuar auditimin e kryer. Në këto kushte, bazuar në ligjin nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, nenin 15 shkronjat (i) dhe (f) dhe në nenin 25, **KLSH i rekomandon Njësisë Auditimit të Brendshëm të Bashkisë Kukës**, të kryejë një auditim tematik në ish-Komunën Arrën (aktualisht Njësi Administrative), në të cilin të përfshihet administrimi i **automjetit të blerë më datën 15.11.2001**, sipas kontratës nr. 292, REP. me nr. 41 kol të Dhomës Noterisë Kukës, duke evidentuar përgjegjësitë përkatëse. Mbi rezultatet e këtij auditimi tematik të informohet KLSH^{në} menjëherë pas përfundimit.

Brenda datës 31.01.2019

4.BASHKIA DROPULL:

- Nga verifikimi rezultoi se KLSH ka dërguar në Bashkinë Dropull rekomandimet e auditimit me shkresën e saj nr. 164 datë 30/11/2017 protokolluar në Bashkinë Dropull me shkresën nr. 544/8 datë 05/12/2017, ndërsa nga Bashkia Dropull për zbatim e rekomandimeve të KLSH është kthyer përgjigje me shkresën e saj nr.1745, datë 28/12/2017 protokolluar në KLSH me shkresën

nr. 544/9 datë 05/01/2018. Pra përgjigja e Bashkisë për zbatimin e rekomandimeve të KLSH është bërë brenda afatit ligjor të kthimit të përgjigjes. Për zbatimin e rekomandimeve të KLSH nga Bashkia Dropull është hartuar Plan Veprimi dhe janë ngarkuar personat për zbatimin e rekomandimeve me afate konkrete.

- Nga verifikimi rezulton se përfundimet e auditimit i janë dërguar subjektit të audituar Bashkisë Dropull, me shkresën e Kryetarit të KLSH nr. 544/8 datë 05/12/2017 dhe duhet të raportonte në KLSH brenda 6 muajve ose brenda datës 05/06/2018 Ndërkohë nga Bashkia Dropull nuk është raportuar brenda afatit .

A. MASA ORGANIZATIVE:

Nga KLSH janë rekomanduar Bashkisë Dropull 7 masa organizative, janë zbatuar plotësisht 4 masa, janë në proces zbatimi 2 masa dhe nuk është zbatuar 1 masë organizative për të cilën rikërkojmë zbatimin si vijon:

1.7. Gjetje nga auditimi: Nga Bashkia Dropull, nuk janë zbatuar plotësisht masat e rekomanduara të rikërkua me shkresën nr. 1015/55 prot., datë 05.04.2016 të Kontrollit të Lartë të Shtetit, duke mos u zbatuar plotësisht 4 masa për shpërbllim dëmi në vlerën 2,824,433 lekë (Trajtuar më hollësisht në faqet nr. 16 -22 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.7.1.Rekomandimi: Nga Bashkia Dropull të merren masa për zbatimin e plotë të masave të rekomanduara dhe të pa realizuara apo në proces zbatimi deri më datën 24.07.2017 të cilat janë dërguar me shkresën nr. 1015/55 prot, datë 05.04.2016 të Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe përshkruara në akt verifikimin nr.1 datë 24.06.2017 “Mbi auditimin e zbatimit të rekomandimeve..”, dorëzuar në zyrën e protokollit të Bashkisë Dropull më datën 24.06.2017.

Menjëherë

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI:

Nga verifikimi rezultoi se nga vlera e rekomanduar nga KLSH prej..... **4,988,342** lekë
-Deri më datën 31.12.2017 është arkëtuar vlera 308.800 lekë prandaj dhe kontabilizimi është bërë për vlerën.....4.679.542 lekë.
Deri në dt.30.09.2018janë arkëtuar 1.987.734 lekë
Kanë mbetur pa u arkëtuar vlera prej3,000,608 lekë

Nga të cilat:

-Në proces arkëtimi 2 rekomandime në vlerën..... 664,643 lekë
-Në proces gjyqësor një rekomandim në vlerën.....1.678.505 lekë
-Janë nisur njoftimet për 4 rekomandime por ende nuk kanë filluar arkëtimet.....1.260.032 lekë
-Janë fituar me gjyq një rekomandim me vlerën..... 82.071 lekë

Në mënyrë të detajuar për masat shpërbllim dëmi rikërkojmë si më poshtë:

1.2. Gjetje nga auditimi: Nga ish komuna Pogon janë kryer pagesa për shpenzime të telefonisë celulare, për ish kryetarin e Komunës, z.Th [REDAKTUAR] Q [REDAKTUAR], në kundërshtim me specifikimet e miratuara në kategorizimet e nivelit të pagave sipas lidhjeve nr.1-6, si dhe pikës 11 të VKM nr.864, datë 23.7.2010 “Për pajisjen me numër telefoni celular të personave juridikë, publikë”, në **vlerën 119,067 lekë** e cila përben dëm ekonomik në të ardhurat e bashkisë (Trajtuar më hollësisht në faqet nr. 48-66 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.2.1.Rekomandimi: Zyra e Financës në Bashkinë Dropull të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **119,067 lekë**, nga ish kryetari i Komunës Pogon z. Th [REDAKTUAR] [REDAKTUAR] pagesa të kryera për telefonin celular.

Menjëherë

2.3. Gjetje nga auditimi: Nga ish komuna Pogon janë kryer pagesa për shpenzime udhëtimi e dieta për ish Kryetarin e Komunës, z.Th [REDACTED] Q [REDACTED], në kundërshtim me kërkesat e VKM nr. 997, datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit, i ndryshuar, në vlerën **9,000 lekë** e cila përben dëm ekonomik në të ardhurat e bashkisë (*Trajtuar më hollësisht në faqet nr. 48-66 të Raportit të Auditimit*).

2.3.1.Rekomandimi: Zyra e Financës në Bashkinë Dropull të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **9,000 lekë**, nga ish kryetari i Komunës Pogon z. Th [REDACTED] Q [REDACTED], pagesa të kryera për udhëtim e dieta.

Menjëherë

3.4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit dhe mbikëqyrjes të punimeve të ndërtimit të administruara në dosjen teknike si dhe nga verifikimi në terren të punimeve për objektin “**Masa Mbrojtëse te Ura në Fshatin Likomil**”, Bashkia Dropull, rezultuan diferenca në vlerën 122,117 lekë pa tvsh, që i takon punimeve të pakryera. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën për mbikëqyrjen e punimeve lidhur me Autoritetit Kontraktor Bashkia Dropull dhe mbikëqyrësit të punimeve ing. Iris Lani (*Trajtuar më hollësisht në faqet nr. 66-97 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

3.4.1.Rekomandimi: Nga Bashkia Dropull të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **122,117 lekë pa tvsh** nga OE “T [REDACTED]” Shpk, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën nr. - prot., datë 11.12.2015 me objekt “Masa Mbrojtëse te Ura në Fshatin Likomil”, Bashkia Dropull, vlerë kjo e cila përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore si rrjedhojë e situacionimit dhe likuidimit të punimeve të pakryera.

Menjëherë

4.5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit dhe mbikëqyrjes të punimeve të ndërtimit të administruara në dosjen teknike si dhe nga verifikimi në terren të punimeve për objektin “Ndërtimi i Tubacionit të Ujit të Pijshëm Goricë-Terihat-Sofratikë dhe rikonstruksioni i Rrjetit të Fshatit Dervician”, ish-Komuna Dropull i Poshtëm, Dropull, rezultuan diferenca në vlerën **1,678,505 lekë pa tvsh**, që i takojnë punimeve të pakryera. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën për mbikëqyrjen e punimeve lidhur me Autoritetit Kontraktor ish-Komuna Dropull i Poshtëm dhe mbikëqyrësit të punimeve ing. G [REDACTED] M [REDACTED] (*Trajtuar më hollësisht në faqet nr. 66-97 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

4.5.1.Rekomandimi: Nga Bashkia Dropull të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **1,678,505 lekë pa tvsh** nga OE “N [REDACTED]” Shpk, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën nr. 314 prot., datë 15.05.2013 me objekt “Ndërtimi i Tubacionit të Ujit të Pijshëm Goricë-Terihat-Sofratikë dhe rikonstruksioni i Rrjetit të Fshatit Dervician”, ish-Komuna Dropull i Poshtëm, Dropull, vlerë kjo e cila përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore si rrjedhojë e situacionimit dhe likuidimit të punimeve të pakryera.

Menjëherë

5.6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i taksave dhe tarifave vendore për vitin 2016 u konstatua se nuk janë arkëtuar detyrimet për taksat vendore të subjekteve të biznesit të madh të biznesit të vogël në vlerën totale **574,270 lekë dëm ekonomik, përkatësisht:**

-përlllogaritje jo e saktë dhe mosarkëtim i detyrimit për taksat vendore të subjekteve të biznesit të madh në vlerën 368,820 lekë,

-përlllogaritje jo e saktë dhe mosarkëtim i detyrimit për taksat vendore të subjekteve të biznesit të vogël në vlerën 205,450 lekë,

Veprime këto në shkelje të ligjit nr. 9920, datë 19.04.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” (*Trajtuar më hollësisht në faqet nr. 97-102 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

5.6.1.Rekomandimi: Bashkia Dropull, Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **574,270 lekë**, sipas Aneksit nr. 7/1 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

6.7. Gjetje nga auditimi: Nga zyra e planifikimit dhe zhvillimit të territorit, nuk është llogaritur saktë taksa e ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet e reja, nuk është kryer përlllogaritja në bazë të çmimit referencë që është kosto mesatare e ndërtimit sipas Entit Kombëtar të Banesave, në shkelje të ligjit nr. 107, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, të ndryshuar neni 46, për 4 subjekte **në vlerën 2,077,807 lekë, dëm ekonomik**, në të ardhurat e buxhetit të Bashkisë (*Trajtuar më hollësisht në faqet nr. 102-118 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

6.7.1.Rekomandimi: Bashkia Dropull, Zyra e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtimin nga 4 persona të vlerës **2,077,807 lekë**, sipas Aneksit nr.8/1 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Menjëherë

7.8. Gjetje nga auditimi: Nga Zyra e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, nuk është vepruar për të krahasuar vlerën e punimeve të preventivit me vlerën e punimeve të situacionit, mbi të cilën është përlllogaritur taksa e ndikimit në Infrastrukturë, për lejet e shfrytëzimit të objekteve, ku ka rezultuar diferenca në taksën e ndikimit në infrastrukturë, në shkelje të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar neni 13 dhe Udhëzimit të KM nr.3 datë 15.2.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit, ndryshuar kapitulli II, pika 3, **në vlerën 325,505 lekë, vlerë që përbën të ardhur të munguar në Buxhetin e Bashkisë** (*Trajtuar më hollësisht në faqet nr. 102-118 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

7.8.1.Rekomandimi: Nga Bashkia Dropull, të merren masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **325,505 lekë**, sipas Aneksit nr.8/2, bashkangjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Menjëherë

C. MASA DISIPLINORE:

Mbështetur në ligjin “Për statusin e Nëpunësit Civil”, neni 37, të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Kontratën individuale të punës, i rikërkohet Kryetarit të Bashkisë, fillimin e procedurës për dhënien e masës disiplinore si më poshtë:

C.1. Për punonjësit që janë pjesë e shërbimit civil.

Në mbështetje të shkronjës (c) neni 15 -*Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së* të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, në zbatim të nenit 58, “*Ilojet e masave disiplinore*” të ligjit nr. 152/2013 datë 30.5.2013 “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil” i **KLSH i ka rekomanduar** Kryetarit të Bashkisë Dropull, që t’i kërkojë Komisionit disiplinor fillimin e procedurave për dhënien e masës disiplinore, “*Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet*”, *parashikuar në neni 58 shkronja “c”, për 4 punonjës. Nga verifikimi rezultoi se këto masa nuk janë zbatuar, prandaj i kërkojmë* Kryetarit të Bashkisë Dropull, që ti rikërkojë Komisionit disiplinor fillimin e procedurave për dhënien e masës disiplinore **për 4 punonjësit e mëposhtëm:**

- 1.z. L [REDAKTUAR] K [REDAKTUAR] me detyrë specialist në Drejtorinë e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit,
2. z. N [REDAKTUAR] P [REDAKTUAR] Përgjegjës i Zyrës së Sektorit të Pyjeve, Kullotave Bordit të Kullimit
3. znj. A [REDAKTUAR] K [REDAKTUAR] N/Kryetare e Bashkisë, në cilësinë e Kryetares KVO
4. znj. Th [REDAKTUAR] P [REDAKTUAR], me detyrë Përgjegjëse e sektorit Ekonomik, në cilësinë e Anëtarit KVO

Menjëherë

5.BASHKIA FINIQ:

-Nga verifikimi rezulton se KLSH ka dërguar në Bashkinë Finiq rekomandimet e auditimit me shkresën e saj nr 494/21 datë 09.11. 2017, protokolluar në Bashkinë Finiq me shkresën nr. 13881/7 prot. datë 26.02.2018 , ndërsa nga Bashkia Finiq për zbatim e rekomandimeve të KLSH nuk është kthyer përgjigje.

Nga verifikimi rezulton se përfundimet e auditimit i janë dërguar subjektit të audituar Bashkisë Finiq, me shkresën e Kryetarit të KLSH nr. 494/21 datë 09.11.2017 dhe duhet të raportonte në KLSH brenda 6 muajve ose brenda datës 09.05.2018. Ndërkohë nga Bashkia Finiq nuk është raportuar brenda afatit .

-Nga verifikimi rezulton se edhe pse Bashkia Finiq ka hartuar planin e veprimit të zbatimit të rekomandimeve të dërguara nga KLSH me shkresën nr 494/21prot., datë 09.11.2017, ndërkohë nuk ka raportuar rregullisht në këshillin e njësisë (Këshillin Bashkiak), në kundërshtim me ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Neni 50-Auditimi i jashtëm ku përcaktohet se; 5. Për të gjitha raportet e auditimit të jashtëm, të kryera nga Kontrolli i Lartë i Shtetit apo auditues të tjerë ligjorë, kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore përgatit një plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve të raportit të auditimit dhe raporton rregullisht në Këshillin e njësisë.

A. MASA ORGANIZATIVE:

Nga KLSH i janë rekomanduar Bashkisë Finiq 17 masa organizative, janë zbatuar plotësisht 5 masa, janë në proces zbatimi 4 masa dhe ka 8 masa organizative të pazbatuara, për të cilat KLSH, kërkon zbatimin e plotë të tyre si më poshtë:

1.2. Gjetje nga auditimi: Ish-Komuna Finiq, është penalizuar nga gjykata për largime nga puna të punonjësve, në kundërshtim me nenet 153 dhe 154 të ligjit nr. 7961, datë 11.7.1995 “Kodi i Punës së Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, dhe me pikën 62 të UMF nr. 2 datë 06.2.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, duke rënduar padrejtësisht shpenzimet e institucionit në vlerën **4,071,844 lekë** (nga kjo vlerë është hequr dore me marrëveshje nga znj.Olta Cani për shumën 1,220,904 lekë pra e pa ekzekutuar, duke e ulur vlerën e dëmshpërblimit në vlerën **2,850,940 lekë**) (Trajtuar në faqet 39-43 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.2.1Rekomandim: Bashkia Finiq, të nxjerrë përgjegjësit për ndërprerjen e marrëdhënieve financiare të punonjësve, pa shkaqe të argumentuara dhe të pambështetura në dispozitat ligjore në fuqi, pasi për shkak të këtyre veprimeve, institucioni detyrohet të ekzekutojë vendime gjyqësore në vlerën **2,850,904 lekë nga e cila është paguar deri më tani 2,187,404 (Mbetur pa u likuiduar 663,500 lekë përkatësisht: V [] P [] për vlerën 237,000 lekë, Ll [] G [] 60,400 lekë, O [] C [] 243,200 leka (1,464,104-1,220,904 lekë), dhe Gj [] I [] 122,900 lekë).**

Menjëherë

2.3. Gjetje nga auditimi: Nga të ardhurat e tatim taksave gjatë auditimit rezultoi se për vitin 2013, në total janë realizuar 48,413 mijë lekë, në vitin 2014, gjithsej 47,683 mijë lekë, në vitin 2015 gjithsej 36,247 mijë lekë dhe në vitin 2016 gjithsej janë realizuar në shumën 52,920 mijë lekë ose 65%. Treguesit paraqesin një performancë të ulët të administratës fiskale me ndikim në realizimin e të ardhurave, si pasojë edhe i mos përfshirjes në paketën fiskale të tarifës për dhënien me qira të tokave bujqësore, kullotave dhe pyjeve.

Nga Drejtoria e Tatim Taksave nuk janë arkëtuar **12,540 mijë lekë**, që i përket tarifave vendore dhe taksës së biznesit të vogël të trashëguar ndër vite, në kundërshtim me ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore”, i ndryshuar, neni 114, “Mospagimi në afat i detyrimit tatimor apo kontributit” dhe UMF nr. 24, datë 02.09.2008 “Për Procedurat Tatimore” (Trajtuar në faqet 124-128 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.3.1 Rekomandim: Nga ana e Drejtorisë së Tatim Taksave të Bashkisë në bashkëpunim me Sektorin Juridik dhe Policinë e Bashkisë si dhe Drejtorinë e Financës, të merren masa në zbatim

të procedurave ligjore, për arkëtimin e vlerës **12,540 mijë lekë**, për subjektet debitorë të biznesit të vogël dhe të madh, si dhe të përfshihen në paketën fiskale të gjitha llojet e taksave, duke bërë një parashikim sa më real të tyre.

Menjëherë

3.4. Gjetje nga auditimi: Bashkia Finiq (Zyra Financës), nuk ka zbatuar procedurat ligjore për arkëtimin e detyrimeve debitorë sipas bilancit kontabël të mbartura nga vitet e mëparshme në vlerën **20,732,201 lekë**, veçanërisht për taksën e Tokës Bujqësore (*Trajtuar në faqet 119-138 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

3.4.1 Rekomandim: Drejtoria e Tatim Taksave të Bashkisë, në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës, Sektorin Juridik dhe Policinë Bashkiake, të marrë masa në zbatim të procedurave ligjore, për arkëtimin e vlerës **20,732,201 lekë**, për subjektet debitorë të paraqitur në bilancin e vitit 2016.

Menjëherë

4.5. Gjetje nga auditimi: Bashkia Finiq nuk ka marrë në evidencë kontabile dhe nuk ka paraqitur në bilance, duke mos trashëguar në bilancin e vitit 2015 dhe 2016, detyrimet që rrjedhin nga taksa e pa paguar e popullatës, taksa e tokës, ndërtesës etj. në vlerën prej **51,729 mijë lekë** (*Trajtuar në faqet 20-67 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

4.5.1 Rekomandimi: Drejtoria e Tatim Taksave të Bashkisë në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës, të marrë, për arkëtimin e vlerës **51,729 mijë lekë**, për të gjithë subjektet debitorë të paraqitur në bilancin e vitit 2016.

Menjëherë

5.7. Gjetje nga auditimi: Gjatë vitit 2013 nga ish Komuna Finiq, janë lidhur 29 Kontrata qiraje për tokat bujqësore të pandara, ndërsa nga ish Komuna Mesopotam, 208 Kontrata qiraje, kontrata të cilat kanë rezultuar në kundërshtim me nenin 678 e vijues të Kodit Civil, dhe VKM nr. 531, datë 21.8.1998 “Për tokat bujqësore të pandara”, i ndryshuar, si dhe UKM nr. 3, datë 16.5.2007 “Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore, të pandara”, akt i shfuqizuar me hyrjen në fuqi të UKM nr. 1, datë 18.7.2012 “Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara” (*Trajtuar në faqet 134-136 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

5.7.1 Rekomandim: Bashkia Finiq, pas shqyrtimit dhe vlerësimit të secilës nga praktikat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara, referuar dhe në konstatimin e grupit të auditimit të KLSH-së, ti paraqesë Këshillit Bashkiak projektvendimin përkatës lidhur me vijueshmërinë ligjore të praktikave të qirasë të cilat mund të konfirmohen si të dala në zbatim të ligjit. Konfirmimi i kontratave të bëhet duke respektuar afatet kohore të sanksionuara nga Kodi Civil.

Menjëherë

6.8. Gjetje nga auditimi: Nga ish-komuna Finiq, më datë 01.10.2013 është realizuar kontrata e shitjes të sipërfaqes së tokës prej 2250 m², me palë blerëse P████ P████. Çmimi i tokës rezulton në vlerën prej 320 lekë/m² ose 720.000 lekë dhe është referuar në VKM nr. 312, datë 30.06.1994 “Për çmimin e truallit që shitet dhe për qiranë e truallit që u jepet në përdorim për ndërtime personave fizike e juridike” dhe vendimit të KRRT Delvinë nr. 194, datë 30.05.1996. Qëllimi i përdorimit rezulton “Magazinë dhe dyqan sipas studimit dhe azhurnimit urbanistik zona C”, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 8652, datë 31.7.2000 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Qeverisjes Vendore”, ligjin nr. 7980, datë 27.7.1995 “Për shitblerjen e trojeve”, ligjin nr. 10270, datë 22.4.2010 “Për të Drejtën e Privatizimit të Truallit Shtetëror në Përdorim dhe për Taksën mbi të Drejtën e Përdorimit të tij”, dhe VKM nr. 738, datë 08.09.2010 “Për përcaktimin e kriterëve dhe të procedurave të shitjes së trojeve në përdorim, sipërfaqe të domosdoshme dhe shtesë funksionale të ndërmarrjeve, shoqërive apo të objekteve shtetërore, të veçuara, të privatizuara dhe të ndërtesave të ndërtuara në bazë të lejeve të ndërtimit” (*Trajtuar në faqet 163-155 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

6.8.1 Rekomandim: Bashkia Finiq, pas shqyrtimit dhe vlerësimit të praktikës të shitjes të tokës, referuar dhe në konstatimin e grupit të auditimit të KLSH-së, ti paraqesë Këshillit Bashkiak projektvendimin përkatës lidhur me vijueshmërinë ligjore të praktikës.

Menjëherë

7.9. Gjetje nga auditimi: Nga ish-komuna Finiq, gjatë vitit 2003, u janë shitur subjekteve të ndryshme 100 parcela toke me sipërfaqe 10 ha, për realizimin e investimeve, sipas studimit urbanistik mbi zonën industriale Vriion, Zona A, miratuar me Vendim të KRRT Delvinë nr. 99, datë 12.02.1996. Kontratat e shitjes janë realizuar në 83 raste dhe janë referuar në VKM nr. 312, datë 30.06.1994 “Për çmimin e truallit që shitet dhe për qiranë e truallit që u jepet në përdorim për ndërtime personave fizike e juridike”, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 8652, datë 31.7.2000 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Qeverisjes Vendore”, ligjin nr. 7980, datë 27.7.1995 “Për shitblerjen e trojeve”, ligjin nr. 10270, datë 22.4.2010 “Për të Drejtën e Privatizimit të Truallit Shtetëror në Përdorim dhe për Taksën mbi të Drejtën e Përdorimit të tij”, dhe VKM nr. 738, datë 08.09.2010 “Për përcaktimin e kriterëve dhe të procedurave të shitjes së trojeve në përdorim, sipërfaqe të domosdoshme dhe shtesë funksionale të ndërmarrjeve, shoqërive apo të objekteve shtetërore, të veçuara, të privatizuara dhe të ndërtesave të ndërtuara në bazë të lejeve të ndërtimit”(Trajtuar në faqet 164-165 të Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe listës bashkëlidhur).

7.9.1 Rekomandim: Bashkia Finiq, pas shqyrtimit dhe vlerësimit të secilës praktikë të shitjes të tokës, referuar dhe në konstatimin e grupit të auditimit të KLSH-së, ti paraqesë Këshillit Bashkiak projektvendimin përkatës lidhur me vijueshmërinë ligjore të praktikave.

Menjëherë

8.10. Gjetje nga auditimi: Nga ish-Komuna Dhivër me VKK nr. 1, datë 10.04.2013 “Për miratimin e procedurës për rindarjen e tokave bujqësore të pandara të komunës Dhivër”, VKB nr. 1, datë 10.06.2013 “Për miratimin në parim të Planit për Rindarjen e tokave bujqësore të pandara të Komunës Dhivër”, VKB nr. 6, datë 09.10.2013 “Për rindarjen e tokës bujqësore që është e pandarë në të gjitha fshatrat e Komunës Dhivër”, si dhe VKB nr. 7, datë 11.11.2013 “Për rindarjen e tokës bujqësore që është e pandarë në të gjitha fshatrat e Komunës Dhivër”, është miratuar ndarja e tokës për sipërfaqen prej 149354 m², nga e cila: 36 familje bujqësore, në fshatin Llupsat për sipërfaqen prej 26051 m², 10 familje bujqësore, në fshatin Dermish për sipërfaqen prej 19725 m², 6 familje bujqësore, në fshatin Memoraq për sipërfaqen prej 5675 m², 5 familje bujqësore, në fshatin Navaricë për sipërfaqen prej 19366 m², 2 familje bujqësore, në fshatin Rumanxa për sipërfaqen prej 38845 m², 5 familje bujqësore dhe në fshatin Shendrerë për sipërfaqen prej 29958 m², 10 familje bujqësore, procedura të realizuara pa zbatuar VKM nr. 253, datë 06.3.2013 “Për përcaktimin e procedurave të plotësimit të akteve të marrjes së tokës bujqësore në pronësi për familjet bujqësore në fshatrat e ish -kooperativave bujqësore”.

Komuna Dhivër nuk ka qenë në kushtet e zbatimit të akteve të sipërcituara përsa nuk ka asnjë dokumentacionin mbi normën për frymë të caktuar gjatë procesit të ndarjes së tokës në vitin 1991-1992, nuk ka kopje të AMTP-ve në Përdorim të marra nga përfituesit të cilët të kenë kërkuar kalimin e tyre në pronësi, nuk kanë dokumentacionin mbi tokën bujqësore të pandarë, nuk kanë dokumentacionin mbi tokën bujqësore të refuzuar, nuk kanë dokumentacionin mbi familjet të cilat kanë pranuar të marrin asistencën sociale duke mos pranuar pajisjen me tokë bujqësore, nuk ka kopje të formularit nr. 6 etj (Trajtuar në faqet 165-166 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

8.10.1 Rekomandim: Bashkia Finiq, pas shqyrtimit dhe vlerësimit rast pas rasti të gjitha praktikave të ndarjes të tokave bujqësore të pandara, referuar dhe në konstatimin e grupit të auditimit të KLSH-së, t'i paraqesë Këshillit Bashkiak projektvendimin përkatës lidhur me vijueshmërinë ligjore të praktikave të AMTP-ve të cilat mund të konfirmohen si të dala në zbatim të ligjit.

Menjëherë

9.11. Gjetje nga auditimi: Bashkisë Finiq nga ish-Drejtoria e Shërbimit Pyjor Vlorë, me procesverbalin e vitit 2016 i kanë kaluar në administrim 7 kontrata të dhënies me qira të fondit pyjor e kullosor dhe konkretisht:

Subjekti	Kontrata	Vjet	Qellimi përdorimit	sipërfaqe	Vlefëta për vit
S	04, dt 28.06.2001	49	Lokal+lodra	1.5 ha	101475
S	05, dt 28.09.2001	49	Lokal+restorant	0.15 ha	183600
Er	10, dt 05.01.2007	10	Pushim+argëtim	1 ha	99680
K	12, dt 28.09.2007	10	Imb uji pishëm	0.5 ha	48000
I	17, dt 24.02.2009	10	Mbarëshitim flore	2 ha	36000
K	18, dt 28.05.2012	10	Pushim+clodhje	0.3 ha	36000
M	00, dt 20.03.2015	10	Ndërtim linje hec	5.1 ha	309132

Lidhja e Kontratave është referuar në ligjin nr. 7850, datë 29.7.1994 “Kodi Civil”, ligjin nr. 9693, datë 19.3.2007 “Për fondin kullor” dhe ligjin nr. 9385, datë 04.05.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”(Trajtuar në faqet 167-168 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

9.11.1 Rekomandim: Bashkia Finiq, pas shqyrtimit dhe vlerësimit rast pas rasti të gjitha praktikave të dhënies me qira, të kërkoj nga Drejtoria e Shërbimit Pyjor Vlorë, apo Ministria përkatëse, mbi procedurat që duhen ndjekur për zëvendësimin e personit juridik (nga pala e mëparshme qiradhënëse DSHP Vlorë te pala aktuale Bashkia Finiq), si dhe lidhur me të drejtat dhe detyrimet për monitorimin e zbatimit të kushteve të secilës kontratë.

Menjëherë

10.12. Gjetje nga auditimi: Bashkia Finiq sipas kontratës tip datë 20.06.2016 lidhur me shoqërinë “Kalivioti” shpk, për një afat deri më 19.06.2017, me sipërfaqe 0,1 ha x 44,000 lekë =44,000 lekë, është lejuar shoqëria të shfrytëzoj sipërfaqet në pronësi të bashkisë për prodhimin e materialeve inerte. Shoqëria rezulton të jetë pajisur me leje minerare nr. 717/1, datë 30.05.2013, për vendburimin “Rreze e Milesë, Sopik”, për shfrytëzim guri gëlqeror për sipërfaqen prej 4.8 ha, me tarifë 440,000 lekë/ha dhe vlerë komplekse 2,112,000 lekë, tarifë kjo e përlogaritur sipas VKM nr. 1064, datë 22.10.2010 (Trajtuar në faqet 167-168 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

10.12.1 Rekomandim: Bashkia Finiq, të konfirmoj sipërfaqen që subjekti ka në shfrytëzim, me qëllim dokumentimin e saj, pasi në referim të VKM dhe lejes minerare çdo subjekti i llogaritet pagesa në varësi të datës efektive të dhënies së lejes së shfrytëzimit dhe në çdo vit në këtë datë efektive në varësi të sipërfaqes të përfshirë në zonën e lejuar të shfrytëzimit; si dhe ti bashkëlidhë kontratës planimetrinë, duke bërë evidentimin e sipërfaqes sipas lejes së shfrytëzimit dhe pjesës të cilën aktualisht shfrytëzohet nga përfituesi, akt i cili duhet të nënshkruhet nga strukturat përgjegjëse dhe të miratohet nga titullari i institucionit.

Menjëherë

11.14. Gjetje nga auditimi: Nga ish-Komunat Finiq, Aliko, Mesopotam dhe Dhivër, për çdo muaj janë kryer pagesa për shpërblimin e këshilltarëve të këshillit, mbi bazën e listëprezencave të pjesëmarrjes në mbledhjet e këshillave. Nga verifikimi i protokollit të mbledhjeve, mbajtur nga sekretari këshillit për çdo mbledhje të realizuar, rezultoi se prezenca e këshilltarëve në mbledhje për muajt të veçantë përkatës, nuk përkon me listëprezencat e dorëzuara, me një efekt financiar si pasojë e pagesave të padrejta në **shumën 4,985,885lekë**, nga e cila për këshilltarët e ish Komunës Finiq në vlerën 255,345 lekë, për këshilltarët e ish-Komunës Aliko për vlerën 2,341,185 lekë, për ish Komunën Dhivër për vlerë 1,937.925 lekë dhe për ish Komunën Mesopotam 451,430 veprime në kundërshtim me ligjin nr. 8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, i ndryshuar, Kreun VI, neni 29, pika 2, i ndryshuar me ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, pika 1 e nenit 51 (Trajtuar në faqet 28-55 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

11.14.1. Rekomandimi: Në kushtet e pamundësisë nga KLSH të verifikimit rast pas rasti të dokumentacionit dhe protokolleve të mbledhjeve per pagesat në **shumën 4,985,885 lekë** për këshilltarët e ish-Komunave dhe Bashkisë, mbështetur në shkronjat (i) dhe (f) të nenit 15, -Të drejtat e dhe detyrat e KLSH-së, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”; sipas të cilit “KLSH ka të drejtë ti propozojë një sive të auditimit të brendshëm në sektorin publik të kryejnë auditime brenda kompetencës të tyre” dhe nenit 25 “Marrëdhëniet me Kontrollin e Lartë të Shtetit”, të ligjit nr. 114/2015 datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, si Standardeve të Auditimit ISSAI 1600, rekomandojmë:

Njësia e Auditimit të Brendshëm në Bashkinë Tuaj, në bazë të një programi tematik auditimi të miratuar nga Titullari i Bashkisë, të verifikojë të gjithë dokumentacionin mbi të cilin është bërë pagesa e këtyre këshilltarëve.

Pas verifikimit dhe saktësimit të pagesave **të lihet në kompetencë Kryetarit të Bashkisë**, të përcaktojë masat përkatëse në lidhje me vlerën e dëmit që duhet të kthejnë në buxhet këshilltarët. Ndalesat lidhur me mos llogaritjen e tatimit mbi pagë duhen paguhen, pasi janë në kundërshtim me kërkesat e kreut II-të, neni 8 “*E ardhur e tatueshme*” shkronja “g”, neni 33 “*Mbajtja në burim e tatimit mbi të ardhurat*”, të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “*Për tatimin mbi të ardhurat*” i ndryshuar me ligjin nr. 83/2014 datë 17.07.2014 dhe 156/2014 datë 27.11.2014.

Menjëherë

12.15. Gjetje nga auditimi: Bashkia Finiq nuk ka marrë në dorëzim nga ish Komuna Finiq, sot Njësi administrative, tre mjete tip Zetora me vlerë kontabile 4.170.200 lekë, të dhuruara gjatë viteve 1994-1995, mjete të cilat nuk gjendet në ambientet e kësaj njësie, madje nuk disponohet as kartelë edhe pse të regjistruar në llogaritë inventariale të Aktiveve të Qëndrueshme, veprime në kundërshtim me kërkesat e UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*” i ndryshuar, Kap I, nenet 10, 12 Kap. IV, pikat 89, 90, 91, 93 dhe ligjit nr. 9228, date 29.4.2004 “*Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare*” i ndryshuar, neni 7 (*Trajtuar në faqet 35-38 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

12.15.1 Rekomandimi: Bashkia Finiq, të vlerësojë gjendjen mungesë së mjeteve, duke evidentuar personat përgjegjës dhe duke ndërmarrë të gjitha veprimet ligjore në ngarkim të tyre, si dhe të marrë masat administrative e ligjore për kthimin e tyre apo për ato raste kur nuk është i mundur të kërkojë arkëtimin e vlerës së dëmit ndaj personave që i kanë pasur në inventar mjetet e transportit por nuk i kanë dorëzuar, për vlerën **4,170,200 lekë**.

Menjëherë

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI:

Nga verifikimi rezultoi se nga vlera e rekomanduar nga KLSH prej.....**53.616.974 lekë**

-Deri më datën 30.09.2018 është arkëtuar850.189 lekë

Kanë mbetur pa u arkëtuar vlera prej.....52.766.785 lekë

Nga të cilat:

-Në proces arkëtimi 14 rekomandime në vlerën.....15.379.695lekë

-Në proces gjyqësor (prokurori) **pa u zbatuar rekomandime në vlerën....28.727.919lekë**

-Janë nisur njoftimet për 1 rekomandime por ende nuk kanë filluar arkëtimet... 7.399.770lekë

Në mënyrë të detajuar masat shpërblim dëmi rikërkojmë si më poshtë:

1.1. Gjetje nga auditimi: Në tenderin me objekt “*Rehabilitimi i rrugës Dermish-Dhiver-Cerkovice*”, me fond limit 82,916,667 lekë, KVO ka vepruar me dy standarde në vlerësimin e ofertave, pasi të gjithë operatorët ekonomik pjesëmarrës në garë, “S []” shpk me vlerë të ofertës 72,408,630 lekë, BOE “B [] shpk & B [] shpk” me vlerë të ofertës 71,285,361 lekë dhe “4-AM” shpk me vlerë të ofertës 81,675,405 lekë, kanë mangësi në plotësimin e “Kritereve të Veçanta të Kualifikimit”, për rrjedhojë tenderi duhej anuluar, çka nuk është bërë, duke kualifikuar dhe shpallur padrejtësisht fitues OE “4 []” shpk, me vlerë më të lartë, çka ka krijuar përdorim me mos efektivitet, efikasitet dhe ekonomikitet dhe pasojë dëm ekonomik në vlerën **10,390,044 lekë**, të llogaritur si diferencë nga oferta e kualifikuar dhe shpallur padrejtësisht fitues “4-AM” shpk minus (-) ofertën e BOE “B [] shpk & B [] shpk” (81,675,405-71,285,361)=10,390,044 lekë (*Trajtuar në faqet 84-89 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

1.1.1 Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike në Bashkinë Finiq, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtim e shumës prej **10,390,044 lekë**, të ndarë në mënyrë të barabartë nga anëtarët e KVO-së, Th [] Z [], I [] E [] dhe S [] C [] me nga **3,463,348 leke secili**.

Menjëherë

2.2. Gjetje nga auditimi: Në tenderin me objekt “Sistemin i Bulevardit qendor Finiq”, të zhvilluar nga ish-Komuna Finiq, me fond limit 50,000,000 lekë”, me fitues BOE “M [REDACTED]” shpk & “F [REDACTED]” shpk & “F [REDACTED] K [REDACTED]” shpk, me vlerë të ofertës 44,749,702 lekë, KVO ka vepruar me dy standarte pasi ka kualifikuar e shpallur padrejtësisht fitues ofertën e BOE “M [REDACTED]” shpk & “F [REDACTED]” shpk & “F [REDACTED] K [REDACTED]” shpk, me vlerë më të lartë, me mangësi në plotësimin e kriterëve të kërkuara në DST, duke krijuar përdorim me mos efektivitet, efikasitet dhe ekonomicitet dhe pasojë dëm ekonomik në vlerën **13,074,372 lekë**, të llogaritur si diferencë nga oferta e BOE padrejtësisht të kualifikuar dhe shpallur fitues “M [REDACTED]” shpk & “F [REDACTED]” shpk & “F [REDACTED] K [REDACTED]” shpk minus (-) ofertën e OE “V [REDACTED]” shpk (44,749,702-31,675,330)= 13,074,372 lekë (Trajtuar në faqet 97-104 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.2.1 Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike në Bashkinë Finiq, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtim e shumës prej **13,074,372 lekë** të ndarë në mënyrë të barabartë nga anëtarët e KVO-së, Th [REDACTED] Z [REDACTED], V [REDACTED] C [REDACTED] dhe V [REDACTED] A [REDACTED] me nga **4,358,124 cdonjeri** prej tyre .

Menjëherë

3.3. Gjetje nga auditimi: Në tenderin me objekt “Rikonstruksioni i kanalit ujitës KK-3”, të zhvilluar nga ish-Komuna Finiq, me fond limit 66,525,389 lekë”, me fitues BOE “F [REDACTED] K [REDACTED] & M [REDACTED]” shpk me vlerë të ofertës 66,392,057 lekë, KVO ka vepruar me 2 standarte pasi ka s’kualifikuar nga gara operatorin ekonomik me vlerë më të ulët “N [REDACTED]” shpk, për mangësi të cilat nuk i ka plotësuar as BOE “F [REDACTED] K [REDACTED]” shpk & “M [REDACTED]” shpk, me vlerë më të lartë dhe nuk është konstatuar nga KVO, çka ka shkaktuar përdorim me mos efektivitet, efikasitet dhe ekonomicitet dhe pasojë dëm ekonomik në vlerën **5,263,503 lekë** (Trajtuar në faqet 91-96 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.3.1 Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike në Bashkinë Finiq, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtim e shumës prej **5,263,503 lekë** të ndarë në mënyrë të barabartë nga anëtarët e KVO-së Th [REDACTED] Z [REDACTED], L [REDACTED] D [REDACTED] dhe V [REDACTED] C [REDACTED] me nga **1,754,501 sejcili** .

Menjëherë

4.4. Gjetje nga auditimi: Në objektin “Ndërtimi i Ujësjiellit Navaricë - Memoraq Dermish” Finiq, nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit dhe mbikëqyrjes së punimeve të ndërtimit të administruara në dosjen teknike rezultoi mos aplikim i penalitetit për vonesa në përfundimin e punimeve në afat në vlerën **7,399,770 lekë**, veprime në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 3272/1, datë 22.12.2016 të lidhur mes Titullarit të Autoritetit Kontraktor Bashkia Finiq dhe BOE “M [REDACTED]” dhe “A [REDACTED]” shpk, neni 27 Dëmshpërblimet për vonesa (Trajtuar në faqet 115-119 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.4.1 Rekomandim: Nga Bashkia Finiq të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **7,399,770 lekë** nga BOE “M [REDACTED]” dhe “A [REDACTED]” sh.p.k, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën nr. 3272/1, datë 22.12.2016 me objekt “Ndërtimi i Ujësjiellit Navaricë - Memoraq Dermish” Finiq, vlerë kjo e cila përfaqëson penalitetin e pa aplikuar nga ana e Autoritetit Kontraktor Bashkia Finiq ndaj sipërmarrësit të punimeve për vonesa të pa justifikuar në përfundimin e punimeve.

Menjëherë

5.5. Gjetje nga auditimi : Nga auditimi i gjendjes së debitorëve të krijuar nga dhënia me qira e tokës bujqësore të pandarë me afat kontrate 10, 35 dhe 99 vjeçare, rezultoi se nga ish Komuna Finiq janë lidhur 29 kontrata për sipërfaqen prej 23,3 ha dhe ish Komuna Mesopotam janë lidhur 208 për një sipërfaqe të ndarë prej 271 ha, nga të cilat për ish Komunën Finiq rezultojnë 19 kontrata debitore ndërsa për ish Komunën Mesopotam 45 kontrata debitore.

Nga llogaritja e detyrimeve nga kamatëvonesa, për çdo person kontraktues dhe për çdo vit rezulton se detyrimi me gjithë kamatëvonesa është në vlerën prej 5,892,423 lekë nga të cilat për vitin 2014 është 1,586,653 lekë; viti 2015 është 1,552,770 leke; viti 2016 është 1,166,347 leke dhe në total është 4,305,770 lekë.

Referuar kontratës tip, rezultojnë se kur kontraktuesi nuk ka kryer pagesën sipas afatit të parashtruar në kontratë detyrohet të paguajë kamatëvonesë për 1% në ditë , sipas me UKM nr. 3,

datë 16.5.2007 “Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore, të pandara”, akt i shfuqizuar me hyrjen në fuqi të UKM nr. 1, datë 18.7.2012 “Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara” (Trajtuar në faqet 134-136 të Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe aneksi nr.23 bashkëlidhur).

5.5.1 Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe Zyra Juridike në Bashkinë Finiq si dhe Njësitë Administrative përkatëse, të marrin masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtimin e detyrimit të krijuar nga mos kryerja e pagesës në afatin e caktuar në kontratë për tokat e marra me qira dhe mos llogaritja e kamatëvonesa sipas kontratës në vlerën **4,305,770 lekë dhe 1,586,653 lekë** detyrimi i pa paguar në afat, ose në total **5,892,423 lekë**.

Menjëherë

6.6. Gjetje nga auditimi: Për vitet 2013-2016 janë krijuar të ardhura nga tarifatat e përdorimit të kullotave dhe kositje, nga kapaciteti i kullotave në juridiksionin të ish Komunave Dhivër, Aliko, Mesopotam dhe Bashkia Finiq, (llogaritur sipas tarifave të VKM nr. 632, datë 11.6.2009 “Për miratimin e Tarifave të Përdorimit të Kullotave dhe Livadheve për Kullotje dhe Kositje”, krahasuar me tarifatat e miratuara në paketat fiskale sipas periudhave 2013-2016 ku konstatohen të ardhur të munguar, të pa planifikuar dhe pa arkëtuara në **vlerën 4,381.990 lekë**, si vijon:

6.a -Në ish Komunën Dhivër:

-Për vitin 2014, rezultojnë se janë lidhur 23 kontrata për 4,578 krerë të imta nga të cilat 2772 krerë dele dhe 1,816 dhi duke zbatuar një çmim për krerë 100 lekë, ndërkohë që në paketën fiskale është miratuar 300 lekë/krerë. Në këto kushte nga 4,588 krerë të imta, janë trajtuar me kontrata qiraje në kundërshtim me VKK nr.13, datë 06.02.2014, duke krijuar një të ardhur të munguar **për 851,540 lekë** (Trajtuar në aneksi nr. 17 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit).

-Për vitin 2015, janë lidhur 23 kontrata për 2,684 krerë të imta nga të cilat 2363 krerë dele dhe 321 dhi ku janë lidhur 19 kontrata, duke zbatuar një çmim për krerë nga 50-100 lekë, ndërkohë që në paketën fiskale të miratuar është miratuar më 300 lekë /krerë. Në këto kushte 2,684 krerë të imta, janë trajtuar me kontrata qiraje në kundërshtim me VKK, nr. 4, datë 11.02.2015, duke krijuar një të ardhur të munguar **për 577,300 lekë** (Trajtuar në aneksin nr.18, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit).

6.b -Në ish Komunën Aliko:

-Për vitin 2014 dhe 2015 rezulton se është miratuar paketa fiskale me VKK nr. 01, datë 14.02.2014 dhe nr. 26, datë 12.03.2015, ku çmimi i qirasë për krerë është përcaktuar në shumën 350 lekë/krerë për dele dhe dhi, ndërkohë që është zbatuar me 100 lekë/krerë duke krijuar një mungesë në arkëtimin e të ardhurve nga qiraja kullosore në vlerën **256,150 lekë** nga të cilët 4 kontrata të katër fermerëve i takon vitit 2014, për shumën 101,500 lekë Për vitin 2015 rezultojnë të jenë lidhur 6 kontrata për 6 fermerëve për shumën 154,650 lekë (Trajtuar në aneksin nr.19, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit).

6.c -Në ish Komunën Mesopotam:

-Për vitin 2013 janë lidhur 35 kontrata duke u aplikuar çmimi 200 dhe jo 300 lekë/krerë, nga ku tarifatat për 5 fermerëve nuk janë llogaritur sipas referencës dhe nuk është paguar vlera prej 47,000 lekë, në kundërshtim me VKK nr. 1, datë 13.02.2013.

-Për vitin 2014 janë lidhur 33 kontrata për kullotjen e të imtave duke u aplikuar çmimi 200 dhe jo 300 lekë/krerë, nga ku tarifatat për 4 fermerëve nuk janë llogaritur sipas referencës dhe nuk është paguar vlera prej 42,000 lekë, në kundërshtim me VKK nr.2, datë 20.02.2014.

-Për vitin 2015 janë lidhur 11 kontrata për kullotjen e të imtave duke u aplikuar çmimi 200 dhe jo 300 lekë/krerë, nga ku tarifatat për 4 fermerëve nuk janë llogaritur sipas referencës dhe nuk është paguar vlera prej 75,000 lekë, në kundërshtim me VKK nr.2, datë 16.02.2015.

Për të 3 vitet, është krijuar një diferencë në arkëtimin e të ardhurve në vlerën prej **164,000 lekë** për një numër të imtash të kontraktuara për 1961 krerë nga të cilat 581 dele dhe 1380 dhi (Trajtuar në faqet 130-134 të Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe aneksi nr.20 bashkëlidhur).

6.d -Në Bashkinë Finiq:

- Për vitin 2015-2016, sezonin veror, janë lidhur 27 kontrata për 6.386 krerë dele, 982 krerë dhi si dhe 65 krerë të trasha, nga ku llogaritjet për çdo krerë të kontraktuar janë për 100 lekë, kur sipas paketës fiskale të miratuar rezulton 200 lekë/krerë, për rrjedhojë është krijuar një diferencë për vlerën **648.300 lekë**.

-Për sezonin dimëror 2016-2017, janë lidhur 157 kontrata, për sipërfaqen prej 6316 ha, nga të cilat 21120 krerë dele, 3290 krerë dhi dhe 10 krerë të trasha, me çmim 100 lekë/krerë dhe jo sipas çmimit të paketës fiskale të miratuar me VKB prej 200 lekë/krerë. Si rrjedhojë e këtij veprimi nga 157 fermer është krijuar e ardhur e munguar për vlerën **1,885,000 lekë**.

Në total për të dy sezonet veror dhe dimërore janë dhënë me qira sipërfaqe kullosore e pyjore 8,455 lekë, janë kontraktuar 27506 krerë dele, 4772 krerë dhi dhe 75 të trasha, për shumën prej 3,192,800 lekë, ose më pak **2,533,800 lekë** nga 5,726,100 lekë që duhet të planifikoheshin dhe arkëtoheshin në arkën e buxhetit të bashkisë (*Trajtuar në faqet 130-134 të Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe aneksin nr.21, bashkëlidhur*).

6.6.1-Rekomandimi: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, Drejtoria e Zhvillimit Pyjor, Drejtoria e Financës dhe Zyra Juridike në Bashkinë Finiq si dhe Njësitë Administrative përkatëse, të marrin masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për të kërkuar *arkëtimin e detyrimit të krijuar nga mosrespektimi i çmimit për krerë të miratuar në paketat fiskale të miratuar dhe atyre të aplikuar, për vlerën 4,381,990 lekë*.

Menjëherë

7.7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i strukturës organizative dhe nivelit të pagave sipas funksioneve, për ish-Komunën Finiq, Aliko, Dhivër dhe Mesopotam dhe Bashkia Finiq, klasifikimi dhe kategorizimi i pagës të përgjegjësit të zyrës (klasa III, kategoria III-a/1) është bërë në kundërshtim me VKM nr. 586, datë 17.07.2013 "*Për disa ndryshime në vendimin nr. 1619, datë 02.07.2008, të KM "Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësisve të qeverisjes vendore për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të punonjësve të organeve të qeverisjes vendore", pasi klasa III-a/1 duhet klasifikuar në klasën III-b "Përgjegjës sektori; Specialist i nivelit të lartë; Inspektor"*, lidhja 2, me një diferencë për vlerën **1,522,317 lekë**, nga ku për ish Komunën Finiq në vlerën 241,941 lekë, Aliko për vlerën 577,235 lekë, Dhivër për vlerën 313,109 lekë, Mesopotam për shumën 356,652 lekë dhe Bashkia Finiq për vlerën 66,680 lekë (*Trajtuar në faqet 46-66 të Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe aneksit bashkëlidhur*).

7.7.1. Rekomandimi: Drejtoria Financës, në bashkëpunim me Sektorin Juridike, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e **vlerës 1,522,317 lekë**.

Menjëherë

8.8. Gjetje nga auditimi: Nga ish-Komuna Livadhja është lidhur kontratë qiraje nr.5176 kol dhe 1882 rep, datë 13.10.2009, "*Për ndërtimin e një stacioni transmetimi mobile*", me palë qiramarrëse shoqëria "*V██████ A██████*" sh.a., për sipërfaqen prej 300 m² me çmim prej 153,000 lekë/vit dhe afat përdorimi deri më 08.08.2015. Për këtë kontratë nuk ka gjetur zbatim VKM nr. 1712, datë 24.12.2008 "*Për dhënie me qira ose enfiletoz të pasurive shtetërore*" dhe VKM nr. 529, datë 08.6.2011 dhe *kontrata është llogaritur për vlerën prej 153,000 lekë x 7 vjet = 1,071,000 lekë, kur duhej të ishte llogaritur në vlerën 300 m² x 100lekë/m² x 84 muaj = 2,520,000 lekë, shumë të cilës i duhet zbritur diferenca e paguar në vlerën prej 1,071,000 = 1,449,000, të ardhura të munguara me dëm ekonomik (Trajtuar në faqet 145-147 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*.

8.8.1 Rekomandim: Drejtoria e Financës, në bashkëpunim me Drejtorinë e Taksave e Tarifave Vendore dhe Sektorin Juridik, të marrin masat për kontabilizimin dhe arkëtimin e detyrimeve nga llogaritja e diferencës në vlerën e qirasë për vlerën prej **1,449,000 lekë**.

Menjëherë

9.9. Gjetje nga auditimi: Nga ish-Komuna Livadhja është lidhur kontratë qiraje nr. Ska, datë 01.08.2010, "*Për ndërtimin e një stacioni transmetimi mobile*", me palë qiramarrëse shoqëria "*P██████ C██████*" sh.a., për sipërfaqen prej 400 m² me çmim prej 350,000 lekë/vit me afat përdorimi deri më 31.07.2019. Për këtë kontratë nuk ka gjetur zbatim VKM nr. 1712, datë

24.12.2008 “Për dhënien me qira ose enfiteozë të pasurive shtetërore” dhe VKM nr. 529, datë 08.6.2011 dhe kontrata është llogaritur për vlerën prej 350,000 lekë x 9 vjet = 3,150,000 lekë, kur duhej të ishte llogaritur në vlerën $400\text{ m}^2 \times 100\text{ lekë/m}^2 \times 108\text{ muaj} = 4,320,000\text{ lekë}$, shumë të cilës i duhet zbritur diferenca e paguar në vlerën prej 3,150,000=1,170,000 lekë, të ardhura të munguara me dëm ekonomik (Trajtuar në faqet 145-147 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

9.9.1 Rekomandim: Drejtoria e Financës, në bashkëpunim me Drejtorinë e Taksave e Tarifave Vendore dhe Sektorin Juridik, të marrin masat për kontabilizimin dhe arkëtimin e detyrimeve nga llogaritja e diferencës në vlerën e qirasë për vlerën prej **1,170,000 lekë**.

Menjëherë

10.10. Gjetje nga auditimi: Në Ish-Komunën Mesopotam, taksa për tokën bujqësore është miratuar për vlerën 1800 lekë/ha për tokën arë, 1500 lekë për tokën arë në zonën malore dhe 1000 lekë/ha për tokën vresht, ullishtë dhe pemishte dhe sipas të dhënave toka e ndarë sipas ligjit 7501, datë 19.07.1991 është 1598 ha nga e cila 1015 ha tokë arë, 259 ha tokë arë malore dhe 324 ha pemishte, vreshta dhe ullishte.

-Nga 1800 lekë që është miratuar mesatarisht për taksën e tokës, për kategorinë tokë arë malore, është zbatuar me çmim 1500 lekë për ha ose 300 lekë/ha më pak duke mos u arkëtuar 77,700 lekë, gjithsej (259 ha 300 lekë/ha (1800-1500 lekë) dhe për tri vitet $77,700 \times 3 = 231,000\text{ lekë}$).

-Nga 1800 lekë që është miratuar mesatarisht për taksën e tokës, për kategorinë tokë arë pemishte, vresht dhe ullishtë, është zbatuar me çmim 1000 lekë për ha ose 800 lekë/ha më pak duke mos u arkëtuar 259,200 lekë, (324 ha x 800 lekë/ha).

Për tri vitet, për kategorinë e tokës arë të mbjellë me pemishte, vresht e ullishtë nuk është planifikuar dhe arkëtuar vlera prej $259,200 \times 3 = 777,600\text{ lekë}$, ndërsa në total rezulton mungesë e planifikimit dhe arkëtimin të të ardhurave për **vlerën 1,010,700 lekë** për të dyja kategoritë e tokës (Trajtuar në faqet 120-135 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

10.10.1 Rekomandimi: Nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, Drejtoria e Bujqësisë (DAMT) dhe Njësia Administrative Mesopotam, të merren masa për llogaritjen e detyrimeve për çdo fermer pronar të tokës për kategoritë e mësipërme, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtimin e detyrimit të krijuar nga mosrespektimi i taksës së tokës të miratuar në paketën fiskale, për vlerën totale **1,010,700 lekë**.

Menjëherë

11.11. Gjetje nga auditimi: Nga ish-Komuna Finiq janë lidhur 2 kontrata qiraje Tip nr. *ska*, datë 17.07.2014, “Për dhënien me qira të trualli”, me palë qiramarrëse L■■■■ C■■■, me çmim prej 30 lekë/m² në vit për sipërfaqen 70 m² me vlerë të përgjithshme 2,100 lekë në vit si dhe Kontrata nr. *ska*, datë 26.08.2014, “Për dhënien me qira të trualli”, me palë qiramarrëse I■■■ N■■■, me çmim prej 30 lekë/m² në vit për sipërfaqen 510 m² me vlerë të përgjithshme 15,300 lekë në vit. Dhënia me qira është në kundërshtim me tarifën e miratuara sipas VKM nr. 54, datë 05.02.2014, “Për përcaktimin e kritereve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, të ndryshuar, duke krijuar dëm ekonomik në vlerën prej:

Kontrata Tip nr.*ska*, datë 17.07.2014, me vlerë të përgjithshme 2,100 lekë në vit, duhet të ishte në vlerën prej 84,000 lekë-vlera e paguar prej 2,100=81,900 lekë.

Kontrata Tip nr.*ska*, datë 26.08.2014, me vlerë të përgjithshme 15,300 lekë në vit, duhet të ishte në vlerën prej 612,000 lekë-vlera e paguar prej 15,300=596,700 lekë (Trajtuar në faqet 144-145 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

11.11.1 Rekomandim: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, Drejtoria e Zhvillimit Pyjor, Drejtoria e Financës dhe Zyra Juridike në Bashkinë Finiq, të marrin masat për kontabilizimin dhe arkëtimin e detyrimeve nga llogaritja e diferencës në vlerën e qirasë për shumën prej **678,600 lekë**.

Menjëherë

12.12. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i aktivitetit për menaxhimin e borxhit (gjendjes së debitorëve të taksave dhe tarifave vendore (biznesi), rezulton se për disa nga debitorët, nuk është llogaritur penaliteti në masën 0,06% kamat vonesë të detyrimit në ditë por jo më tepër se 365 ditë,

bazuar në nenit 114, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për Procedurat tatimore në R.SH”, i ndryshuar, dhe konkretisht:

-Njësia administrative Finiq 18 subjekte private shuma leke kamate e parkëtuar=94026 leke.

-Njësia Aliko, për 3 subjekte, vlera e kamatës të parkëtuar=12,255 lekë.

-Njësia Mesopotam, për 17 subjekte, vlera e kamatës të parkëtuar=57,417 lekë.

-Njësia Dhiver, 15 subjekte, vlera e kamatës të parkëtuar=104,987 lekë.

-Njësia Livadhja, për 23 subjekte, kamata e pa arkëtuar = 99,582 lekë.

Në total Bashkia Finiq vlera e kamatës të parkëtuar është **368,267 lekë** (Trajtuar në faqet 132-148 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

12.12.1 Rekomandimi: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, Drejtoria e Financës dhe Zyra Juridike në Bashkinë Finiq dhe Njësiti Administrative, të marrin masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për të kërkuar *arkëtimin e detyrimit të krijuar nga mospenalizimi i subjekteve debitorë në vlerën 368,267 lekë.*

Menjëherë

13.13. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i kontratave të dhënies me qira të fondit pyjor e kullësor (kontrata me afat 3 dhe 10 vjet) parcela faktike është më e madhe se sipërfaqja e kontraktuar, si dhe numri i krerëve të kontraktuar krahasuar me kapacitetin kullësor rezulton me diferencë, duke krijuar diferencë në planifikim dhe arkëtimin e të ardhurave me efekt ekonomik për **vlerën 441,900 lekë** (Trajtuar në faqet 132-134 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

13.13.1 Rekomandimi: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, Drejtoria e Zhvillimit Pyjor, Drejtoria e Financës dhe Zyra Juridike në Bashkinë Finiq, si dhe Njësiti Administrative përkatëse, të marrin masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për kërkimin dhe arkëtimin e detyrimit të krijuar nga mosrespektimi sipërfaqes së kontraktuar më sipërfaqen faktikë të parcelave kullësore e për rrjedhojë kontraktuar më pak numër krerësh të imët krahasuar me kapacitetin e kullësor mbajtës të vetë parcelës. Në këto, kushte është krijuar një e ardhur e munguar e pa llogaritur dhe e pa arkëtuar në vlerën **441,900 lekë** nga e cila;

-Për ish Komunën Mesopotam, vlera 149,100 lekë, nga 6 fermerë, J ■■■ St ■■■ për vlerën 15,300 lekë, V ■■■ K ■■■ për shumën 17,400 lekë, M ■■■ K ■■■ për shumën 65,100 lekë, B ■■■ T ■■■ për shumën 51,300 lekë dhe P ■■■ Sh ■■■.

-Për ish Komunën Aliko, vlera 276,900 lekë, nga 5 fermerë, Dh ■■■ F ■■■ për vlerën 75,000 lekë, L ■■■ K ■■■ për vlerën 12,300 lekë, V ■■■ K ■■■ Th ■■■ për vlerën 84,300 lekë, Th ■■■ K ■■■ Th ■■■ për vlerën 84,300 lekë dhe Th ■■■ K ■■■ për vlerën 21,300 lekë detyrime të pa llogaritura dhe të pa arkëtuara.

Menjëherë

14.14. Gjetje nga auditimi: Nga ish Komuna Livadhja është lidhur kontratë qiraje nr. Ska, datë 08.11.2007, “Për ndërtimin e një stacioni transmetimi mobile”, me palë qiramarrëse shoqëria “T ■■■ A ■■■” sh.a. për sipërfaqen prej 300 m² me çmim prej 330,000 lekë/vit, me afat përdorimi deri më 17.09.2016. Për këtë kontratë nuk ka gjetur zbatim VKM nr. 1712, datë 24.12.2008 “Për dhënien me qira ose enfiteozë të pasurive shtetërore” dhe VKM nr. 529, datë 08.6.2011 dhe *kontrata është llogaritur për vlerën prej 330,000 lekë x 9 vjet = 2,970,000 lekë, kur duhej të ishte llogaritur në vlerën 300 m² x 100 lekë/m² x 108 muaj = 3,240,000 lekë, shumë të cilës i duhet zbritur diferenca e paguar në vlerën prej 2,970,000 = 270,000 leke të ardhura të munguara me dëm ekonomik* (Trajtuar në faqet 145-146 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

14.14.1 Rekomandim: Drejtoria e Financës, në bashkëpunim me Drejtorinë e Taksave e Tarifave Vendore dhe Sektorin Juridik, të marrin masat për kontabilizimin dhe arkëtimin e detyrimeve nga llogaritja e diferencës në vlerën e qirasë për vlerën prej **270,000 lekë.**

Menjëherë

15.15. Gjetje nga auditimi: Nga ish Komuna Aliko është lidhur 1 kontratë qiraje “Për dhënien me qira të objektit ish-vatra e Kulturës, kati përdhe”, me palë qiramarrëse V ■■■ C ■■■, me çmim prej 2750 lekë në muaj për objektin ose 33,000 lekë për sipërfaqen prej 50 m² “ndërtesë”, kontratë e cila është përsëritur edhe gjatë viteve në vazhdim sipas kontratës datë 29.04.2014 dhe datë 16.04.2015. Nga mos llogaritja e tarifës së qirasë sipas VKM nr. 529, datë 08.6.2011 “Për

përcaktimin e kritereve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore” dhe nenit 801 të Kodit Civil, është krijuar dëm ekonomik për buxhetin e Komunës Aliko, i cili për periudhën objekt auditimit, (36 muaj) llogaritet si vijon:

$50 \text{ m}^2 \times 55 \text{ lekë/m}^2 \text{ në muaj} = 2,750 \text{ lekë/muaj} \times 36 \text{ muaj} = 99,000 \text{ lekë}$

$50 \text{ m}^2 \times 100 \text{ lekë/m}^2 \text{ në muaj} = 5,000 \text{ lekë/muaj} \times 36 \text{ muaj} = 180,000 \text{ lekë}$

Diferenca ndërmjet vlerës që duhej lidhur kontrata dhe asaj që është lidhur është $180,000 - 99,000 = 81,000 \text{ lekë dëm ekonomik për buxhetin e komunës, por duke qenë se subjekti nuk ka paguar asnjë vlerë të qirasë e gjithë vlera prej 180,000 lekë konsiderohet si dëm për buxhetin (Trajtuar në faqet 141-142 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).$

15.15.1 Rekomandim: Drejtoria e Financës, në bashkëpunim me Drejtorinë e Taksave e Tarifave Vendore dhe Sektorin Juridik, të marrin masat për kontabilizimin dhe arkëtimin e detyrimeve nga llogaritja e diferencës në vlerën e qirasë për vlerën prej **180,000 lekë**.

Menjëherë

16.16. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi planifikimin dhe zbatimin e tarifës së pastrimit për subjektet inerte në ish Komunën Mesopotam për periudhën 01.01.2013 deri më datë 31.12.2016, si dhe taksën e tokës rezultoi se:

Në vitin 2013 me VKK nr. 1, datë 13.02.2013, në vitin 2014 me VKK nr. 2, datë 13.02.2014, dhe në vitin 2015 me VKK nr.2, datë 13.02.2015, është miratuar Paketa Fiskale, ku tarifa e pastrimit është përcaktuar e miratuar për dy subjekte që kanë ushtruar aktivitetin në fushën e inerteve përkatësisht “Subjekti D [redacted]” dhe subjekti “Th [redacted]”. Tarifa e pastrimit është miratuar në vlerën 75,000 lekë ndërkohë që është zbatuar 60,500 lekë (pagesa është kryer për 14,500 lekë në vit më pak me efekt ekonomik 14,500 lekë x 3 vjet = 43,500 lekë për subjektin Dinamika shpk dhe 14,500 lekë /vit x 3 vjet = 43,500 lekë për subjektin Th [redacted] shpk. Në mënyrë të përmbledhur rezultoi se dy subjektet e mësipërme nuk kanë paguar në total për të tri vite **vlerën 87,000 lekë** (Trajtuar në faqet 64-66 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

16.16.1 Rekomandimi: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, Drejtoria e Financës dhe Zyra Juridike në Bashkinë Finiq, si dhe Njësitë Administrative përkatëse, të marrin masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për të kërkuar arkëtimin detyrimin prej **87,000 lekë** të krijuar nga mosrespektimi i tarifës së pastrimit të miratuar në paketën fiskale të miratua, për subjektin “D [redacted]” shpk për vlerën 43,500 lekë dhe subjektin “Th [redacted]” shpk për vlerën 43,500 lekë.

Menjëherë

17.17 Gjetje nga auditimi: Nga ish-Komuna Aliko është lidhur 1 kontratë qiraje “Për dhënien me qira objekti me sipërfaqe që ndodhet në truallin e Komunës Aliko në objektin (ish shkolla fillore Neohor)”, me palë qiramarrëse T [redacted] K [redacted], me çmim prej 60 lekë/m² në muaj për objektin ose 59,760 lekë për sipërfaqen prej 83 m². Nga mos llogaritja e tarifës së qirasë sipas VKM nr. 529, datë 08.6.2011 “Për përcaktimin e kritereve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore” dhe nenit 801 të Kodit Civil, është krijuar dëm ekonomik për buxhetin e Komunës Aliko, i cili për periudhën objekt auditimit, (12 muaj) llogaritet si vijon:

$83 \text{ m}^2 \times 60 \text{ lekë/m}^2 \text{ në muaj} = 4,980 \text{ lekë/muaj} \times 12 \text{ muaj} = 59,760 \text{ lekë}$

$83 \text{ m}^2 \times 100 \text{ lekë/m}^2 \text{ në muaj} = 8,300 \text{ lekë/muaj} \times 12 \text{ muaj} = 99,600 \text{ lekë}$

Diferenca ndërmjet vlerës që duhej lidhur kontrata dhe asaj që është lidhur është $99,600 - 59,760 = 39,840 \text{ lekë, dëm ekonomik për buxhetin e komunës (Trajtuar në faqet 142-143 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).$

17.17.1 Rekomandim: Drejtoria e Financës, në bashkëpunim me Drejtorinë e Taksave e Tarifave Vendore dhe Sektorin Juridik, të marrin masat për kontabilizimin dhe arkëtimin e detyrimeve nga llogaritja e diferencës në vlerën e qirasë për vlerën prej **39,840 lekë**.

Menjëherë

18.18. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i veprimeve me bankë, është konstatuar se nga Drejtoria Ekonomike nuk është mbajtur tatimi në burim, për F [redacted] K [redacted] (jurist i jashtëm), duke evidentuar mungesë të ardhurash me dëm për vlerën prej **5000 lekë**, veprime në kundërshtim me

ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për Tatimin mbi të Ardhurat”, i ndryshuar neni 28 dhe 33 pika (f), për shpenzimet e kryera me objekt “specialist i jashtëm” (Trajtuar në faqet 37-39 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

18.18.1 Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike në bashkëpunim me Drejtorinë e Taksave Vendore në Bashkinë Sarandë, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore për arkëtimin nga z. F. [REDAKTUAR] K. [REDAKTUAR] të vlerës **5000 lekë**.

Menjëherë

C. MASA ADMINISTRATIVE;

c.1.Mbi masat e rekomanduara Agjencisë Prokurimit Publik.

I.Klsh me shkresën nr 494/26 prot., datë 20.12.2017 i ka rekomanduar Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Prokurimit Publik znj. Reida KASHTA, të vlerësojë shkeljet e konstatuara, duke vendosur marrjen e masave administrative (dënim me gjobë) në raport me shkeljet e konstatuara, apo me rekomandimin e autoritetit kontraktor (për marrjen e masave disiplinore) për **13 personat**. Nga verifikimi rezulton se APP me vendimin nr.15, datë 26.02.2018 duke vendosur masa dënim me gjobë për **19 persona në vlerën 2.300.000 lekë**. KLSH i kërkon **kryetarit të Bashkisë Finiq për 18 persona (pasi e ndjera znj. L. [REDAKTUAR] D. [REDAKTUAR] ka ndërruar jetë, dhe do zbritet shuma prej 130,000 lekë), të kërkohet në Gjykatë shndrimi i vendimit të kundërvajtjes në titull ekzekutiv në vlerën 2,170,000 lekë për të gjithë personat siç përcaktohet në ligjin nr. 10279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, Neni 24-Shndërrimi i vendimit për kundërvajtjen administrative në titull ekzekutiv, ku parashikohet se:**

1. Vendimi për kundërvajtjen administrative bëhet titull ekzekutiv në momentin e nxjerrjes së vendimit përfundimtar nga organi administrativ që ka kompetencën për shqyrtimin përfundimtar të kundërvajtjes në rrugë administrative.
2. Vendimi për kundërvajtjen administrative, që parashikon dënim që është i natyrave të tjera dhe jo dënim me gjobë, bëhet titull ekzekutiv, kur ligji i posaçëm ka parashikuar procedura të ankimit administrativ, por e drejta për ankim nuk është ushtruar brenda afateve të parashikuara nga ligji i posaçëm.

Menjëherë

6.BASHKIA KRUIJË:

-Nga verifikimi rezulton se KLSH ka dërguar në Bashkinë Krujë rekomandimet e auditimit me shkresën e saj nr.776/14, datë 15.12.2017, protokolluar në Bashkinë Krujë me shkresën nr.4458/3, datë 18.12.2017, ndërsa nga Bashkia Krujë për zbatim e rekomandimeve të KLSH është kthyer përgjigje me shkresën e saj nr.72, datë 05.01.2018, protokolluar në KLSH me shkresën nr.776./10 datë 10.01.2018.

-Nga verifikimi rezulton se përfundimet e auditimit i janë dërguar subjektit të audituar Bashkisë Krujë, me shkresën e Kryetarit të KLSH nr.776/14, datë 15.12. 2017 dhe duhet të raportonte në KLSH brenda 6 muajve ose brenda datës 15.06.2018 (referuar nenit 30, pika 2 e ligjit nr.154/2014 datë 27.11.2014 “Për funksionimin dhe organizimin e KLSH, për raportimin brenda 6 muajve nga marrja e njoftimit të RPA).

A. MASA ORGANIZATIVE:

Nga KLSH janë rekomanduar Bashkisë Krujë 19 masa organizative, janë zbatuar plotësisht 9 masa, janë në proces zbatimi 9 masa dhe nuk është zbatuar 1 masë organizative për të cilën rikërkohet zbatimin e masave si vijon:

1.19.Gjetje nga auditimi: Bashkia Krujë edhe pse ka mazhorancën e aksioneve në Ujësbellës sh.a Krujë , nuk e ka përcaktuar si agjent tatimor nëpërmjet një marrëveshje, për të arkëtuar detyrimet për taksat dhe tarifatat vendore për 4474 familje, në vlerën 3,096,000 lekë, së bashku me faturat e ujit

të pijshëm, bazuar në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 5 shkronja (ii), neni 7 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore” i ndryshuar, pikës 7.1 të UMF nr. 24, datë 02.09.2008 “Për Procedurat Tatimore”, i ndryshuar, marrëveshje e cila do të rriste arkëtimin e taksave vendore dhe do rigjenerojë të ardhura për Bashkinë Krujë (*Trajtuar hollësisht në faqet 118-119, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

1.19.1 Rekomandimi: Bashkia Krujë të përgatisë aktmarrëveshjen me Ujësjelesh sh.a. Krujë , për kryerjen nga ana e këtij të fundit të agjentit tatimor për arkëtimin e taksave dhe tarifave vendore të popullatës për 4474 familje në vlerën 3,096,000 lekë, së bashku me faturat ujit të pijshëm, marrëveshje e cila duhet të miratohet në Këshillin Bashkiak bazuar në legjislacionin në fuqi.

Menjëherë

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI:

Nga verifikimi rezultoi se nga vlera e rekomanduar nga KLSH prej..... **12,339,075 lekë**

-Deri më datën 20.09.2018 është arkëtuar422,386 lekë

Kanë mbetur pa u arkëtuar vlera prej.....11,916,689lekë

Nga të cilat:

-Në proces arkëtimi 1 rekomandime në vlerën..... 27,500 lekë

-Janë nisur njoftimet për 9 rekomandime por ende nuk kanë filluar arkëtimet.....10,488,728 lekë

-Pagesa e këshilltarëve 2 rekomandime1,400,461lekë

Në mënyrë të detajuar masat shpërblim dëmi rikërkojmë si më poshtë:

1.1 - Gjetje nga auditimi: Bashkia Krujë me urdhër shpenzim nr. 128, datë 30.03.2015, në shumën 80,000 lekë, për gratë e Bashkisë ka organizuar drekë me rastin e festës së 8 Marsit, ndërsa shpenzimet e kryera në vlerën 80,000 lekë, përbën shkelje të disiplinës financiare me dëm ekonomik për buxhetin e Bashkisë, veprim në papajtueshmëri me pika 9, të VKM nr. 929, datë 17.11.2010 “Për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë”, të ndryshuar me VKM nr. 826, datë 05.12.2011, VKM nr. 849, datë 06.12.2012, pikën 1/b, të VKM nr. 472, datë 2.7.2011 “Për disiplinimin e përdorimit të fondeve buxhetore” (*Në mënyrë të detajuar janë pasqyruar në pikën C. 1 faqen 25-26, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

1.1.1 - Rekomandimi: Bashkia Krujë të marrë masa, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e pagesave të kryera për festën e 8 marsit në vlerën **80,000 lekë**.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

2.2 - Gjetje nga auditimi: Bashkia Krujë me urdhër shpenzim nr. 138, datë 03.04.2015, në shumën 298,000 lekë, anëtarët e këshillit të Bashkisë Krujë ka zhvilluar udhëtim turistike në Sofje, Bullgari. Bashkëlidhur urdhër shpenzimit nuk ndodhen: programi i hartuar nga këshilli i Bashkisë, qëllimi i udhëtimit, data, preventivi i shpenzimeve, faturat tatimore për fjetje në hotel, etj. Anëtarët e këshillit të bashkisë nuk mund të shkojnë për udhëtim turistik, ndërsa shuma 298,000 lekë, përbën shkelje të disiplinës financiare me dëm ekonomik për buxhetin e Bashkisë Krujë , veprim në papajtueshmëri me germa a pikën 3, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, të ndryshuar” (*Në mënyrë të detajuar janë pasqyruar në pikën C. 1 faqen 26-26, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

2.2.1 - Rekomandimi: Bashkia Krujë të marrë masa, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore për arkëtimin nga **17 anëtarët** e këshillit të Bashkisë Krujë të cilët janë paguar për në udhëtim turistike në Sofje, Bullgari në vlerën **298,800 lekë**.

Menjëherë

3.3 - Gjetje nga auditimi: Bashkia Krujë me urdhër shpenzim nr. 552, datë 24.06.2015, në shumën 18,000 lekë ka blerë kafe me kapsula. Institucionet shtetërore apo vendore mund të kryej shpenzime për pritje dhe përcjellje, por duke hartuar program pritje për delegacioni, qëllimin i takimit të delegacionit, numri i pjesëmarrësve, kuota e shpenzimit sipas grupeve etj. Preventivi i shpenzimeve për pritje delegacioni miratohet nga titullari i institucionit, ndërsa shuma 18,000 lekë, përbënë shkelje të disiplinës financiare me dëm ekonomik për buxhetin e Bashkisë, veprim në papajtueshmëri me germa a pikën 3, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar, me pikën 42, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, të ndryshuar dhe VKM nr. 243, datë 15.05.1995 “Për shpenzimet për pritjen, përcjelljen dhe trajtimin që u bëhet delegacioneve të huaja”, të ndryshuar, (Trajtuar hollësisht në faqet 27-28, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.3.1-Rekomandimi: Bashkia Krujë të marrë masa, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore për arkëtimin nga 2 persona sa paguar padrejtësisht për pritje përcjellje nga fondet e buxhetit të Bashkisë Krujë në vlerën **18,000 lekë**, përkatësisht:

- në vlerën 9,000 lekë, nga Sh. H. me detyrë ish-Kryetar Bashkie;
- në vlerën 9,000 lekë, R. S., me detyrë ish-Përgjegjëse e Sektorit të Financës.

Menjëherë

4.4 - Gjetje nga auditimi: Bashkia Krujë me urdhër shpenzim nr. 1804, datë 29.12.2015, në rastin e festës së Ullirit ka organizuar një drekë me 60 persona pjesëmarrës duke shpenzuar shumën 108,000 lekë, e cila përbën shkelje të disiplinës financiare me dëm ekonomik për buxhetin e Bashkisë Krujë, pagesa në kundërshtim me VKM nr. 243, datë 15.05.1995 “Për pritje dhe përcjellje dhe trajtimin që u bëhet delegacioneve të huaja”, i ndryshuar me VKM nr. 258 datë 3.6.1999 (Në mënyrë të detajuar janë pasqyruar në pikën C. 1 faqen 29-30, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.4.1-Rekomandimi: Bashkia Krujë të marrë masa, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore për arkëtimin nga 60 punonjës të Bashkisë Krujë të vlerës **108,000 lekë**.

Menjëherë

5.5 - Gjetje nga auditimi: Bashkia Krujë me urdhër shpenzim nr. 527, datë 18.03.2016, në shumën 168,300 lekë, nr. 528, datë 18.03.2016, në shumën 15,300 lekë, nr. 529, datë 18.03.2016, në shumën 45,900 lekë, për pjesëmarrje në koncertin Kombëtar të Këngës Popullore, organizuar në qytetin e Elbasanit datë 11-12.03.2016.

Ministria e Kulturës, Qendra Kombëtare e Veprimtarive folklorike Tiranë, me shkresë nr. 25/9, datë 25.01.2016, ka përcaktuar: “Grupet do të paraqiten në konkurrim me një program me gjatësi deri në 15 minuta dhe me numër pjesëmarrësish jo më shumë se 12 persona, artistë dhe staf mbështetës.”. Shpenzimet për fjetje dhe ushqim janë përballuar nga pala pritëse, ndërsa Bashkia Krujë duhet të përballonte vetëm shpenzim e transportit. Drejtoria e Financës, ka paguar 15 persona më shumë 221,400 lekë, që përbën shkelje të disiplinës financiare me dëm ekonomik për buxhetin e Bashkisë Krujë, veprim në papajtueshmëri me nenin 12 pikën 3, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar dhe VKM nr. 1173, datë 06.11.2009 “Për përcaktimin e rregullave për organizimin e ngjarjeve kulturore, artistike dhe sociale nga organet e qeverisjes qendrore dhe institucionet e tjera publike, të pavarura” (Në mënyrë të detajuar janë pasqyruar në pikën C. 1 faqen 31-32, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

5.5.1 - Rekomandimi: Bashkia Krujë të marrë masa, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore për arkëtimin nga 15 persona të vlerës **221,400 lekë**, sa paguar pa u mbështetur në dispozitë ligjore, për pjesëmarrje në koncertin Kombëtar të Këngës Popullore organizuar në qytetin e Elbasanit datë 11-12.03.2016.

Menjëherë

6.6 - Gjetje nga auditimi: Bashkia Krujë me urdhër shpenzim nr. 1682, datë 26.08.2016, në shumën **550,000 lekë**, ka paguar udhëtim e dieta personelin e Repartit ushtarak nr. 4040, Komanda Mbështetëse, Ministria Mbrojtjes Tiranë. Dhënia e dietave të plota dhe e shpenzimeve të fjetjes për punonjësit e Repartit Ushtarak nr. 4040 Tiranë, në shumën 550,000 lekë, përbën shkelje të disiplinës financiare me dëm ekonomik për buxhetin e Bashkisë, veprim në papajtueshmëri me pikën I, të VKM nr. 997, datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës”, të ndryshuar (*Në mënyrë të detajuar janë pasqyruar në pikën C. 1 faqen 32-32, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

6.6.1 - Rekomandimi: Bashkia Krujë të marrë masa, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për arkëtimin nga 10 persona te vlerës **550,000 lekë**, sa paguar pa mbështetur në dispozitë ligjore për udhëtim e dieta personelin e Repartit ushtarak nr. 4040, Komanda Mbështetëse, Ministria Mbrojtjes Tiranë.

Menjëherë

7.7- Gjetje nga auditimi: Bashkia Krujë ka kryer pagesa për shpërblimin e anëtarëve të këshillit të bashkisë të cilët, kanë munguar në mbledhjet e këshillit, duke u shpërblyer edhe për muajt në të cilët nuk janë zhvilluar mbledhjet e këshillit të bashkisë, për vitin 2015, që përbën dëmin ekonomik në vlerën 1,102,461 lekë, veprim në kundërshtim me ligjin nr. 8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, i ndryshuar, Kreu VI, neni 29, pika 2 dhe ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, neni 31, pika 2 dhe 8 (*Në mënyrë të detajuar janë pasqyruar në pikën C. 1 faqen 23-24, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

7.7.1- Rekomandim: Bashkia Krujë të marrë masa, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për arkëtimin nga 45 persona te vlerës **1,102,461 lekë**, të cilët kanë munguar në mbledhjet e këshillit për vitin 2015, ndërkohë janë shpërblyer (paguar) edhe për muajt në të cilët nuk janë zhvilluar mbledhjet e këshillit të bashkisë.

Menjëherë

7.7.3 -Rekomandim: Në kushtet e pamundësisë nga KLSH të verifikimit rast pas rasti të dokumentacionit dhe protokolleve të mbledhjeve për pagesat e këshilltarëve të ish-Komunave dhe Bashkisë, mbështetur në shkronjat (i) dhe (f) të nenit 15, -*Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së*, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”; sipas të cilit “KLSH ka të drejtë ti propozojë njësitë të auditimit të brendshëm në sektorin publik të kryejnë auditime brenda kompetencës të tyre” ; *nenit 25-Marrëdhëniet me Kontrollin e Lartë të Shtetit*, të ligjit nr. 114/2015 datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, dhe ISSAI 1600, rekomandojmë: Njësia e Auditimit të Brendshëm në Bashkinë Tuaj, në bazë të një programi tematik auditimi të miratuar nga Titullari i Bashkisë, të verifikojë të gjithë dokumentacionin mbi të cilin është bërë pagesa e këtyre këshilltarëve.

Pas verifikimit dhe saktësisimit të këtyre pagesave, **i lihet në kompetencë Kryetarit të Bashkisë**, të përcaktojë masat përkatëse në lidhje me vlerën e dëmit që duhet të kthejnë në buxhet këshilltarët. Ndalesat që bëjnë fjalë për mos llogaritjen e tatimit mbi pagë duhet te paguhet, pasi janë në kundërshtim me kërkesat e kreu II-të, neni 8 “E ardhur e tatueshme” shkronja “g”, neni 33 “Mbajtja në burim e tatimit mbi të ardhurat”, të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar me ligjin nr. 83/2014 datë 17.07.2014 dhe 156/2014 datë 27.11.2014. **Për rezultatet e auditimit të njoftohet edhe Kontrolli i Lartë i Shtetit duke dërguar edhe një kopje të Raportit Final dhe propozimet përkatëse.**

Menjëherë

8.10.-Gjetje nga auditimi: Bashkia Krujë , në objektin: “Sistemimi asfaltim i rrugës SMT - së dhe sistemimi i ujërave të sheshit pranë poliklinikës Fushë Krujë ” Krujë , nga dokumentacioni teknik i zbatimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të punimeve të ndërtimit rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në vlerën 41,920 lekë pa tvsh, në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 2019, datë 24.08.2015, lidhur ndërmjet ish-Bashkisë Fushë Krujë dhe OE “D [REDACTED]” shpk, me kontratën e mbikëqyrjes së punimeve nr. 134, datë 23.06.2013,

me kontratën e kolaudimit të punimeve pa numër datë 30.06.2015 (Trajtuar hollësisht në faqet 107-108, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

8.10.1 - Rekomandim: Bashkia Krujë të marrë masa, të kërkojë në rrugë ligjore dhe administrative arkëtimin e vlerës **41,920 lekë pa tvsh** për punime të pakryera nga “D [REDACTED]” shpk, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën nr. 2019, datë 24.08.2015 me objekt: “Sistemimi asfaltim i rrugës SMT - së dhe sistemimi i ujërave të sheshit pranë poliklinikës Fushë Krujë” Krujë.

Menjëherë

9.12 - Gjetje nga auditimi: Bashkia Krujë, në objektin: “Pastrim i shtratit të lumit Zezë” Krujë, nga dokumentacioni teknik i zbatimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të punimeve të ndërtimit rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në vlerën 160,000 lekë pa tvsh, në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 3661, datë 30.08.2016, të lidhur ndërmjet Bashkisë Krujë dhe OE “HA [REDACTED]” shpk dhe kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes nr. 3671, datë 30.08.2016 (Trajtuar hollësisht në faqet 113-114, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

9.12.1 - Rekomandim: Bashkia Krujë të marrë masa, të kërkojë në rrugë ligjore dhe administrative arkëtimin e vlerës **160,000 lekë pa tvsh** për punime të pakryera nga OE “H [REDACTED]” shpk, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën nr. 3661, datë 30.08.2016 me objekt: “Pastrim i shtratit të lumit Zezë” Krujë.

Menjëherë

10.13 - Gjetje nga auditimi: Bashkia Krujë, në objektin: “Sistemimi i segmentit të rrugës Bubq” Krujë, nga dokumentacioni teknik i zbatimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të punimeve të ndërtimit rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në vlerën 200,277 lekë pa tvsh, në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 1585, datë 30.12.2013, lidhur ndërmjet Komunës Bubq dhe OE “[REDACTED]” shpk dhe kontratës shërbimit të mbikëqyrjes nr. 3671, datë 30.08.2016 (Trajtuar hollësisht në faqet 116-117, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

10.13.1 - Rekomandim: Bashkia Krujë të marrë masa, të ndjek në rrugë ligjore dhe administrative arkëtimin e vlerës **200,277 lekë pa tvsh** për punime të pakryera nga OE “[REDACTED]” shpk, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën nr. 1585, datë 30.12.2013 me objekt: “Sistemimi i segmentit të rrugës Bubq” Krujë.

Menjëherë

11.14 - Gjetje nga auditimi: Bashkia Krujë, në objektin: “Rikonstruksion i rrugëve, Rruga nga dy segmentshi-baseni i liqenit Tarin; Shkolla Tari-Lagje e Shoteve, Bubq” Krujë, nga dokumentacioni teknik i zbatimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të punimeve të ndërtimit rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në vlerën 546,623 lekë pa tvsh, në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 1585, datë 30.12.2013, lidhur ndërmjet Komunës Bubq dhe OE “AMG-AL” shpk dhe kontratës shërbimit të mbikëqyrjes nr. 1538/1, datë 13.12.2013 (Trajtuar hollësisht në faqet 117-1118, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

11.14.1 - Rekomandim: Bashkia Krujë të marrë masa, të ndjek në rrugë ligjore dhe administrative arkëtimin e vlerës **546,623 lekë pa tvsh** për punime të pakryera nga OE “AMG-AL” shpk, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën nr. 1585, datë 30.12.2013 me objekt: “Rikonstruksion i rrugëve, Rruga nga dy segmenti shi-baseni i liqenit Tarin; Shkolla Tari-Lagje e Shoteve, Bubq” Krujë.

Menjëherë

12.15 - Gjetje nga auditimi: Bashkia Krujë, me subjektin “Fushë Kruja Cement Faktori” sha, ka lidhur kontratë nr. 407, datë 21.01.2011, me afat 10 vjeçare, për përdorim të një sipërfaqe 3.5235 ha, për prodhimin e inerteve çakull dhe gurë gëlqeror, vlera e qirasë është në shumën 1,442,918 lekë/vit e cila është llogaritur sipas VKM nr. 391, datë 21.06.2006 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të Kullotave”, të ndryshuar. Subjekti “F [REDACTED] K [REDACTED] C [REDACTED] F [REDACTED]” sha për 6 vitet 2012, 2013, 2014, 2015, 2016 dhe 2017 nuk ka likuiduar detyrimet gjithsej në **vlerën 8,657,508 lekë**, që përbën dëm ekonomik për buxhetin e Bashkisë Krujë, veprim në kundërshtim

me kushtet e Kontratës nr. 156/1, datë 20.04.2007 (Trajtuar hollësisht në faqet 131-131, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

12.15.1 - Rekomandimi: Bashkia Krujë të marrë masa, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore për të kërkuar zbatimin e kontratës nr. 407, datë 21.01.2011 dhe arkëtimin e vlerës **8,657,508 lekë**, nga subjekti “F [] K [] C [] F []”sha.

Menjëherë

7.BASHKIA DURRËS:

- Nga verifikimi rezulton se KLSH ka dërguar në Bashkinë Durrës rekomandimet e auditimit me shkresën e saj nr.1108/5 datë 20.12. 2017, protokolluar në Bashkinë Durrës me shkresën nr. 20171/18 datë 22.12.2017, ndërsa nga Bashkia Durrës për zbatim e rekomandimeve të KLSH është kthyer përgjigje me shkresën e saj nr.514 datë 10.01.2018, protokolluar në KLSH me shkresën nr. 1108/8 datë 12.01.2018. Pra përgjigja e Bashkisë për zbatimin e rekomandimeve të KLSH është bërë brenda afatit ligjor të kthimit të përgjigjes. Për zbatimin e rekomandimeve të KLSH nga Bashkia Durrës është hartuar Plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve dhe janë ngarkuar personat për zbatimin e rekomandimeve me afate konkrete.

- Nga verifikimi rezulton se përfundimet e auditimit i janë dërguar subjektit të audituar Bashkisë Durrës, me shkresën e Kryetarit të KLSH nr. 1108/5 datë 20.12. 2017 dhe duhet të raportonte në KLSH brenda 6 muajve ose brenda datës 20.06.2018 Ndërkohë nga Bashkia Durrës është raportuar brenda afatit me shkresën nr. 10938/1 datë 22.06.2018 protokolluar në KLSH me shkresën nr. 1108/12 datë 25.06.2018.

A. MASA ORGANIZATIVE:

Nga KLSH janë rekomanduar Bashkisë Durrës 9, masa organizative, janë zbatuar plotësisht 4 masa, janë në proces zbatimi 1 masë dhe nuk janë zbatuar 4 masa organizative për të cilat rikërkojmë zbatimin e masave si vijon:

1.1. Gjetje nga auditimi: Asgjësimet e materialeve për inventarët jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata e afat shkurtër në vitin 2016, që i përkasin inventarëve të vitit 2015, nuk kundrojnë me pasqyrën “Mbi ndryshimet në aktivet e qëndrueshme” (formati nr. 6), në vlerën **5,560,132 lekë**, pasi procesverbali i komisionit asgjësimit datë 10.08.2016 përmban vlerën 21,285,233 lekë, ndërsa në bilanc është shkarkuar për vlerën 26,845,365 lekë, pra shkarkuar më shumë në kontabiliteti për vlerën **5,560,132 lekë** (Trajtuar në faqen 40-52, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1.1. Rekomandimi: Nëpunësi urdhërues i Bashkisë Durrës, të marrë masa sistemimin e vlerës me dokumentacionin mbështetës, si dhe vënien para përgjegjësisë të personave përgjegjës.

Menjëherë

2.7. Gjetje nga auditimi: Në kontratat e qirasë të lidhura me të tretë nga ndërmarrjet e varësisë (respektivisht Ndërmarrja Parku Mallrave të Eksportit dhe Ndërmarrja e Tregtisë me Shumicë, sipas kontratave të paraqitura në pasqyrën Aneks 6, bashkëlidhur Raport Auditimit), konstatohet se nuk është bërë derdhjen e detyrimit në favor të Bashkisë Durrës për 50 % të ardhurave nga këto kontrata, veprime në papajtueshmëri me Kapitulli III- “Tarifat dhe vlera dysheme për pasuritë shtetërore që jepen me qira ose enfiteozë, pika 1 dhe 2, të VKM nr. 54, datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kritereve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, i ndryshuar, duke i sjellë të ardhura të munguara për Bashkinë Durrës në vlerën **6,278,269 lekë**, konkretisht: Ndërmarrja Parku Mallrave të Eksporti në vlerën 3,589,175 lekë dhe Ndërmarrja e Tregtisë me Shumicë në vlerën 2,689,094 lekë (Trajtuar në faqen 163-165, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.7.1. Rekomandimi: Bashkia Durrës në bashkërendim me ndërmarrjet e varësisë, Ndërmarrja Parku Mallrave të Eksportit dhe Ndërmarrja e Tregtisë me Shumicë, të marrë masa për kryerjen e

rakordimeve financiare për kalimin në favor të Bashkisë Durrës të vlerës vlerën **6,278,269 lekë**, konkretisht: Ndërmarrja Parku Mallrave të Eksportit në vlerën 3,589,175 lekë dhe Ndërmarrja e Tregtisë me Shumicë në vlerën 2,689,094 lekë (*Sipas pasqyrës Aneks 6*).

Menjëherë

3.8. Gjetje nga auditimi: Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Vendor në Bashkinë Durrës, nuk ka arkëtuar gjobat për shkeljet e konstatuara në ndërtimet pa leje ndërtimi, si dhe nuk ka ndjekur në rrugë ligjore me padi në gjykatë për 33 raste në vlerën 13,300,000 lekë, që përbëjnë të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë, veprim në kundërshtim me ligjin nr. 10279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative” nenet 20, 30 dhe ligjin nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për Inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, të ndryshuar (*Trajtuar hollësisht në faqet 161-163 , të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

3.8.1 Rekomandimi: Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Vendor (IMTV) dhe Drejtoria Juridike të marrë masat dhe të kërkojë në Gjykatë rivendosjen në afat për 33 vendime me gjobë për ndërtimet e kundërligjshme, të vendosura gjatë vitit 2017 në vlerën **13,300,000 lekë**, bazuar në nenet 151 dhe 152, të “Kodit Procedurës Civile në RSH”.

Njëherazi të marrë masa për kthimin e vendimeve të gjobave në tituj ekzekutiv në zbatim të nenit 24 -Shndërrimi i vendimit për kundërvajtjen administrative në titull ekzekutiv të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”(Sipas pasqyrës Aneks 8, bashkëlidhur Raport auditimit).

Menjëherë

4.9.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Durrës të analizojë me grup pune sipas përkatësive arsyet e mos zbatimit të rekomandimeve dhe të nxjerrë aktet administrative për arkëtimin e shpërblimit të dëmit në vlerën 21,900 mijë lekë, ndaj personave përgjegjës (*sipas rekomandimeve të paraqitura në germën “B” dhe “D”*), dhe të masave organizative me mungesë të ardhurash në vlerën 53,834 mijë lekë, dërguar me shkresën nr. 197/8, datë 30.06.2013, dhe të rikërkuara nga KLSH me shkresën nr. 1016/27, datë 30.6.2014.

Menjëherë

IV/3-B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI:

Nga verifikimi rezultoi se nga vlera e rekomanduar nga KLSH prej..... **20,245,264 lekë**

-Deri më datën 15.09.2018 është arkëtuar vlera prej **5,730,760 lekë**

Kanë mbetur pa u arkëtuar vlera prej..... 14,514,504lekë

Nga të cilat:

-Në proces arkëtimi 2 rekomandim në vlerën.....4,421,214 lekë

-Janë nisur njoftimet për 3 rekomandime por ende nuk kanë filluar arkëtimet...10,093,290 lekë

Në mënyrë të detajuar masat shpërblim dëmi rikërkojmë si më poshtë:

1.1. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e dy dosjeve të subjekteve me aktivitet “hoteleri dhe restorant”, u konstatua të ardhura të munguara në vlerën prej **967,640 lekë**, si rezultat i mos llogaritjes të saktë të taksës së ndërtesës dhe truallit funksional, për sipërfaqen totale që subjekti disponon (ndërtesë + truall funksional) në vitet 2016 - 2017, respektivisht në vlerën **555,200 lekë** për subjektin “R [REDAKTUAR]” A [REDAKTUAR]” shpk, i cili rezulton dhe me gjendje debitorë nga viti 2012 në shumën prej **3,025,614 lekë** dhe vlera prej **412,440 lekë** për subjektin “U [REDAKTUAR] I [REDAKTUAR]” dhe me gjendje debitorë prej **794,430 lekë** (*Trajtuar në faqen 138-153, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

1.1.1. Rekomandimi: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore Bashkia Durrës, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyqimit të gjitha rrugët ligjore për njoftimin dhe arkëtimin e detyrimeve në vlerën **4,795,684 lekë**, respektivisht:

-vlera 3,580,814 lekë, ndaj subjektit “R [REDACTED] I [REDACTED]” Ar [REDACTED] shpk, nga e cila detyrim i pa arkëtuar në vlerën 3,025,614 lekë dhe detyrim pataksuar për taks ndërtese në vlerën 555,200 lekë.

-vlera 1,206,870 lekë ndaj subjektit “U [REDACTED] I [REDACTED]”, shpk, nga e cila detyrim i pa arkëtuar në vlerën 794,430 lekë dhe detyrim pataksuar për taks ndërtese në vlerën 412,440 lekë.

Menjëherë

2.2. Gjetje nga auditimi: Nga Ndërmarrja e Tregtisë me Shumicë (Njësia vartëse e Bashkisë Durrës), janë dhënë me qira kundrejt kontratave prona në administrim të Bashkisë Durrës, sipas VKM nr. 536, datë 01.05.2008 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike shtetërore që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të Bashkisë Durrës, Qarkut Durrës”, ku për vitin 2015 është dhënë një sipërfaqe gjithsej 2077.8 m² dhe për vitin 2016 një sipërfaqe gjithsej 2064.4 m², për të cilat nuk është paguar detyrimi për qiranë në vlerën **995,940 lekë**, nga e cila vlera prej 200,900 lekë për sipërfaqen 717.5 m² (viti 2016) dhe vlera prej 795,040,4 lekë për sipërfaqen 2,839.43 m² (viti 2017)(Trajtuar në faqen 138-153, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.2.1 Rekomandimi: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore në bashkërendim me Ndërmarrjen e Tregtisë me Shumicë në Bashkinë Durrës, të marrë masa që të kontabilizohet dhe arkëtohet detyrimi në masën prej **995,940 lekë**, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit ndaj qiramarrësve.

Menjëherë

3.3. Gjetje nga auditimi: Bashkia Durrës për periudhën objekt auditimi ka lidhur kontrata qiraje me të tretët për dhënie me qira të hapësirës publike plazh, në vitin 2015 për 55 kontrata për vlerë totale 7,900,000 lekë, në vitin 2016 për 143 kontrata për vlerë totale 24,770,660 lekë dhe në vitin 2017 për 203 kontrata për sipërfaqen vlerë totale 32,516,220 lekë. Për të tre vitet rezultoi se është arkëtuar në total vlera 60,379,340 lekë nga 65,186,880 lekë që është detyrimi i lindur nga këto kontrata, duke shkaktuar të ardhura të munguara me dëm në **vlerën 4,807,540 lekë nga 14 kontrata** (Trajtuar në faqen 150-153, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.3.1. Rekomandimi: Bashkia Durrës të marrë masa duke kontabilizuar dhe kërkuar në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës prej **4,807,540 lekë**, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit ndaj qiramarrësve qira të hapësirës publike plazh. Bashkia Durrës për 14 qiramarrësit të cilët nuk kanë shlyer detyrimet e mëparshme të mos lidh kontrata për vitin 2018 e në vazhdim (sipas regjistrit në Bashkinë Durrës dhe pasqyrës Aneksit 7, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar Auditimit).

Menjëherë

4.4. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e dokumentacionit teknik të zbatimit dhe mbikëqyrjes të punimeve të ndërtimit të administruara në dosjen teknike, si dhe nga verifikimi në terren të objektit “Rikonstruktion i Rrugës Juba në L. 18, Ish Kënetë” me vlerë 26,612,640 lekë, Bashkia Durrës, rezultuan diferenca me dëm ekonomik në vlerë 683,350 lekë pa tvsh për punime të pakryera, nga të cilat vlera 369,550 lekë pa tvsh për punime të pakryera në fakt dhe vlera 313.800 lekë pa tvsh, si pasojë ndryshimit të zërave të punimeve pa u shoqëruar me çmimin përkatës, veprimet në kundërshtim me nenin 7, të ligjit nr. 8402 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Udhëzimin nr. 1, datë 16.06.2011 “Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001 të Këshillit të Ministrave “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, pika 3.2 dhe 3.3, kontratën për mbikëqyrjen e punimeve lidhur me Autoritetit Kontraktor Bashkia Durrës dhe mbikëqyrësit të punimeve Ing. A [REDACTED] T [REDACTED], Ing. B [REDACTED] S [REDACTED] dhe Ing. F [REDACTED] E [REDACTED], neni 4 dhe neni 6 pika 1, Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kreu II, pika 8.1 dhe 8.3, Udhëzimin nr. 2 datë 13.05.2005 “Për zbatimin punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kreu II, pikat 3 (Trajtuar në faqen 98-138, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.4.1. Rekomandimi: Drejtoria e Shërbimeve në Bashkinë Durrës, të marrë masa për zërat e punimeve të konstatuara me mangësi, duke kryer riparimet përkatës/ose shpërblimit të dëmit për

vlerën e punimeve të pakryera me vlerën **683,350 lekë pa tvsh** nga OE “S [REDAKTUAR]” Shpk, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën nr. 8291, datë 11.12.2014 me objekt “Rikonstruksion i Rrugës Juba në L.18, Ish Këneta”.

Gjetje nga auditimi: Në auditimin e dokumentacionit teknik të zbatimit dhe mbikëqyrjes të punimeve të ndërtimit të administruara në dosjen teknike, si dhe nga verifikimi në terren të objektit “Rikonstruksion i Rrugës Juba në L. 18, Ish Këneta” me vlerë 26,612,640 lekë, Bashkia Durrës, rezultuan diferenca me dëm ekonomik në vlerë 683,350 lekë pa tvsh për punime të pakryera, nga të cilat vlera 369,550 lekë pa tvsh për punime të pakryera në fakt dhe vlera 313.800 lekë pa tvsh, si pasojë ndryshimit të zërave të punimeve pa u shoqëruar me çmimin përkatës, veprimet në kundërshtim me nenin 7, të ligjit nr. 8402 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Udhëzimin nr. 1, datë 16.06.2011 “Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001 të Këshillit të Ministrave “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, pika 3.2 dhe 3.3, kontratën për mbikëqyrjen e punimeve lidhur me Autoritetit Kontraktor Bashkia Durrës dhe mbikëqyrësit të punimeve Ing. Adnan Toçila, Ing. Bashkim Salillari dhe Ing. Fatmir Ejupi, neni 4 dhe neni 6 pika 1, Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kreu II, pika 8.1 dhe 8.3, Udhëzimin nr. 2 datë 13.05.2005 “Për zbatimin punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kreu II, pikat 3 (Trajtuar në faqen 98-138, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.1. Rekomandimi: Drejtoria e Shërbimeve në Bashkinë Durrës, të marrë masa për zërat e punimeve të konstatuara me mangësi, duke kryer riparimet përkatës/ose shpërblimit të dëmit për vlerën e punimeve të pakryera me vlerën **683,350 lekë pa tvsh** nga OE “S [REDAKTUAR]” Shpk, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën nr. 8291, datë 11.12.2014 me objekt “Rikonstruksion i Rrugës Juba në L.18, Ish Këneta”.

Menjëherë

5.6. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e dokumentacionit teknik të zbatimit dhe mbikëqyrjes të punimeve të ndërtimit të administruara në dosjen teknike, si dhe nga verifikimi në terren të objektit “Ndërtim i Rrugës Paralel me Murin e Portit” me vlerë 199,898,920 lekë, Bashkia Durrës, rezultuan diferenca me dëm ekonomik në vlerën **8,414,000 lekë pa tvsh** për punime të pakryera, në kundërshtim me kontratën nr. 5176, datë 03.09.2014 lidhur me sipërmarrësin “F [REDAKTUAR]” Shpk, me objekt “Ndërtim i Rrugës Paralel me Murin e Portit”, Bashkia Durrës (Trajtuar në faqen 98-138, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

5.6.1. Rekomandimi: Drejtoria e Shërbimeve në Bashkinë Durrës, të marrë masa për zërat e punimeve të konstatuara me mangësi, duke kryer riparimet përkatës/ose shpërblimit të dëmit për vlerën e punimeve të pakryera me vlerën **8,414,000 lekë pa tvsh** nga OE “F [REDAKTUAR]” Shpk, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën nr. 5176, datë 03.09.2014 me objekt “Ndërtim i Rrugës Paralel me Murin e Portit”, Bashkia Durrës.

Menjëherë

C. MASA DISIPLINORE:

C.1. Për punonjësit që janë pjesë e shërbimit civil.

Në mbështetje të shkronjës (c) neni 15 -Të drejtat dhe detyrat e KLSH-sëtë ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, në zbatim të nenit 58, “Ilojet e masave disiplinore” të ligjit nr. 152/2013 datë 30.5.2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil” **KLSH i rekomandon** Kryetarit të Bashkisë Durrës, që **ti rikërkojë** Komisionit disiplinor fillimin e procedurave për dhënien e masës disiplinore, “Vërejtje” e parashikuar në nenin 58, germa “a” deri në masën “Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në 1 vit” e parashikuar në nenin 58, germa “c”, për **6 punonjës** si më poshtë:

1. Znj. H [REDAKTUAR] H [REDAKTUAR], me funksion Përgjegjëse e Sektorit të Financës.

2. Z. Sh [REDACTED] H [REDACTED], me funksion Specialist i Sektorit të Kontrollit të Taksave dhe Tarifave Vendore.
3. Z. L [REDACTED] B [REDACTED], me funksion Specialist në Sektorin e të Ardhurave në DTTV.
4. Zj. D [REDACTED] B [REDACTED], me funksion Drejtoresh e Drejtorisë Ligjore, në cilësinë e anëtarit të KVO.
5. Zj. M [REDACTED] S [REDACTED], Specialiste në Drejtorinë e Shërbimeve në cilësinë e anëtarit të KVO.
6. Zj. E [REDACTED] K [REDACTED], Specialiste në Drejtorinë e Shërbimeve në cilësinë e anëtarit të KVO.

Menjëherë

8. BASHKIA DURRËS (Auditimi Financiar)

-Nga verifikimi rezulton se KLSH ka dërguar në Bashkinë Durrës rekomandimet e auditimit me shkresën e saj nr 775/18 datë 15.12.2017, protokolluar në Bashkinë Durrës me shkresën nr. 20171/17 datë 20.12.2017, ndërsa nga Bashkia Durrës për zbatim e rekomandimeve të KLSH është kthyer përgjigje me shkresën e saj nr.364/1 datë 08.01.2018, protokolluar në KLSH me shkresën nr. 775/19 datë 09.01.2018. Pra përgjigja e Bashkisë për zbatimin e rekomandimeve të KLSH është bërë brenda afatit ligjor të kthimit të përgjigjes. Për zbatimin e rekomandimeve të KLSH nga Bashkia Durrës është hartuar Plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve dhe janë ngarkuar personat për zbatimin e rekomandimeve me afate konkrete.

- Nga verifikimi rezulton se përfundimet e auditimit i janë dërguar subjektit të audituar Bashkisë Durrës, me shkresën e Kryetarit të KLSH nr. 775/18 datë 15.12. 2017 dhe duhet të raportonte në KLSH brenda 6 muajve ose brenda datës 15.06.2018, ndërkohë nga Bashkia Durrës është raportuar më shkresën nr. 10938, datë 20.06.2018.

A. MASA ORGANIZATIVE:

Nga KLSH janë rekomanduar Bashkisë Durrës 13 masa organizative, janë zbatuar plotësisht 11 masa, është në proces zbatimi 1 masë dhe nuk është zbatuar 1 masë organizative, për të cilën rikërkojmë zbatimin e masës si vijon:

1.3. Gjetje nga auditimi: Përpunimi i të dhënave mbi transaksionet, mbajtja e kontabilitetit dhe përpilimi i pasqyrave financiare realizohet me program Office Excel dhe jo me ndonjë software më të përshtatshëm. Kjo ul sigurinë e përpunimit të informacionit kontabël dhe rrit mundësinë për gabime dhe manipulime.

1.3.1 Rekomandim: Drejtoria Ekonomike në Bahskinë Durrës të marrë masa për aplikimin e një programi të përpunimit elektronik të kontabilitetit dhe përgatitjes së Pasqyrave Financiare.

Menjëherë

9. BASHKIA DURRËS (ish komunat) :

-Nga verifikimi rezulton se KLSH ka dërguar në Bashkinë Durrës rekomandimet e auditimit me shkresën e saj nr 1108/5 datë 20.12. 2017, protokolluar në Bashkinë Durrës me shkresën nr. 20171/18 datë 20.12. 2017, ndërsa nga Bashkia Durrës për zbatim e rekomandimeve të KLSH është kthyer përgjigje me shkresën e saj nr.702 datë 12.01.2018, protokolluar në KLSH me shkresën nr. 1108/9 datë 15.01.2018. Pra përgjigja e Bashkisë për zbatimin e rekomandimeve të KLSH është bërë brenda afatit ligjor të kthimit të përgjigjes. Për zbatimin e rekomandimeve të KLSH nga Bashkia Durrës është hartuar Plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve dhe janë ngarkuar personat për zbatimin e rekomandimeve me afate konkrete.

- Nga verifikimi rezulton se përfundimet e auditimit i janë dërguar subjektit Bashkia Durrës, me shkresën e Kryetarit të KLSH nr. 1108/5 datë 20.12. 2017 dhe duhet të raportonte në KLSH brenda 6 muajve ose brenda datës 20.06.2018. Ndërkohë nga Bashkinë Durrës është raportuar brenda afatit me shkresën nr.11246, datë 25.06.2018 protokolluar në KLSH me shkresën 1108/13 datë 26.06.2018.

A. MASA ORGANIZATIVE:

Nga KLSH janë rekomanduar Bashkisë Durrës 6 masa organizative, janë zbatuar plotësisht 3 masa, janë në proces zbatimi 2 masa dhe nuk është zbatuar 1 masë organizative për të cilën rikërkojmë zbatimin e masës si vijon:

1.3. Gjetje nga auditimi: Në ish-Komunën Ishëm janë lidhur 10 kontrata për dhënie me qira të hapësirës publike për plazh me rërë me kohëzgjatje 10 vjet, nga e cila në vitin 2013 një sipërfaqe prej 12446 m², në vitin 2014 një sipërfaqe prej 35670 m² dhe në vitin 2015 një sipërfaqe prej 32970 m² (pasqyra aneks 4, bashkëlidhur Raport Auditimit), veprim në kundërshtim me VKM nr. 369, datë 18.05.2016 “Për miratimin e rregullores “Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit”, që rregullojnë këtë marrëdhënie kontraktuale në nenin 4, pika 8, pasi kontratat janë lidhur përpara hyrjes në fuqi të këtij VKM nr. 369, e përcakton afat deri në 3 vite për dhënie me qira të hapësira publike (plazh) (Trajtuar në faqen 144-149, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.3.1. Rekomandimi: Bashkia Durrës të marrë masa për rishqyrtimin e kontratave të qirasë, duke vlerësuar deri në anulimin e tyre, pasi janë në kundërshtim me VKM nr. 369, datë 18.05.2016 “Për miratimin e rregullores “Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit”, që rregullojnë këtë marrëdhënie kontraktuale në nenin 4, pika 8- “Sanksionon”, ku shprehet se: “Kontrata për dhënie në përdorim të hapësirave të plazhit mund të nënshkruhet me afat deri në 1 vit, me të drejtë rinovimi deri në 3 vjet.”.

Menjëherë

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI:

Nga verifikimi rezultoi se nga vlera e rekomanduar nga KLSH prej..... **23,211,986** lekë

-Deri më datën 15.09.2018 është arkëtuar199,837 lekë

Kanë mbetur pa u arkëtuar vlera prej.....23,012,149lekë

Nga të cilat:

-Janë nisur njoftimet për 7 rekomandime por ende nuk kanë filluar arkëtimet..... 23,012,149 lekë

Në mënyrë të detajuar masat shpërblim dëmi rikërkojmë si më poshtë:

1.1.Gjetje nga auditimi: Në ish-Komunën Ishëm janë lidhur kontrata qiraje (me të tretë), për dhënie me qira të hapësirës publike (plazh), ku për vitin 2013 janë 20 kontrata për vlerën 2,240,280 lekë, për vitin 2014 janë 26 kontrata për vlerën 6,420,600 lekë, për vitin 2015 janë 20 kontrata për vlerën 7,118,340 lekë. Në total nga vlera e planifikuar prej 15,779,220 lekë është arkëtuar vlera 9,652,820 lekë dhe mbetet pa arkëtuar **vlera 6,126,400 lekë nga 18 kontrata**, e cila nuk është pasqyruar si debitorë në kontabilitet dhe përbën të ardhura të munguar në buxhetin e ish-Komunës Ishëm aktualisht Njësi administrative në përbërje të Bashkisë Durrës (Trajtuar në faqen 144-149, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1.1. Rekomandimi: Drejtoria e Taksave e Tarifave Vendore në bashkëpunim me Drejtorinë Ekonomike dhe Policinë Bashkiake, Bashkia Durrës, të marrë masa duke kontabilizuar dhe kërkuar në rrugë ligjore dhe ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit ndaj qiramarrësve për arkëtimin e vlerës **6,126,400 lekë**(Sipas pasqyrës Aneks 4, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Menjëherë

2.2. Gjetje nga auditimi: Në ish-Komunën Rrashbull, janë lidhur 4 (katër) kontrata me subjektin “E []” Shpk, përfaqësuar nga z. E [] Sh [] sipas ligjit nr. 9385, datë 04.05.2005 “Për dhënie me qira të sipërfaqeve pyjore ose tokave pa fryt shkurre, etj.,” neni 9, i VKM nr. 314, datë 12.03.2008 dhe ligjin nr. 8744, datë 22.02.2001 “Për transferimin pronave publike në njësinë e qeverisjes vendore, me afat 30 vjeçare me sipërfaqe 61.9 lekë/ha me çmim total kontratash/vit

në vlerën 1,238,200 lekë. Totali i investimit për 4 (katër) kontrata sipas konkurrimit të subjektit privat është në vlerën 350,133,450 lekë.

Nga verifikimi i dokumentacionit deri datë 30.06.2015 (*Reforma administrative*), nga subjekti është shlyer detyrimi i kontratave për llogari të vitit 2008 (1,238,200 lekë) dhe për vitet e mëvonshme është ndërprerë shlyerja e këtij detyrimi, pavarësisht se për çdo vit janë përsëritur kontratat.

Nga dokumentacioni në dosje, subjekti nuk i ka shlyer detyrimet me pretendimin se ka kryer investime, por referuar kontratave bazë (mbi të cilën janë lidhur dhe kontratat në vijimësi), për çdo vit konstatohet se nga subjekti nuk janë përmbushur nenet e kontratës, respektivisht:

Në nenin 2.2 “Çmimi i qirasë është 20,000 lekë/ ha, çmim i cili do të paguhet menjëherë vitin e parë, ndërsa më pas do të kompensohet nëpërmjet investimeve të palës qiramarrëse për shndërrimin e pronës sipas objektit.

Në nenin 3.3, “Pala qiradhënëse njeh investimet e palës tjetër për kthimin në eficensë të pasurisë në aktivitet prodhues me qëllim rritjen e vlerës së saj. Në përfundimin e afatit të kontratës sipas pikës 2.1 pranon rivlerësimin e pronës duke kompensuar kështu detyrimin me vlerën e investimit dhe njohur pjesën tjetër për efekt parablerje të saj.

Nga ish- Komuna Rrashbull nuk është zbatuar neni 4.1, i kontratës pasi nuk janë siguruar bilancet e subjektit privat, të certifikuara në Degën Rajonale Tatimore Durrës, numrin e të punësuarve nga sigurimet shoqërore, preventivat dhe situacionet vjetore. Në këto kushte subjekti privat referuar nenit 2 të kontratës “Kohëzgjatja dhe çmimi”, duhej që për çdo vit të shlyente rregullisht komunës çmimin e kontratave vjetore në vlerën **9,905,600 lekë** (për 4 kontrata të lidhura në vitin 2008 dhe të përsëritura nga ish-Komuna për vitet 2009-2017), që përbën të ardhura dëm ekonomik, veprim në kundërshtim me germën (c) të udhëzimit të KM nr. 3, datë 16.05.2007 “Për procedurën e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara”, i ndryshuar (*Trajtuar në faqen 145-149, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

2.2.1. Rekomandimi: Drejtoria e Pronave në Bashkinë Durrës, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyqimit për arkëtimin e vlerës **9,905,600 lekë** nga subjekti privat “E [REDAKTUAR] “Shpk”, si dhe të rishikojë kushtet e kontratave bazë të lidhura në vitin 2008, konkretisht nenet 2.2 dhe 33 të kontratës, duke rënë në marrëveshje me qiramarrësin sipas germën (c) të udhëzimit të KM nr. 3, datë 16.05.2007 “Për procedurën e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara”, i ndryshuar. Nëse nuk sistemohet me marrëveshje e mirëkuptim midis palëve, Bashkia Durrës të kërkojë prishje e menjëhershme e kontratës për mos përmbushje të detyrimeve.

Menjëherë

3.3. Gjetje nga Auditimi: Në ish- Komunën Katundi i Ri me urdhër shpenzimin nr. 103, datë 23.06.2015, janë likuiduar për periudhën Dhjetor 2014 - Qershor 2015, shpenzime për celular në emër të ish Kryetarit të Komunës z. H [REDAKTUAR] P [REDAKTUAR], në vlerën **28,000 lekë**, veprim në kundërshtim me pikën 9 dhe 11, të VKM nr. 864, datë 23.07.2010 “Për Pajisjen me numër telefoni celular të personave juridikë, publikë”, duke shkaktuar dëm ekonomik (*Trajtuar në faqen 51-53, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

3.3.1. Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike, Bashkia Durrës, të marrë masat duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët për arkëtimin e vlerës **28,000 lekë**, ndaj ish- Kryetarit të Komunës Katundi i Riz. H [REDAKTUAR] P [REDAKTUAR].

Menjëherë

4.4. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e dokumentacionit teknik të zbatimit dhe mbikëqyrjes së punimeve të ndërtimit të administruara në dosjen teknike të objektit “Rikonstruksion Rruga Maminas –Shën Pjetër” me vlerë kontrate 15,938,450 lekë në ish- Komunën Ishëm, rezultuan diferenca në vlerë për punime të pakryera duke shkaktuar dëm ekonomik në vlerën **2,651,640 lekë pa tvsh**, në kundërshtim me ofertën e paraqitur në tender dhe kontratën nr. 5 prot, datë 25.06.2013 të lidhur ndërmjet ish- Komunën Ishëm dhe sipërmarrësit “V [REDAKTUAR] - E [REDAKTUAR]” Shpk (*Trajtuar në faqen 127-132, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

4.4.1.Rekomandimi: Drejtoria e Shërbimeve në Bashkinë Durrës, të marrë masa për realizimin e zërave të punimeve të pa kryera, duke kryer riparimet përkatës/ose shpërblimit të dëmit për punime të pakryera me vlerën **2,651,640 lekë pa tvsh** nga OE “V - E” Shpk, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën nr. 5 prot, datë 25.06.2013 me objekt “*Rikonstruksion Rruga Maminas-Shën Pjetër*”.

Menjëherë

5.5. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e kushteve të zbatimit të kontratës nr. 5, datë 25.6.2013, nenin II “*Afati i kontratës*” (3 muaj), të lidhur midis ish Kryetarit të Komunës Ishëm dhe subjektit “V -E” me objekt “*Rikonstruksion rruga Maminas-Shënpjetër, viti 2013*”, me vlerë kontrate 15,938,450 lekë, konstatohet se nga subjekti nuk është respektuar afati i përfundimit të punimeve për **76 ditë vonesë**, për të cilën nuk është bërë i mundur llogaritja e kamat vonesave në vlerën **2,757,795 lekë**, dëm ekonomik në buxhet (*Trajtuar në faqen 88-90, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

5.5.1. Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike Bashkia Durrës, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët për arkëtimin e vlerës **2,757,795 lekë** ndaj subjektit “V -E”.

Menjëherë

6.6. Gjetje nga Auditimi: Nga krahasimi i çmimit të disa zërave të preventivit me çmimet e manualit (viti 2013), konstatohet se është preventivuar më tepër fond limit në vlerën **374,513 lekë pa TVSh**, duke shkaktuar dëm ekonomikndaj buxhetit të njësisë vendore si pasojë e rritjes fiktive të çmimeve jo në përputhje me manualin teknik të çmimeve gjatë hartimit të projekt-preventivit të objektit: “*Lyrje fasadash në Bashkinë Sukth*”, veprimnë kundërshtim me ligji nr. 8402, datë 10.09.1998 “*Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit*”, i ndryshuar, Kreu I, neni 3, si dhe Vendimi nr. 514, datë 15.08.2007 “*Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit*, ndryshuar me Vendim nr. 664, datë 26.09.2012 “*Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 514, datë 15.08.2007 të Këshillit të Ministrave “Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit”, e konkretisht pikat 2, 3, 9 (Trajtuar në faqen 76-78, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*.

6.6.1. Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike Bashkia Durrës, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët për arkëtimin e vlerës **374,513 lekë**, ndaj grupit të punës për hartimin e preventivit, *respektivisht:*

-vlera **124,837 lekë** ndajz. O G me funksion ish- Inspektor i Mbrojtjes Civile;

-vlera **124,837 lekë** ndajz. M H me funksion ish specialiste SAMT në NJA Sukth;

-vlera **124,837 lekë** ndaj z. B H me funksion ish Specialist të Zyrës së PZHT.

Menjëherë

7.7. Gjetje nga auditimi: Në tenderin me objekti “*Rikonstruksion i rrugës ura e Teqesë në fshatin Arapaj*” me vlerë kontrate fillestare 6,467,094 lekë, në ish- Komunën Rrashbull, me kërkesë të mbikëqyrësit të punimeve datë 20.11.2014 Ing. L H është kërkuar shtesë kontrate për zërin e punimeve “*Shtresë stabilizanti 610 m², cakulli, beton në rrugë C25-30 prej 46.5 m³, FV hekur 8 ton*, për të cilën ka paraqitur kërkesë subjekti “V E”, për vlerën 1,293,419 lekë.

Në auditimin e dosjes teknike, konstatohet se dokumentacioni që ndodhet nuk është në zbatim të ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “*Për Kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit*”, i ndryshuar dhe udhëzimit nr. 2, datë 13.05.2005 “*Për zbatimin e punimeve të ndërtimit*”, Kreu I- “*Sipërmarrësi i punimeve të ndërtimit*”, pika 7.1, pasi: -*Nuk është bërë ndryshimi në preventivin fillestar të punimeve nga personat përgjegjës që e kanë hartuar atë; -Referuar procesverbalit datë 21.11.2014 të mbajtur nga mbikëqyrësi Ing. L H, sipërmarrësi “V E” dhe përgjegjësi i urbanistikës Ing. P B, në paragrafin e fundit thuhet se: “. ndryshimet e paraqitura në preventivin e ripunuar si dhe zërat e punimeve që nuk janë parashikuar në preventivin tenderit me qëllim negocim e çmimeve”.* Nga verifikimi i preventivit të punimeve

konstatohet se këto zëra punimesh janë të pasqyruara dhe nuk mungojnë; -Në procesverbal nuk argumentohet me saktësi dhe volumet përkatës arsyeja e kësaj shtese.

-Nuk ka projekt dhe preventiv të azhurnuar për përcaktimin e fondit limit, veprime në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Kreu I pika 3/b, Kreu II pika 2/c dhe kreu V pika 1, si dhe nuk është paraqitur asnjë dokumentacion nga investitori për ndryshimin projektit fillestar (projekt i korrigjuar), për të treguar dhe argumentuar kërkesat e subjektit për punimet shtesë, veprime me efekt negativ me dëm në buxhetin e ish Komunës Rrashbull për rëndim të shpenzime të paargumentuara me dokumentacion ligjorë në vlerën **1,293,038 lekë pa tvsh** (Trajtuar në faqen 103-105, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

7.7.1. Rekomandimi: Mbështetur në shkronjën (i) dhe (f) të nenit 15 –“Të drejtat dhe detyrat e KLSH”, të ligjit nr. 154/2015, datë 22.10.2015 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” dhe nenit 25- “Marrëdhëniet me Kontrollin e Lartë të Shtetit”.

Drejtoria e Shërbimeve Bashkia Durrës, në bazë të një programi tematik të miratuar nga Titullari i Bashkisë Durrës, të verifikojë në vend zbatimin e punimeve të kontratës shtesë sipas zërave të preventivit të objektit “Rikonstruksion i rrugës ura e Teqesë në fshatin Arapaj” dhe kushteve të kontratës nr. 4, datë 17.10.2014 për saktësimin e vlerës **1,293,038 lekë** në ngarkim të subjektit “V- E”.

Menjëherë

C. MASA DISIPLINORE:

C.1. Për punonjësit që janë pjesë e shërbimit civil.

Në mbështetje të shkronjës (c) neni 15 -Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, nenin 37 të ligjit nr. 7691, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar dhe kontratës individuale të punës, neni 11, **KLSH i rekomandon Kryetarit të Bashkisë Durrës**, rifillimin e procedurave për dhënien e masës disiplinore, nga “Vërejtje” deri në “Zgjidhje të kontratës së punës”, për **1 punonjës**, si më poshtë:

1. Z. V S me detyrë specialist kadastre në NJA Rrashbull, në cilësinë ish- Përgjegjës i Zyrës Urbanistikës në ish- Komunën Rrashbull.

Menjëherë

10.BASHKIA DIVJAKË:

- Nga verifikimi rezulton se KLSH ka dërguar në Bashkinë Divjakë rekomandimet e auditimit me shkresën e saj nr. 779/1, datë 20.12.2017, protokolluar në Bashkinë Divjakë me shkresën nr.5626, datë 22.12.2017, ndërsa nga Bashkia Divjakë për zbatim e rekomandimeve të KLSH është kthyer përgjigje me shkresën e saj nr.575, datë 19.02.2018, protokolluar në KLSH me shkresën nr. 779/12, datë 19.02.2018. Pra përgjigja e Bashkisë për zbatimin e rekomandimeve të KLSH është bërë brenda afatit ligjor të kthimit të përgjigjes. Për zbatimin e rekomandimeve të KLSH nga Bashkia Divjakë është hartuar Plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve dhe janë ngarkuar personat për zbatimin e rekomandimeve me afate konkrete.

- Nga verifikimi rezulton se përfundimet e auditimit i janë dërguar subjektit të audituar Bashkisë Divjakë, me shkresën e Kryetarit të KLSH nr.779/11 datë 20.12.2017 dhe duhet të raportonte në KLSH brenda 6 muajve ose brenda datës 20.06.2018, ndërkohë nga Bashkia Divjakë është raportuar me shkresën nr. 575, datë 19.02.2018 duke pranuar dhe premtuar se do të zbatohen rekomandimet e KLSH.

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI:

Për shpërblim dëmi janë rekomanduar 17 masa me vlerë 14,333,895 lekë, janë kontabilizuar 8 masa në vlerën prej 3,756,234 lekë duke mos kontabilizuar 9 masa në vlerën 12,92,000 lekë, deri me datë 30.09.2018 janë arkëtuar 447,332leke, ndërsa shuma 13,886,563 lekë nuk është arkëtuar.

Nga verifikimi rezultoi se nga vlera e rekomanduar nga KLSH prej..... **14,333,895** lekë

-Deri më datën 30.09.2018 është arkëtuar dhe zbatuar punimet 447,332 lekë

Kanë mbetur pa u arkëtuar vlera prej..... 13,886,563 lekë

Nga të cilat:

-Në proces arkëtimi 3 rekomandime në vlerën..... 750,529 lekë

-Në proces gjyqësor 2 rekomandime në vlerën.....214,829 lekë

-Janë nisur njoftimet për 9 rekomandime por ende nuk kanë filluar arkëtimet..... 12,921,205 lekë

Në mënyrë të detajuar masat shpërblim dëmi rikërkojmë si më poshtë:

1.1.Gjetje nga auditimi: Në objektin “**Rivitalizim e Sheshit Qëndror e Trotuareve të Aksit Kryesor Qyteti Divjakë**”, Bashkia Divjakë, nga auditimi i dokumentacionit teknik mbi hartimin e projektit të zbatimit dhe preventivit të punimeve të ndërtimit, të administruara në dosjen teknike rezulton se janë preventivuar tepër fond limit, si pasojë e rritjes fiktive të çmimeve të krahasuar me manualin teknik të çmimeve, në kundërshtim me, aktet ligjore e nënligjore që rregullojnë fushën e kontrollit dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit, fushën menaxhimit financiar dhe kontrollit, dhe fushën e prokurimit publik, duke i shkaktuar buxhetit të Bashkisë Divjakë **dëm ekonomik në vlerën në 6,489,647 lekë pa tvsh** (Trajtuar më hollësisht në faqet nr. 206-207të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1.1.Rekomandim: Nga Bashkia Divjakë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **6,489,647 lekë pa tvsh** nga ing. O [] Z [] në cilësinë e hartuesit të projekt preventivit me objekt “*Rivitalizim e Sheshit Qendror e Trotuareve të Aksit Kryesor Qyteti Divjakë*”, Bashkia Divjakë, vlerë kjo e cila përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore si rrjedhojë e rritjes fiktive të fondit limit.

Menjëherë

2.3.Gjetje nga auditimi: Në objektin “*Sistemim, Asfaltim Blloku Veri-Lindor, Lagjia e Stanit*”, Bashkia Divjakë, nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit dhe mbikëqyrjes së punimeve të ndërtimit të administruara në dosjen teknike si dhe nga verifikimi në terren rezultuan diferenca *më tepër në vlerë, në vlerën 756,254 lekë pa tvsh duke shkaktuar dëm ekonomik për punime të pakryera në fakt.* Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën për mbikëqyrjen e punimeve lidhur me Autoritetit Kontraktor Bashkia Divjakë dhe mbikëqyrësit të punimeve ing. V [] A [] (Trajtuar më hollësisht në faqet nr. 206-207të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

2.3.1.Rekomandim: Nga Bashkia Divjakë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **756,254 lekë pa t.v.sh** nga OE “S []” Shpk, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën nr. 998 prot., datë 01.04.2015 me objekt “*Sistemim, Asfaltim Blloku Veri-Lindor, Lagjia e Stanit*”, Bashkia Divjakë, vlerë kjo e cila përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore si rrjedhojë e situacionimit dhe likuidimit të punimeve të pakryera.

Menjëherë

3.4.Gjetje nga auditimi: Në objektin “*Sistemim, Asfaltim Rruga e Stanit*”, Bashkia Divjakë, nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit dhe mbikëqyrjes së punimeve të ndërtimit të administruara në dosjen teknike si dhe nga verifikimi në terren rezultuan diferenca *më tepër në vlerë, në vlerën 660,000 lekë pa tvsh duke shkaktuar dëm ekonomik për punime të pakryera në fakt.* Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me, kontratën për mbikëqyrjen e punimeve lidhur me Autoritetit Kontraktor Bashkia Divjakë dhe mbikëqyrësit të punimeve ing. Dh [] D [] (Trajtuar më hollësisht në faqet nr. 206-207të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.4.1.Rekomandim: Nga Bashkia Divjakë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **660,000 lekë pa tvsh** nga BOE “B [REDAKTUAR]” Shpk dhe “XH [REDAKTUAR] & K [REDAKTUAR]” shpk, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën nr. 1826 prot., datë 10.09.2014 me objekt “Sistemim, Asfaltim Rruga e Stanit”, Bashkia Divjakë, vlerë kjo e cila përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore si rrjedhojë e situacionimit dhe likuidimit të punimeve të pakryera.

Menjëherë

4.5. Gjetje nga auditimi: Në objektin “Sistemim, Asfaltim Rruga Mertish-Tre Urat”, Bashkia Divjakë, nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit dhe mbikëqyrjes së punimeve të ndërtimit të administruara në dosjen teknike si dhe nga verifikimi në terren rezultuan diferenca më tepër në vlerë, në vlerën **584,200 lekë pa tvsh duke shkaktuar dëm ekonomik për punime të pakryera në fakt.** Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën për mbikëqyrjen e punimeve lidhur me Autoritetit Kontraktor Bashkia Divjakë dhe mbikëqyrësit të punimeve ing. Anduen Mbriçe (Trajtuar më hollësisht në faqet nr. 206-207 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.5.1. Rekomandim: Nga Bashkia Divjakë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **584,200 lekë pa tvsh** nga OE “S [REDAKTUAR]” Shpk, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën nr. 633 prot., datë 24.02.2016 me objekt “Sistemim, Asfaltim Rruga Mertish-Tre Urat”, Bashkia Divjakë, vlerë kjo e cila përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore si rrjedhojë e situacionimit dhe likuidimit të punimeve të pakryera.

Menjëherë

5.6. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e strukturës organizative dhe nivelin e pagave sipas funksioneve në Bashkinë Divjakë, u konstatua se janë paguar për vlerën e pagës së grupit për grupet e diplomave të arsimit universitar dhe për shtesën e pagës për vjetërsinë në punë, për punonjësit të Bashkisë, në kundërshtim me VKM nr. 586, datë 17.07.2013 “Për disa ndryshime në vendimin nr. 1619, datë 02.07.2008, të KM "Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të qeverisjes vendore për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të punonjësve të organeve të qeverisjes vendore", lidhja nr.2, dhe VKM nr.165, datë 02.03.2016 “Për grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore” pika 5, 6 dhe lidhja nr.9, me pasojë **dëmin ekonomik në vlerën 279,360 lekë** (Trajtuar më hollësisht në faqet nr. 206-207 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

5.6.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Divjakë, Drejtoria e Financës, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtimin e **vlerës 279,360 lekë**, sipas aneksit nr.1, bashkangjitur.

Menjëherë

6.7. Gjetje nga auditimi: Janë kryer shpenzime për organizime festash me rastin e ditës së verës, festës së mësuesit, festës së abetares, festës së Vitit të Ri dhe shpenzime për koktej, nuk përcaktohen personat përfitues, ku fondi i përdorur për përballimin e këtyre shpenzimeve nuk është nga fondi i veçantë, por është përdorur artikulli nr.602, shpenzime operative, në kundërshtim me Ligjin nr. 160/2014, datë 27.11.2014, “Për buxhetin e vitit 2015”, neni 15, Ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 6, VKM nr. 243, datë 15.05.1995 “Për pritje dhe përcjellje dhe trajtimin që u bëhet delegacioneve të huaja”, i ndryshuar, pasqyrat nr.1-3, me pasojë dëmin ekonomik në **vlerën 82,100 lekë** përkatësisht: nga Bashkia Divjakë 44,000 lekë, si dhe nga ish Komuna Tërbuf 38,100 lekë (Trajtuar më hollësisht në faqet nr. 32-102 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

6.7.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës në Bashkinë Divjakë të përcaktojë personat përfitues për organizime festash (pjesëmarrës në koktej) ose të arkëtohen nga Përgjegjësit e zyrës së Financës dhe të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e

ligjore për arkëtimin e vlerës prej **82,100 lekë**, përkatësisht: nga Bashkia Divjakë znj.F. ■■■■■ M. ■■■■■ vlera 44,000 lekë dhe ish Komuna Tërbuf z.A. ■■■■■ B. ■■■■■ vlera 38,100 lekë.

Menjëherë

7.8. Gjetje nga auditimi: Nga ish Komuna Gradishtë kryer pagesa për shërbim konsulence juridike, bazuar vetëm në listë pagesat dhe listë prezencat e paraqitur nga ish kryetari i Komunës dhe ish përgjegjësi i zyrës së financës, pasi mungojnë dokumentet shoqëruese (nuk ka kontrate të lidhur) si dhe nuk vërtetohet puna që është kryer, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 10296, date 8.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” neni 4/26, neni 9/4, neni 12/3, në shkelje të disiplinës financiare me dëm ekonomik **në vlerën 171,000 lekë** dhe përfitues z.Metush Meçka në funksionin Jurist të ish Komunës Gradisht (*Trajtuar më hollësisht në faqet nr. 32-102 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

7.8.1. Rekomandimi:Drejtoria e Financës në Bashkinë Divjakë të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **171,000 lekë** nga z.M. ■■■■■ M. ■■■■■ ish Komuna Gradisht për pagesa të kryera për konsulenca juridike.

Menjëherë

8.9. Gjetje nga auditimi: Janë kryer pagesa për shpenzime të telefonisë celulare, në kundërshtim me pikat 2-11, të VKM nr. 864, datë 23.04.2010 “Për pajisjen me numër telefoni celular të personave juridik dhe publik”, pasi nuk plotëson asnjë specifikim kusht të përcaktuar të këtij vendimi, në shkelje të disiplinës financiare me pasojë **dëmin ekonomik në vlerën 176,729 lekë**, përkatësisht: z. A. ■■■■■ Rr. ■■■■■ ish Komuna Remas vlera 85,000 lekë dhe z.A. ■■■■■ D. ■■■■■ ish Komuna Tërbuf vlera 91,729 lekë (*Trajtuar më hollësisht në faqet nr. 32-102 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

8.9.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës në Bashkinë Divjakë të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **176,729 lekë**, përkatësisht: ngaish kryetari i Komunës Remas z. A. ■■■■■ Rr. ■■■■■ vlerën 85,000 lekë dhe nga ish Kryetari i Komunës Tërbuf z.A. ■■■■■ D. ■■■■■ vlerën 91,729 lekë, pagesa të kryera për telefonin celular.

Menjëherë

9.10. Gjetje nga auditimi: Janë kryer pagesa për shpenzime udhëtimi e dieta, për punonjësit e ish Komunës Remas, me mangësi në dokumentacion, pa u pajisur me autorizim nga titullari i njësisë vendore, pa u përcaktuar qëllimi i shërbimit dhe kohëzgjatja e tij, në kundërshtim me VKM nr. 997, datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit”, i ndryshuar, paragrafi V, pika 2, germa “b”, me pasojë **dëmin ekonomik në vlerën 408,000 lekë** (*Trajtuar më hollësisht në faqet nr. 32-102 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

9.10.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës në Bashkinë Divjakë të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **408,000 lekë**, për shpenzime udhëtimi e dieta, për punonjësit e ish Komunës Remas, me mangësi në dokumentacion, pa u pajisur me autorizim nga titullari i njësisë vendore, sipas aneksit nr.7, bashkangjitur.

Menjëherë

10.11. Gjetje nga auditimi: Nga ish Komuna Remas nuk është vepruar për të kryer ndalesat për tatimi në burim për pagesat e kryera për shpërbimin e këshilltarëve dhe kryetarëve të fshatrave, të ish komunës Remas, në kundërshtim me kërkesat e kreut II-të, neni 8 “E ardhur e tatueshme” shkronja “g”, neni 33 “Mbajtja në burim e tatimit mbi të ardhurat”, të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar me ligjin nr. 83/2014 datë 17.07.2014 dhe 156/2014 datë 27.11.2014. me pasojë **dëmin ekonomik në vlerën 36,570 lekë** (*Trajtuar më hollësisht në faqet nr. 32-102 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

10.11.1.Rekomandimi: Drejtoria e Financës në Bashkinë Divjakë të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **36,570 lekë**, sipas aneksit nr.8, bashkangjitur.

Menjëherë

11.13. Gjetje nga auditimi: Nga Bashkia Divjakë, Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit procesit të Territorit, gjatë procesit të miratimit të Lejeve të Përdorimit, nuk është vepruar për të krahasuar vlerën e punimeve të preventivit me vlerën e punimeve të situacionit, mbi të cilën është përlogaritur taksa e ndikimit në Infrastrukturë, për Certifikatat e Përdorimit të objekteve, ku ka rezultuar diferenca në vlerë për taksën e ndikimit në infrastrukturë, në shkelje të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar neni 13 dhe UKM nr.3 datë 15.2.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit, ndryshuar kapitulli II, pika3, me pasojë **dëmin ekonomik në vlerën 530,023 lekë**, përkatësisht:

z.D ■ M ■ për vlerën 1,823 lekë, z.S ■ J ■ për vlerën 190,655 lekë, z.A ■ K ■ për vlerën 179,291 lekë dhe z.A ■ L ■ për vlerën 158,254 lekë (Trajtuar më hollësisht në faqet nr. 32-102 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

11.13.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Divjakë, Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **530,023 lekë**, përkatësisht: nga z.D ■ M ■ për vlerën 1,823 lekë, nga z.S ■ J ■ për vlerën 190,655 lekë, nga z.A ■ K ■ për vlerën 179,291 lekë, nga z.A ■ L ■ për vlerën 158,254 lekë.

Menjëherë

12.14. Gjetje nga auditimi: Nga Bashkia Divjakë, janë trashëguar dy kontrata qiraje dhe konkretisht:

Nr	Emeri subjektit	Emeri Objektit	Kontrata nr. date	Qera Trualli	Qera Ndertese	Qira Vjetore
1	E ■ B ■	Pallat Nr.1 (3-kt) Pas.Nr.2/53	2543 rep 710 kol dt. 16.7.2010	16.07.2010	20 Vjet	910368
2	J ■ R ■	Pallat Pas.Nr.568/1	1476 rep 405 kol dt. 14.11.2006	14.11.2006	20 Vjet	233016

Lidhur me kontratën e qytetarit Jovan Rudho, rezultoi se përvec se kontrata nuk i është referuar bazës ligjore në fuqi në kohën e nënshkrimit të saj, nuk është referuar as në çmimin për m² sipas VKM-së dhe konkretisht Sipas VKM nr. 1712, datë 24.12.2008 “Për përcaktimin e kritereve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, ndryshuar me VKM nr. 739, datë 01.07.2009, VKM nr. 54, datë 05.02.2014, VKM nr. 735, datë 05.11.2014, VKM nr. 606, datë 31.08.2016 dhe VKM nr. 693, datë 05.10.2016, ku është përcaktuar se: Për sipërfaqen funksionale, tarifa dysheme e qirasë mujore është 20 për qind e tarifës dysheme të detyrimit mujor, të përcaktuar për ndërtesat. Trualli nën ndërtesë (objekti) përfshihet në tarifën e qirasë së ndërtesës.

Sipas kontratës subjekti ka marrë me qira një sipërfaqe trualli të lirë prej 1300 m² nga i cili 56 m² është objekt “**Furrë pjekje një kat**”, ku vlera e qirasë është përcaktuar në masën 233,016 lekë/vit. Sipas VKM-ve të sipërcituara vlera e qirasë për objektin është 56 m²x100lekë/m²x12 muaj=67,200 lekë.

Po ashtu sipërfaqja e truallit funksional (edhe pse ajo nuk mund të jetë më e madhe se ajo e objektit) në vlerën minimale përlogaritet 1300-56= 1244x20lekë/m²x12 muaj =298,560 lekë shumë të cilës i duhet shtuar edhe vlera e objektit, pra 298,560 lekë+67,200 lekë=365,760 lekë, kur subjekti ka paguar 233,016 lekë ose me pak (233,016-365,760=132,744 lekë/vit). Në total vlera e detyrimit të pa përlogaritur dhe për rrjedhojë edhe të pa paguar shkon në shumën 132,744x11 vjet=**1,460,184 lekë, dëm ekonomik për buxhetin e Bashkisë Divjakë**(Trajtuar më hollësisht në faqet nr. 276-286 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

12.14.1. Rekomandimi: Bashkia Divjakë të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **1,460,184 lekë**, nga subjekti **J** **Rr**, si dhe të bëj përditësimin e kontratës me subjektin, sipas referencës ligjore aktuale.

Menjëherë

13.15. Gjetje nga auditimi: Nga Bashkia Divjakë, ka lidhur 51 kontrata për zënie të përkohshëm të hapësirave publike (plazhe), nga të cilat 6 kontrata për vitin 2015, për vlerën prej 140080 lekë, 25 kontrata për vitin 2016 për vlerën prej 3,848,000 lekë dhe 20 kontrata për vitin 2017 dhe vlerë prej 2,746,000 lekë. Nga këto kontrata, për shkak të mosndjekjes korrektësisht të tyre nga 7 subjekte të cilët nuk kanë shlyer detyrimet kontraktore është krijuar një dëm ekonomik në shumën prej **560,000 lekë**, **procedura në kundërshtim me VKM nr. 369**, datë 18.05.2016 “Për miratimin e rregullores për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit” dhe kontratave tip respektive, sipas tabelës bashkëlidhur (*Trajtuar më hollësisht në faqet nr. 276-286 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

13.15.1. Rekomandimi: Bashkia Divjakë të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për 51 kontrata për zënie të përkohshëm të hapësirave publike (plazhe), dhe arkëtimin nga subjektet debitore të vlerës **560,000 lekë**.

Menjëherë

11.PREFEKTURA DURRËS:

- Nga verifikimi rezulton se KLSH ka dërguar në Prefekturën Durrës rekomandimet e auditimit me shkresën e saj nr. 777/10 datë 15.12. 2017, ndërsa nga Prefektura Durrës për zbatim e rekomandimeve të KLSH është kthyer përgjigje me shkresën e saj nr.842/29 datë 04.01.2018, protokolluar në KLSH me shkresën nr.777/11 datë 08.01.2018. Pra përgjigja e Prefekturës për zbatimin e rekomandimeve të KLSH është bërë brenda afatit ligjor të kthimit të përgjigjes. Për zbatimin e rekomandimeve të KLSH nga Prefektura Durrës është hartuar Plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve dhe janë ngarkuar personat për zbatimin e rekomandimeve me afate konkrete.

- Nga verifikimi rezulton se përfundimet e auditimit i janë dërguar subjektit të audituar Prefekturës Durrës, me shkresën e Kryetarit të KLSH nr. 777/10 datë 15.12. 2017 dhe duhet të raportonte në KLSH brenda 6 muajve ose brenda datës 15.06.2018 Ndërkohë nga Prefektura Durrës nuk është raportuar brenda afatit .

A. MASA ORGANIZATIVE:

Nga KLSH janë rekomanduar Prefekturës Durrës 21, masa organizative, janë zbatuar plotësisht 15 masa, është në proces zbatimi 1 masë dhe nuk janë zbatuar 5 masa organizative për të cilat rikërkujmë zbatimin e masave si vijon:

1.1-Gjetje nga auditimi: Në tre raste në vitin 2013, për të cilat nga Komisioni Vendor i Vlerësimit të Titujve të Pronësisë është marrë vendim për rikonfirmim të vlefshmërisë ligjore të aktit të marrjes së tokës në pronësi (AMTP) u konstatua se, në dosjet përkatëse të këtyre vendimeve ka mungesë të dokumenteve të rëndësishme, si certifikata e gjendjes familjare më datën 01.08.1991, vërtetimi nëse qytetari ka qenë më datën 01.08.1991 anëtar i ish kooperativës bujqësore, vërtetim nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore etj., të cilat në shkresën e vendimit cilësohen se janë marrë në analizë nga Komisioni Vendor i Vlerësimit të Titujve të Pronësisë, por në fakt nuk janë pjesë e dosjes. Gjithashtu në shqyrtimin e këtyre vendimeve Komisioni nuk ka marrë në analizë të gjitha AMTP që disponon qytetari. Këto mangësi nuk japin siguri se këto vendimet janë të drejta e në përputhje me kërkesat ligjore. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me seksionin I, pika 2, të udhëzimit të KM nr.2, datë 13.1.2010 “Për mënyrën e verifikimit apo të shqyrtimit të vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore, nga KV, kur këtë e kërkojnë individë a institucione”. Konkretisht vendimet: nr.270 datë

21.03.2013 “Për rikonfirmimin e vlefshmërisë ligjore të AMTP nr. 240/1, datë 20.07.2003”, në emër të qytetarit R ■■■ H ■■■; vendimi nr.271, datë 21.03.2013 “Për rikonfirmimin e vlefshmërisë ligjore të AMTP nr.101/1 datë 25.10.2003”, në emër të qytetarit H ■■■ Zh ■■■ vendimi nr.273, datë 21.03.2013, “Shfuqizim i pjesshëm i AMTP nr. 64/1, datë 10.02.2002, të familjes bujqësore të përfaqësuar nga qytetari M ■■■ C ■■■” (*Më hollësisht trajtuar në pikën 7/1-Auditim mbi funksionimin e KVVTP për periudhën 2013-2014, faqe 41-64 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

1.1.1-Rekomandim: Komisioni Vendor i Vlerësimit të Titujve të Pronësisë, pasi të sigurojë të gjithë dokumentacionin e nevojshëm ligjor, të rishqyrtoj 3 vendimet e KVVTP respektivisht: nr.270 datë 21.03.2013, nr.271, datë 21.03.2013 dhe nr. 273, datë 21.03.2013.

Menjëherë

2.3-Gjetje nga auditimi: Komisioni Vendor i Vlerësimit të Titujve të Pronësisë, për shqyrtimin e ankesëdatë 20.01.2017 të qytetares M ■■■ J ■■■, e cila ka konflikt pronësie me z.Z ■■■ V ■■■ P ■■■, nuk ka kryer hetim të plotë administrativ, duke mos kërkuar nga institucionet përkatëse (ZRPP etj), dokumentacionin e duhur për znj. M ■■■ J ■■■, por vetëm për z. Z ■■■ P ■■■, veprime me dy standarde. Në këtë mënyrë hetimi administrativ është kryer vetëm për njërin nga dy qytetarët në konflikt pronësie dhe si rezultat, gjykimi përfundimtar i Komisionit Vendor për pamundësinë e shqyrtimit të vlefshmërisë ligjore të 2 akteve të marrjes së tokës në pronësi, në emër të z. Z ■■■ P ■■■ (për të cilin M ■■■ J ■■■ pretendon se nëpërmjet tyre i ka marrë padrejtësisht tokën bujqësore), nuk jep siguri se është i drejtë e në përputhje me kuadrin ligjor. Këto veprime janë në kundërshtim me nenin 8 të ligjit nr.9948, datë 7.7.2008, “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, udhëzimin nr.2, datë 13.1.2010 “Për mënyrën e verifikimit apo të shqyrtimit të vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore, nga komisionet vendore të verifikimit të titujve të pronësisë, kur këtë e kërkojnë individë a institucione” (*Më hollësisht trajtuar në pikën 7/2-Auditim mbi funksionimin e KVVTP për periudhën 2015-2017, faqe 64-86 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

2.3.1-Rekomandim: Komisioni Vendor i Vlerësimit të Titujve të Pronësisë, të kryej hetim të plotë administrativ në përgjigje të ankesës së qytetares M ■■■ J ■■■ duke marrë në shqyrtim dokumentacionin e plotë të të dy palëve në konflikt për tokën bujqësore.

Menjëherë

3.4-Gjetje nga auditimi: Komisioni vendor i vlerësimit të titujve të pronësisë, për shqyrtimin e ankesës së qytetarit A ■■■ S ■■■, datë 11.6.2014, Manëz Durrës, për verifikimin e AMTP nr. 245, 245/1 dhe 245/2, nuk ka kryer hetim të plotë administrativ, pasi nuk ka marrë në shqyrtim të gjithë dokumentacionin e nevojshëm, duke mos kërkuar nga ISSH, ZRPP, SAMT Qarkut Durrës, dokumentet përkatëse ligjore. Në këto kushte vendimi nr.21, datë 05.11.2015, i Komisionit “Për pamundësinë e përfundimit të hetimit administrativ”, nuk jep siguri se është vendim i drejtë, nuk ka zgjidhur konfliktin brenda familjes S ■■■ dhe është marrë në kundërshtim me udhëzimin nr.2, datë 13.1.2010 “Për mënyrën e verifikimit apo të shqyrtimit të vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore, nga komisionet vendore të verifikimit të titujve të pronësisë, kur këtë e kërkojnë individë a institucione” (*Më hollësisht trajtuar në pikën 7/2-Auditim mbi funksionimin e KVVTP për periudhën 2015-2017, faqe 64-86 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

3.4.1-Rekomandim: Komisioni Vendor i Vlerësimit të Titujve të Pronësisë, pasi të ketë siguruar të gjithë dokumentacionin e nevojshëm ligjor, të rishqyrtoj kërkesën e z. A ■■■ S ■■■ dhe vendimin e KVVTP nr. 21, datë 05.11.2015.

Menjëherë

4.5-Gjetje nga auditimi: Komisioni Vendor i Vlerësimit të Titujve të Pronësisë në shqyrtimin e ankesës nr.1238, datë 18.05.2015 të vëllezërve Shehu, me objekt “Kërkesë për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të AMTP nr. 280, datë 10.7.2006, në emër të z. B ■■■ B ■■■”, nuk ka bërë hetim të plotë administrativ, duke mos marrë në konsideratë të gjitha faktet.

Komisioni ka marrë vendimin nr. 22, datë 5.11.2015, për “Pamundësinë e marrjes në shqyrtim të AMTP nr. 280, datë 10.7.2006, por pas daljes së fakteve të reja nga Drejtoria e Policisë Durrës me shkresën nr.99, datë 06.01.2016, se AMTP e mësipërme disponohet në ZVRPP Durrës në origjinal, Komisioni nuk ka marrë në rishqyrtim vendimin e tij nr. 22, datë 5.11.2015, duke mos zgjidhur konfliktin midis familjeve të vëllezërve Sh[] dhe z. B[] B[]. Këto veprime janë në kundërshtim me nenin 8 të ligjit nr.9948, datë 7.7.2008, “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, udhëzimin nr.2, datë 13.01.2010“Për mënyrën e verifikimit apo të shqyrtimit të vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore, nga komisionet vendore të verifikimit të titujve të pronësisë, kur këtë e kërkojnë individë a institucione” (Më hollësisht trajtuar në pikën 7/2-Auditim mbi funksionimin e KVVTP për periudhën 2015-2017, faqe 64-86 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.5.1-Rekomandim:Komisioni Vendor i Vlerësimit të Titujve të Pronësisë, të rishqyrtoj vendimin nr. 22, datë 5.11.2015 dhe të vlerësoj vlefshmërinë ligjore të AMTP nr. 280, datë 10.7.2006. Për këtë të bëjë hetim të ri administrativ lidhur me kërkesën nr.1238, datë 18.05.2015 të vëllezërve Sh[], duke rikërkuar nga institucionet shtetërore dhe ankimuesi të gjithë dokumentacionin e nevojshëm.

Menjëherë

5.6-Gjetje nga auditimi: Në një rast, në marrjen e vendimit nr.30, datë 30.12.2016, për rikonfirmim të vlefshmërinë ligjore të AMTP nr.58, datë 23.07.1992, me sipërfaqe toke 15,000 m2, në emër të z.Sh[] F[], Komisioni Vendor i Vlerësimit të Titujve të Pronësisë, ka marrë vendim duke mos u mbështetur në dokumente origjinale, pasi AMTP-ja e mësipërme është fotokopje e pa noterizuar dhe me korrigjim tek parcela 190/36 me sipërfaqe 2,700 m2, pasi është pasqyruar në një kohë të dytë (në vitin 1994) dhe nuk ekziston në dokumentacionin e DAMT Durrës. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me udhëzimin e KM nr.2, datë 13.01.2010“Për mënyrën e verifikimit apo të shqyrtimit të vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore, nga komisionet vendore të verifikimit të titujve të pronësisë, kur këtë e kërkojnë individë a institucione” (Më hollësisht trajtuar në pikën 7/2-Auditim mbi funksionimin e KVVTP për periudhën 2015-2017, faqe 64-86 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

5.6.1-Rekomandimi:Komisioni Vendor i Vlerësimit të Titujve të Pronësisë, pasi të ketë siguruar të gjithë dokumentacionin e nevojshëm ligjor, të rishqyrtoj vendimin e datës 30.12.2016, për vlefshmërinë ligjore të AMTP nr.58 datë 23.07.1992.

Menjëherë

12.PREFEKTURA ELBASAN:

-Nga verifikimi rezulton se KLSH ka dërguar në Prefekturën Elbasan rekomandimet e auditimit me shkresën e saj nr. nr.880/7, datë 26.12.2017) protokolluar në Prefekturën me shkresën nr. 1299/36, datë 27.12.2017,ndërsa nga Prefektura Elbasan për zbatim e rekomandimeve të KLSH është kthyer përgjigje me shkresën e saj nr.1299/39 datë 15.01.2018 protokolluar në KLSH me shkresën nr. 880/8 datë17.01.2018. Pra përgjigja e Prefekturës për zbatimin e rekomandimeve të KLSH është bërë brenda afatit ligjor të kthimit të përgjigjes. Për zbatimin e rekomandimeve të KLSH nga Prefektura Elbasan është hartuar Plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve janë ngarkuar personat për zbatimin e rekomandimeve me afate konkrete.

- Nga verifikimi rezulton se përfundimet e auditimit i janë dërguar subjektit të audituar Prefekturës Elbasan rekomandimet e auditimit me shkresën e saj nr. nr.880/8 prot, datë 26.12.2017) dhe duhet të raportonte në KLSH brenda 6 muajve ose brenda datës 05.07.2018. Prefektura Elbasan ka raportuar në KLSH me shkresën nr.1299/40 dt 05.07.2018, pra brenda afatit ligjor të përcaktuar prej 6 muajsh.

A. MASA ORGANIZATIVE:

Nga KLSH janë rekomanduar Prefekturës Elbasan 27 masa organizative, janë zbatuar plotësisht 10 masa, është në proces zbatimi 15 masa dhe nuk janë zbatuar 2 masa organizative për të cilat rikërkojmë zbatimin e masave si vijon:

1.6. Gjetje nga auditimi: KVVTP Prefekti Qarkut Elbasan në Vendimin nr. 207, datë 24.5.2016, ka kërkuar shfuqizim të sipërfaqes *tepër prej 529 m²*, për shkak të sipërfaqes mbi normë për frymë, lidhur me AMTP nr. 93, datë 20.01.92 në emër të S [REDAKTUAR] S [REDAKTUAR] L [REDAKTUAR]. Ky vendim është dërguar në Gjykatën Administrative Durrës me datë 30.05.2016, e cila ka përfunduar gjykimin dhe është në proces të zbardhjes së vendimit. Zbritja prej 529 m² nuk është e saktë pasi KVVTP duhej të zbriste 1807 m², pra zbritur më pak 1278 m²; kjo për shkak të mos konfirmimit të saktë nga ZVRPP Elbasan, veprim në kundërshtim me UKM nr. 2, datë 13.01.2010 “Për Mënyrën e Verifikimit apo Shqyrtimit të Vlefshmërisë Ligjore të Krijimit të Titujve të Pronësisë mbi Tokën Bujqësore nga Komisionet Vendore të Verifikimit të Titujve të Pronësisë, kur këtë e Kërkojnë Individë apo Institucione”, i ndryshuar, pika 2 “c” (*Më hollësisht trajtuar në pikën 7.5 A.2, faqe 91 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

1.6.1. Rekomandim: KVVTP Prefekti Qarkut të marrë masa të rishqyrtojë Vendimin nr. 207, datë 24.5.2016, i ndodhur në proces gjyqësor, ku të përfshijë në zbritje për pavlefshmëri edhe sipërfaqen tepër prej-1278 m² sipërfaqe zbritur me pak me Vendimin nr. 207, datë 24.5.2016 si dhe e ndodhur ne pasurit nr. 115/1, volum 2, faqe 99, ZK. 1732 fshatin Gjergjan në pasurinë nr. 86/66, volum 2, faqe 69 ZK. 1732 fshatin Gjergjan, nr. 54/56, volum 3, faqe 82 ZK.1732 fshatin Gjergjan dhe ne nr. 15/3, volum 2, faqe 158 ZK. 1732 fshatin Gjergjan.

Menjëherë

2.7. Gjetje nga auditimi: KVVTP Prefekti i Qarkut Elbasan në Vendimin nr. 215, datë 30.12.2016 dërguar në Gjykatën Administrative Durrës me datë 30.12.16, sipas të cilit ka kërkuar shfuqizimi në sipërfaqen tepër prej 1392 m² lidhur me AMTP nr. 40, datë 25.02.1992 në emër të Q [REDAKTUAR] Q [REDAKTUAR] fshati Rrenas, NJA Grekan Bashkia Belsh. Zbritja prej 1392 m² nuk është e saktë pasi duhej të zbriste edhe 1428 m², kjo për shkak të përdorimit të normës së pasaktë për frymë si dhe për shkak të mos konfirmimit të saktë nga ZVRPP Elbasan në kundërshtim me UKM nr. 2, datë 13.01.2010 “Për Mënyrën e Verifikimit apo Shqyrtimit të Vlefshmërisë Ligjore të Krijimit të Titujve të Pronësisë mbi Tokën Bujqësore nga Komisionet Vendore të Verifikimit të Titujve të Pronësisë, kur këtë e Kërkojnë Individë apo Institucione”, i ndryshuar, pika 2 “c” (*Më hollësisht trajtuar në pikën 7.5 A.2, faqe 92 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

2.7.1. Rekomandim: KVVTP Prefekti Qarkut Elbasan të marrë masa të rishqyrtojë Vendimin nr. 215, datë 30.12.2016, duke u bazuar në Printim III, normën për frymë, duke zbritur dhe truallin 250 m², sipërfaqja tepër prej 1428 m² rezulton e llogaritur 19088 m² PIII- 16268 m² sipas normës = 2820 m² sipërfaqja tepër – 1392 m² zbritja e KVVTP = 1428 m² sipërfaqe zbritur me pak, ndodhur në pasurinë nr. 114/4, volum 1, faqe 232, ZK. 3223 Grekan dhe në pasurinë nr. 66/1, volum 1, faqe 229, ZK. 3223 Grekan.

Menjëherë

13. PREFEKTURA VLORË:

-Nga verifikimi rezulton se KLSH ka dërguar në Prefekturën e Qarkut Vlorë rekomandimet e auditimit me shkresën e saj nr.1028/5 datë 20.12. 2017, protokolluar në Prefekturën e Qarkut Vlorë me shkresën nr. 2621 datë 21.12.2017, ndërsa nga Prefektura e Qarkut Vlorë për zbatim e rekomandimeve të KLSH është kthyer përgjigje me shkresën e saj nr.9275/5, datë 12.01.2018, protokolluar në KLSH me shkresën nr. 1027/7 datë 15.01.2018. Pra përgjigja e Prefekturës për zbatimin e rekomandimeve të KLSH është bërë brenda afatit ligjor të kthimit të përgjigjes. Për zbatimin e rekomandimeve të KLSH nga Prefektura e Qarkut Vlorë është hartuar Plan veprimi dhe janë ngarkuar personat për zbatimin e rekomandimeve me afate konkrete.

- Nga verifikimi rezulton se përfundimet e auditimit i janë dërguar subjektit të audituar Prefekturën e Qarkut Vlorë, me shkresën e Kryetarit të KLSH nr. 1028/5 datë 20.12. 2017_dhe duhet të raportonte në KLSH brenda 6 muajve ose brenda datës 20.06.2018, ndërkohë nga Prefektura e Qarkut Vlorë nuk është raportuar brenda afatit.

A. MASA ORGANIZATIVE:

Nga KLSH janë rekomanduar Prefekturës Vlorë 20, masa organizative, janë zbatuar plotësisht 8 masa, janë në proces zbatimi 7 masa dhe nuk janë zbatuar 5 masa organizative për të cilat rikërkojmë zbatimin e masave si vijon:

1.8 - Gjetje nga auditimi: Komisioni Vendor i Vlerësimit të Titujve të Pronësisë për 13 vendime me sipërfaqe 51152 m², të cilët kanë marrë formë të prerë nga gjykata, si dhe për 6 vendime me sipërfaqe 42530 m², të cilët nuk kanë marrë forme të prerë nga gjykata, nuk ka bërë kallëzim penal në organet e drejtësisë, ndaj anëtarëve të komisioneve të ndarjes së tokës të fshatrave, pasi kanë tejkalluar kompetencat ligjore, të cilët kanë sjellë, për pasojë, me efekt dhe dëmtimin e rëndë të interesave të shtetit, duke ndarë tokë bujqësore mbi normën për frymë apo duke mos qenë punonjës të ish-NB-së me datë 01.10.1992, veprim në papajtueshmëri me nenin 15, të ligjit nr. 9948, datë 07.07.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, i ndryshuar (*Trajtuar hollësisht në faqet 34-53, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

1.8.1 - Rekomandim: Komisioni Vendor i Vlerësimit të Titujve të Pronësisë të marrë masa, të bëjë kallëzim penal në organet e drejtësisë, ndaj anëtarëve të komisionit të ndarjes së tokës në fshat, të cilët pasi kanë tejkalluar kompetencat ligjore, kanë sjelle, dëmtimin e rëndë të interesave të shtetit, duke ndarë tokë bujqësore mbi normën për frymë.

Menjëherë

2.16 - Gjetje nga auditimi: Komisioni Vendor i Vlerësimit të Titujve të Pronësisë pranë Prefektit të Qarkut Vlorë, ka hartuar vendimin nr. 2, datë 22.05.2015, dheka vendosur “Revokimin” e vendimit nr. 17, datë 05.03.2013 mbi “Pavlefshmërinë e pjeshme të AMTP nr. 20735, pa datë, me sipërfaqe 45000 m², në emër të familjes M■■■■ F■■■■, KV pranë Prefekti të Qarkut Vlorë nuk ka iniciuar një hetim administrativ në themel nuk ka analizuar faktin se kjo familje ka përfituar më shumë tokë se norma për frymë me sipërfaqe 5850 m², veprim në papajtueshmëri me pikën 3, neni 8 dhe pikën 1 neni 9, të ligjit nr. 9948, datë 07.07.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, i ndryshuar (*Trajtuar hollësisht në faqet 57-57, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

2.16.1 - Rekomandim: Komisioni Vendor i Vlerësimit të Titujve të Pronësisë pranë Prefektit të Qarkut Vlorë, të marrë masa, të rishqyrtoj vendimin nr. 2, datë 22.05.2015, për “Revokimin” e vendimit nr. 17, datë 05.03.2013 mbi “Pavlefshmërinë e pjeshme të AMTP nr. 20735, pa datë, me sipërfaqe 45000 m², në emër të familjes M■■■■ F■■■■, pasi komisioni i ndarjes së tokës në fshat ka tejkalluar kompetencat ligjore duke ndarë tokë më shumë se norma për frymë me sipërfaqe 5850 m².

Menjëherë

3.17 - Gjetje nga auditimi: Komisioni Vendor i Vlerësimit të Titujve të Pronësisë pranë Prefektit të Qarkut Vlorë, ka hartuar vendimin nr. 3, datë 22.05.2015, dheka vendosur Revokimin e vendimit nr. 12, datë 08.12.2012 mbi “Rikonfirmimin e AMTP nr. 20975, pa datë, me sipërfaqe 3100 m², në emër të familjes I■■■■ T■■■■, KV pranë Prefekti të Qarkut Vlorë nuk ka iniciuar një hetim administrativ në themel nuk ka analizuar faktin se kjo familje ka përfituar tokë në ngastrën nr. 203, ZK “Pyll”, veprim në papajtueshmëri me pikën 3, neni 8 dhe pikën 1 neni 9, të ligjit nr. 9948, datë 07.07.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, i ndryshuar (*Trajtuar hollësisht në faqet 58-58, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

3.17.1 - Rekomandim: Komisioni Vendor i Vlerësimit të Titujve të Pronësisë pranë Prefektit të Qarkut Vlorë, të marrë masa, të rishqyrtoj vendimin nr. 3, datë 22.05.2015, për “Revokimin” e vendimit nr. 12, datë 08.12.2012 mbi “Rikonfirmimin e AMTP nr. 20975, pa datë, me sipërfaqe 3100 m², në emër të familjes të I■■■■ T■■■■ pasi komisioni i ndarjes së tokës në fshat ka tejkalluar kompetencat ligjore duke ndarë tokë në ngastrën nr. 203, ZK “Pyll” me sipërfaqe 3100 m².

Menjëherë

4.18 - Gjetje nga auditimi: Komisioni Vendor i Vlerësimit të Titujve të Pronësisë pranë Prefektit të Qarkut Vlorë, ka hartuar vendimin **nr. 7, datë 22.05.2015** dheka vendosur Revokimin e vendimit nr. 7, datë 08.10.2012 mbi “Rikonfirmimin e AMTP nr. 20830, pa datë, me sipërfaqe 10000 m², në emër të familjes L■■■■ V■■■■, KV pranë Prefekti të Qarkut Vlorë nuk ka iniciuar një hetim administrativ në themel nuk ka analizuar faktin se kjo familje **ka përfituar më shumë tokë me sipërfaqe 2750 m²**, veprim në papajtueshmëri me pikën 3, neni 8 dhe pikën 1 neni 9, të ligjit nr. 9948, datë 07.07.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, i ndryshuar (*Trajtuar hollësisht në faqet 59-60, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

4.18.1 - Rekomandim: Komisioni Vendor i Vlerësimit të Titujve të Pronësisë pranë Prefekti të Qarkut Vlorë, të marrë masa, të rishqyrtoj vendimin **nr. 7, datë 22.05.2015**, për“Revokimin” e vendimit nr. 7, datë 08.10.2012 mbi “Rikonfirmimin e AMTP nr. 20830, pa datë, me sipërfaqe 10000 m², në emër të familjes L■■■■ V■■■■ pasi komisioni i ndarjes së tokës në fshat ka tejkualuar kompetencat ligjore duke dhënë **më shumë tokë me sipërfaqe 2750 m²**.”

Menjëherë

5.19 - Gjetje nga auditimi: Komisioni Vendor i Vlerësimit të Titujve të Pronësisë pranë Prefektit të Qarkut Vlorë, në **2 raste** ka marrë vendimin **nr. 4, datë 22.05.2015** dhevendimin **nr. 8, datë 22.05.2015**, ka vendosur “Revokimin” e vendimit nr. 13, datë 05.03.2013 mbi “Rikonfirmimin e AMTP nr. 21628, datë 07.09.1998, me sipërfaqe 4500 m², në emër të familjes të R■■■■ I■■■■ dhe vendimit nr. 3, datë 08.10.2012 mbi “Rikonfirmimin e AMTP nr. 20874, datë 18.06.1996, me sipërfaqe 5000 m², në emër të familjes L■■■■ Xh■■■■, në të 2 rastet, KV nuk ka iniciuar një hetim administrativ në themel për të analizuar dhe shqyrtuar të gjithë elementët e vlefshmërisë dhe ligjshmërisë së aktit të marrjes së tokës në pronësi, në përfundim ka dal me një vendim abstrakt dhe në tejkalimi të kompetencave ligjore të dhëna nga ligji nr. 9948, datë 07.07.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, i ndryshuar dhe VKM nr. 1269, datë 17.09.2008 “Për përbërjen, mënyrën e funksionimit dhe detyrat e përgjegjësitë e strukturave shtetërore, të ngarkuara për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, i ndryshuar. Vendimi “Revokim”, është në kapërcim të tagrit të KV pasi ligji nuk i njuh të drejtën e Revokimit pa marr një vendimmarrje sa përcaktuar në nenin 9 e në vijim të ligji nr. 9948, datë 07.07.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, i ndryshuar (*Trajtuar hollësisht në faqet 58-59, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

5.19.1 - Rekomandim: Komisioni Vendor i Vlerësimit të Titujve të Pronësisë pranë Prefektit të Qarkut Vlorë, të marrë masat për rishqyrtim të vendimit **nr. 4, datë 22.05.2015**, për “Revokimin” e vendimit nr. 13, datë 05.03.2013 mbi “Rikonfirmimin e AMTP nr. 21628, datë 07.09.1998, me sipërfaqe 4500 m², në emër të familjes Refat Isufidhevendimit **nr. 8, datë 22.05.2015**, për “Revokimin” vendimit nr. 3, datë 08.10.2012 mbi “Rikonfirmimin e AMTP nr. 20874, datë 18.06.1996, me sipërfaqe 5000 m², në emër të familjes L■■■■ Xh■■■■, duke marr një vendim në përmbushje të detyrës funksionale në zbatim të tagrit ligjor të përcaktuar nga neni 9 e në vijim të ligji nr. 9948, datë 07.07.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, i ndryshuar.

Menjëherë

B. MASAT DISIPLINORE:

B/I. Për punonjësit që marrëdhëniet e punës rregullohen me Kodin e Punës:

Në mbështetje të shkronjës (c) neni 15 -*Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së* të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, nenin 37 të ligjit nr. 7691, datë 12.7.1995 “*Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë*” i ndryshuar dhe kontratës individuale të punës, neni 11, **KLSH i rikërkon Prefektit të Qarkut Vlorë**, fillimin e procedurave për dhënien e masës disiplinore, nga “*Vërejtje*” deri në “*Zgjidhje të kontratës së punës*”, për **4 punonjës**, si më poshtë:

- 1- S L , me detyrë anëtare e Komisionit Vendor.
- 2- P Ç (G), me detyrë anëtare e Komisionit Vendor.
- 3- O Z , me detyrë anëtar i Komisionit Vendor.
- 4- E T , me detyrë anëtare e Komisionit Vendor.

Menjëherë

Në 6 Subjekte respektivisht: Bashkia Delvinë, Vlorë (auditimi financiar), Roskovec, Krujë ish-komunat, Agjencia Parqeve dhe Rekreacioneve dhe Drejtoria Nr.1, e Punëtorëve të Qytetit Tirënë, janë zbatuar rekomandimet e KLSH në masën 100%, për të cilat duhet tu dërgojmë vetëm Raportet Përfundimtare të Auditimit, së bashku me shkresën shoqëruese si më poshtë:

14.1. BASHKIA VLORË Auditimi Financiar:

Në përfundim të procesit të auditimit, vlerësojmë punën e bërë nga Bashkia Vlorë për zbatimin e rekomandimeve të KLSH paraqitur me shkresën 1027/16 datë 22.12.2017.

15.2. BASHKIA ROSKOVEC:

Nga verifikimi rezulton se KLSH ka dërguar në Bashkinë Roskovec rekomandimet e auditimit me shkresën e saj nr.257/25 datë 03.11. 2017, protokolluar në Bashkinë Roskovec me shkresën nr.3816, datë 06.11.2017, ndërsa nga Bashkia Roskovec për zbatim e rekomandimeve të KLSH është kthyer përgjigje me shkresën e saj nr.3816/1 datë 15.12.2017, protokolluar në KLSH me shkresën nr. 257/27, datë 26.12.2017. Pra përgjigja e Bashkisë për zbatimin e rekomandimeve të KLSH është bërë brenda afatit ligjor të kthimit të përgjigjes. Për zbatimin e rekomandimeve të KLSH nga Bashkia Roskovec është hartuar Plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve dhe janë ngarkuar personat për zbatimin e rekomandimeve me afate konkrete.

- Nga verifikimi rezulton se përfundimet e auditimit i janë dërguar subjektit të audituar Bashkisë Roskovec, me shkresën e Kryetarit të KLSH nr. 257/25 datë 03.11.2017 dhe duhet të raportonte në KLSH brenda 6 muajve ose brenda datës 03.05.2018. Ndërkohë nga Bashkia Roskovec nuk është raportuar brenda afatit .

16.3. BASHKIA DELVINË:

-Nga verifikimi rezulton se KLSH ka dërguar në **Bashkinë Delvinë** rekomandimet e auditimit me shkresën e saj nr 1034/6 datë 29.12. 2017, protokolluar në Bashkinë Delvinë me shkresën nr. 7 datë 05.01.2018, ndërsa nga Bashkia Delvinë për zbatim e rekomandimeve të KLSH nuk është kthyer përgjigje.

- Nga verifikimi rezulton se përfundimet e auditimit i janë dërguar subjektit të audituar Bashkisë Delvinë, me shkresën e Kryetarit të KLSH nr. 1034/6 datë 29.12. 2017 dhe duhet të raportonte në KLSH brenda 6 muajve ose brenda datës 29.03.2018. Ndërkohë nga Bashkia Delvinë nuk është raportuar brenda afatit .

Në përfundim të procesit të auditimit, KLSH vlerëson punën e bërë nga Bashkia Delvinë për zbatimin e rekomandimeve të KLSH të paraqitura me shkresën nr.1034/6, datë 29.12.2017, konstatohet se janë zbatuar të gjitha masat e rekomanduara .

17. 4. BASHKIA KRUIJË ish komunat:

Në përfundim të procesit të auditimit, duke vlerësuar punën e bërë nga Bashkia Krujë për zbatimin e rekomandimeve të KLSH paraqitur me shkresën e saj nr. 3552 Prot datë 23.06.2018, konstatohet se pjesa më me peshë e tyre është zbatuar dhe për masat të cilat rezultojnë në proces zbatimi, për të cilat kërkojmë vijimin e punës në përfundimin e procesit të nisur për zbatimin përfundimtar të tyre.

18. 5.AGJENSIA E PARQEVE DHE REKREACIONIT:

Në përfundim të procesit të auditimit, vlerësohet puna e bërë nga Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit Tiranë, për zbatimin e rekomandimeve të KLSH paraqitur me shkresën nr. 879/6 Prot., datë 23.12.2017, konstatohet se të gjitha rekomandimet e KLSH kanë gjetur zbatim të plotë.

19.6. DREJTORIA E PËRGJITHSHME NR. 1, TË PUNËTORËVE TË QYTETIT TIRANË:

Në përfundim të procesit të auditimit, duke vlerësuar punën e bërë nga Drejtoria e Përgjithshme Nr. 1, e Punëtorëve të Qytetit Tiranë, për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, paraqitur me shkresën 878/8 Prot datë 20.12.2018, konstatohet se janë pranuar të gjitha rekomandimet e KLSH, janë vlerësuar maksimalisht ato duke hartuar plan veprimi dhe ngarkuar persona përgjegjës. Kështu janë zbatuar plotësisht masat për shpërbllim dëmi duke i arkëtuar në vlerën **194,102 lekë** ose në masën 100%, po kështu edhe 9 masat disiplinore janë zbatuar plotësisht sipas rekomandimeve të KLSH.

20.BASHKIA FIER:

-Nga verifikimi rezulton se KLSH ka dërguar në Bashkinë Fier rekomandimet e auditimit me shkresën e saj nr. 245/6 datë 30.06.2018 protokolluar në Bashkinë Fier, ndërsa nga Bashkia Fier për zbatim e rekomandimeve të KLSH është kthyer përgjigje me shkresën e saj nr.2101/28, datë 20.07.2018 protokolluar në KLSH me shkresën nr. 245/9 datë 27.07.2018. Pra përgjigja e Bashkisë për zbatimin e rekomandimeve të KLSH është bërë brenda afatit ligjor të kthimit të përgjigjes. Për zbatimin e rekomandimeve të KLSH nga Bashkia Fier është hartuar Plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve dhe janë ngarkuar personat për zbatimin e rekomandimeve me afate konkrete.

- Nga verifikimi rezulton se përfundimet e auditimit i janë dërguar subjektit të audituar Bashkisë Fier, me shkresën e Kryetarit të KLSH nr. 245/6, datë 30.06.2018 dhe duhet të raportoj në KLSH brenda 6 muajve ose brenda datës 30.12.2018.

A. MASA ORGANIZATIVE:

Nga KLSH janë rekomanduar Bashkisë Fier 7, masa organizative, janë zbatuar plotësisht 2 masa, janë në proces zbatimi 4 masa dhe nuk është zbatuar 1 masë organizative për të cilën rikërkojmë zbatimin e masave si vijon:

1.6. Gjetje nga auditimi:Për vitin 2017 në fillim të vitit me miratimin e Buxhetit të Bashkisë janë alokuar fonde në masën 10,000,000 lekë të cilat me ndryshimet e mëvonshme të buxhetit janë shtuar edhe me 12,000,000 lekë. Gjithsej për vitin 2017 janë akorduar fonde Klubit Futboll Apollonia shuma prej 22,000,000 lekë në artikullin 602 (*Trajtuar më hollësisht në faqet 10 të Projekt Raportit të Auditimit*).

1.6.1 Rekomandim: Bashkia Fier të marr masa që për vitin 2018, me Vendim të Këshillit Bashkiak, vlerën e përcaktuar për zmadhim kapitali të Klubit Futbollit Apollonia, ta kalojë në artikullin 231 dhe jo në artikullin 602 të Buxhetit të bashkisë dhe të pasqyrohet në pasqyrat financiare në aktiv të bilancit ky kapital.

Menjëherë

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI:

Nga verifikimi rezultoi se nga vlera e rekomanduar nga KLSH prej..... **29,255,635** lekë

-Deri më datën 30.09.2018 është arkëtuar shuma0 lekë

Kanë mbetur pa u arkëtuar vlera prej..... 29,255,635 lekë

Nga të cilat:

-Janë nisur njoftimet për 7 rekomandime por ende nuk kanë filluar arkëtimet.... 29,255,635 lekë

Në mënyrë të detajuar masat shpërblim dëmi rikërkojmë si më poshtë:

1.1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt *“Rehabilitim i rrjetit ujitës me kanal in Vjosë – Levan - Fier”, Rehabilitim i kanalit sekondar – Dega e Martinës” Bashkia Fier*, me vlerë të kontratës (me tvsh)144,823,330 lekë, fituar nga subjekti Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë “B[REDACTED]” Sh.p.k & “B[REDACTED]” shpk, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën **3,573,690 lekë pa TVSH**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 4400 prot datë 21.10.2016 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Fier dhe Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë “B[REDACTED]” Sh.p.k & “B[REDACTED]” (*Trajtuar më hollësisht në faqet 72 - 79 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

1.1.1. Rekomandim:Nga Bashkia Fier të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **3,573,690 lekë pa TVSH** nga Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë “B[REDACTED]” Sh.p.k & “B[REDACTED]”, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën nr. 4400 prot datë 21.10.2016 me objekt *“Rehabilitim i rrjetit ujitës me kanal in Vjosë – Levan - Fier”, Rehabilitim i kanalit sekondar – Dega e Martinës” Bashkia Fier*, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si rrjedhojë e likuidimit të punimeve të pakryera. Kjo masë shpërblim dëmi revokohet pjesërisht. Vlera e dëmit ekonomik prej 1,473,500 lekë pa tvsh mbetet për tu arkëtuar, ndërsa për vlerën e dëmit ekonomik prej 2,100,190 lekë pa tvsh është pranuar observacioni.

Menjëherë

2.2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt *“Rikonstruksion i rrugës Qendër – Cakran - Autostradë”, Bashkia Fier*, me vlerë të kontratës (me tvsh)38,081,511 lekë me tvsh, fituar nga subjekti Operatori Ekonomik “C[REDACTED] R[REDACTED] 2[REDACTED]” Sh.p.k, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën **482,146 lekë pa tvsh**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 419 prot datë 24.03.2017 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Fier dhe Operatorit Ekonomik “C[REDACTED] R[REDACTED] 2[REDACTED]” (*Trajtuar më hollësisht në faqet 72 - 79 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

2.2.1. Rekomandim:Nga Bashkia Fier të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **482,146 lekë pa TVSH** nga Operatori Ekonomik “C[REDACTED] R[REDACTED] 2[REDACTED]”, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën nr. 419 prot, datë 24.03.2017, me objekt *“Rikonstruksion i rrugës Qendër - Cakran - Autostradë”*, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si rrjedhojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Menjëherë

Rekomandim: Të vazhdojë ndjekja e procedurave të nevojshme ligjore për arkëtimin e dëmit ekonomik nga 8, persona (antarë të KVO apo NJHDT), në vlerën 27,299,989 lekë , në lidhje me rekomandimet për 5 procedura prokurimi respektivisht nr. 3,4,5,6, dhe 7,(të trajtuar në mënyrë më të detajuar më poshtë), ku në mënyrë të përmbledhur paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Detyrimet e personave përgjegjës sipas pozicionit zyrtar për prokurimet paraqiten si më poshtë:

1. N[REDACTED] C[REDACTED] me pozicion _____ për 5 procedura Prokurimi për vlerën.....7.456.650 lekë

2. L[REDACTED] Z[REDACTED] me pozicion _____ për 5 procedura Prokurimi në vlerën....7.456.650 lekë

3. E[REDACTED] B[REDACTED] me pozicion _____ për 4 procedura prokurimi në vlerën....6.632.036 lekë

4. R[REDACTED] H[REDACTED] me pozicion _____ për 2 procedura prokurimi në vlerën... .1.643.347 lekë

5. O[REDACTED] Z[REDACTED] me pozicion _____ për 2 procedura prokurimi në vlerën 1.643.347 lekë

6. D [redacted] S [redacted] me pozicion _____ për 1 procedurë prokurimi në vlerën.....824.614 lekë
 7. A [redacted] H [redacted] me pozicion _____ për 1 procedurë prokurimi në vlerën..... 824.614 lekë
 8. R [redacted] P [redacted] me pozicion _____ për 1 procedurë prokurimi në vlerën..... 818.733 lekë
Gjithsejtë.....27,299,991 lekë

3.3. Gjetje nga auditimi: Në prokurimin publik me objekt “Rikonstruksion i shkollës ‘Perikli Ikonomi’” me fond limit 36,851,880 lekë pa tvsh, është skualifikuar OE “L [redacted] K [redacted]” me ofertë më të favorshme ekonomike në vlerën 30,961,419 lekë, si pasojë e kriterëve të vendosura në DST dhe devijimeve të vogla për dokumentacionin shoqëruar, duke shkaktuar përdorimin e fondeve publike me efekt dëm ekonomik në vlerën 4,947,681 lekë në papajtueshmëri me nenet 1, 2, 20, 46, 53 të ligjit Nr. 9643, date 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar (*Trajtuar më hollësisht në faqet 19-72 të Projekt Raportit të Auditimit*).

3.3.1 Rekomandim: Kryetari i Bashkisë dhe Këshilli Bashkiak Fier, nëpërmjet strukturave përgjegjëse, të marrë masa për analizimin dhe nxjerrjen e përgjegjësisë për zhdëmtimin e vlerës 4,947,681 lekë ndaj personave përgjegjës për procedurën e prokurimit, duke u udhëhequr nga qëllimi kryesor i ligjit për prokurimet publike ai i sigurimit të dobishmërisë maksimale të fondeve të prokuruar, të cilat nuk çenojnë thelbin e zbatimit të kontratës, procedura të cilat deri më tani kanë sjellë pasoja me efekte negative.

Menjëherë

4.4. Gjetje nga auditimi: Në prokurimin publik me objekt “Ndërtimi i tregut publik të produkteve bujqësore dhe blegtorale” me fond limit 45,974,536 lekë pa tvsh, si pasojë e kriterëve të vendosura në DST, është skualifikuar OE “B [redacted] [redacted]” me ofertë më të favorshme ekonomike në vlerën 42,584,083 lekë, duke shkaktuar përdorimin e fondeve publike me efekt dëm ekonomik në vlerën 3,129,573 lekë në papajtueshmëri me nenet 1, 2, 20, 46, 53 të ligjit Nr. 9643, date 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar (*Trajtuar më hollësisht në faqet 19-72 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

4.4.1 Rekomandim: Kryetari i Bashkisë dhe Këshilli Bashkiak Fier, nëpërmjet strukturave përgjegjëse, të marrë masa për analizimin dhe nxjerrjen e përgjegjësisë për zhdëmtimin e vlerës 3,129,573 lekë ndaj personave përgjegjës për procedurën e prokurimit, duke u udhëhequr nga qëllimi kryesor i ligjit për prokurimet publike ai i sigurimit të dobishmërisë maksimale të fondeve të prokuruar, të cilat nuk çenojnë thelbin e zbatimit të kontratës, procedura të cilat deri më tani kanë sjellë pasoja me efekte negative.

Menjëherë

5.5. Gjetje nga auditimi: Në prokurimin publik me objekt “Rikonstruksion i rrjetit të kanalizimeve në lagjen Sheq i madh” me fond limit 30,274,239 pa tvsh, si pasojë e kriterëve të vendosura në DST, është skualifikuar OE “N [redacted]” me ofertë më të favorshme ekonomike në vlerën 27,551,430 lekë, duke shkaktuar përdorimin e fondeve publike me efekt dëm ekonomik në vlerën 2,022,290 lekë në papajtueshmëri me nenet 1, 2, 20, 46, 53 të ligjit Nr. 9643, date 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar (*Trajtuar më hollësisht në faqet 19-72 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

5.5.1 Rekomandim: Kryetari i Bashkisë dhe Këshilli Bashkiak Fier, nëpërmjet strukturave përgjegjëse, të marrë masa për analizimin dhe nxjerrjen e përgjegjësisë për zhdëmtimin e vlerës 2,022,290 lekë ndaj personave përgjegjës për procedurën e prokurimit, duke u udhëhequr nga qëllimi kryesor i ligjit për prokurimet publike ai i sigurimit të dobishmërisë maksimale të fondeve të prokuruar, të cilat nuk çenojnë thelbin e zbatimit të kontratës, procedura të cilat deri më tani kanë sjellë pasoja me efekte negative.

6.6. Gjetje nga auditimi: Në prokurimin publik me objekt “Loti 3-Rehabilitim i rrjetit ujitës me kanalën Vjosë-Levan”- Rehabilitim i kanalit Sekondar - Dega e Martinës” me fond limit 120,686,108 lekë pa tvsh, është skualifikuar BOE “B [redacted] & E [redacted] C [redacted] C [redacted]” me ofertë

më të favorshme ekonomike në vlerën 115,773,708 lekë, si pasojë e kriterëve të vendosura në DST dhe devijimeve të vogla për dokumentacionin shoqëruar, duke shkaktuar përdorimin e fondeve publike me efekt dëm ekonomik në vlerën 4,912,400 lekë në papajtueshmëri me nenet 1, 2, 20, 46, 53 të ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar (*Trajtuar më hollësisht në faqet 19-72 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

6.6.1 Rekomandim: Kryetari i Bashkisë dhe Këshilli Bashkiak Fier, nëpërmjet strukturave përgjegjëse, të marrë masa për analizimin dhe nxjerrjen e përgjegjësive për zhdëmtimin e vlerës **4,912,400 lekë** ndaj personave përgjegjës për procedurën e prokurimit, duke u udhëhequr nga qëllimi kryesor i ligjit për prokurimet publike ai i sigurimit të dobishmërisë maksimale të fondeve të prokuruar, të cilat nuk çenojnë thelbin e zbatimit të kontratës, procedura të cilat deri më tani kanë sjellë pasojë me efekte negative.

Menjëherë

7.7. Gjetje nga auditimi: Në prokurimin publik me objekt “*Rikonstruktion i rrugës Daullas – Grecalli-Mujalli, Njësia Administrative Qënder*” me fond limit 127,025,351 lekë pa tvsh, si pasojë e kriterëve të vendosura në DST, është skualifikuar OE “G. [REDAKTUAR]” me ofertë më të favorshme ekonomike në vlerën 112,846,480 lekë, duke shkaktuar përdorimin e fondeve publike me efekt dëm ekonomik vlerën 12,288,045 lekë në papajtueshmëri me nenet 1, 2, 20, 46, 53 të ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar (*Trajtuar më hollësisht në faqet 19-72 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

7.7.1 Rekomandim: Kryetari i Bashkisë dhe Këshilli Bashkiak Fier, nëpërmjet strukturave përgjegjëse, të marrë masa për analizimin dhe nxjerrjen e përgjegjësive për zhdëmtimin e vlerës **12,288,045 lekë** ndaj personave përgjegjës për procedurën e prokurimit, duke u udhëhequr nga qëllimi kryesor i ligjit për prokurimet publike ai i sigurimit të dobishmërisë maksimale të fondeve të prokuruar, të cilat nuk çenojnë thelbin e zbatimit të kontratës, procedura të cilat deri më tani kanë sjellë pasojë me efekte negative.

Menjëherë

C. MASA DISIPLINORE:

Mbështetur në nenin 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, gjerat (b, c, ç) e nenin 58 “Llojet e masave disiplinore”, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, në VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil” dhe nenin 64 shkronjën “k” të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, **KLSH i rikërkon** Kryetarit të Bashkisë Fier të marrë masa për të ngritur Komisionin Disiplinor, pranë Institucionit për marrjen e masës disiplinore, **për 2 punonjës**, si më poshtë:

b“Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në 1 vit”:

1. z. P [REDAKTUAR] V [REDAKTUAR], me detyrë specialit i taksave
2. zj. E [REDAKTUAR] S [REDAKTUAR], me detyrë specialiste e taksave.

21. BASHKIA VLORË:

- Nga verifikimi rezulton se KLSH ka dërguar në Bashkinë Vlorë rekomandimet e auditimit me shkresën e saj nr.1029/16, datë 11.06.2017, ndërsa nga Bashkia Vlorë për zbatim e rekomandimeve të KLSH është kthyer përgjigje me shkresën e saj nr.5605, datë 03.07.2018, protokolluar në KLSH me shkresën nr. 1029/18, datë 09.07.2018. Pra përgjigja e Bashkisë për zbatimin e rekomandimeve të KLSH është bërë brenda afatit ligjor të kthimit të përgjigjes. Për zbatimin e rekomandimeve të KLSH nga Bashkia Vlorë është hartuar Plan veprimi dhe për zbatimin e rekomandimeve janë ngarkuar personat përgjegjës me afate konkrete.

- Nga verifikimi rezulton se përfundimet e auditimit i janë dërguar subjektit të audituar Bashkisë Vlorë, me shkresën e Kryetarit të KLSH nr.1029/16, datë 11.06.2018 dhe duhet të raportojë në KLSH brenda 6 muajve ose brenda datës 11.12.2018.

Nga verifikimi i dokumentacionit për zbatimin e rekomandimeve konstatohet se, janë rekomanduar gjithsej:

a . Për përmirësimin e gjendjes janë rekomanduar 36 masa organizative, nga të cilat janë pranuar plotësisht 36, masa nga të pranuarat janë zbatuar 7, masa dhe janë në proces zbatimi 28 masa organizative dhe nuk ka masa organizative të pa zbatuara.

Zbatuar

b. Janë rekomanduar 34 masa disiplinore, gjendja e të cilave paraqitet;

-Sipas "Ligjit për Nëpunësin Civil" janë rekomanduar **21 masa disiplinore** "Mbajtja deri në 1/3 e pagës së plotë për një periudhë deri në gjashtë muaj ose pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet", neni 58 germa (b,

-Për dhënien e masave disiplinore për nëpunësit civil janë zbatuar **17 masat** disiplinore të rekomanduara nga KLSH, "Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritje në shkallën e pagës për një periudhë 3 mujore", ka mbetur pa u zbatuar **1, masë disiplinore ndërkohë 3** punonjës kanë ndërprerë marrëdhëniet financiare me Bashkinë Vlore.

-Sipas "Kodit të Punës në Republikën e Shqipërisë" janë rekomanduar **13, masa disiplinore nga "Vërejtje" deri në "Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna"**, për të cilën Kryetari i Bashkisë Vlorë ka nxjerrë Vendim për masën disiplinore "Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna" për 12 punonjës, **1** punonjës është larguar nga Bashkia Vlore.

Zbatuar

c. I janë rekomanduar APP të vlerësojë shkeljet e konstatuara, duke vendosur marrjen e masave administrative (dënim me gjobë) në raport me shkeljet e konstatuara, apo me rekomandimin e autoritetit kontraktor (për marrjen e masave disiplinore) për 18 persona. Nga verifikimi rezulton se APP me vendimin nr. 105 datë 18.10.2018 percjellë për në Bashkinë Vlorë dhe KLSH-në me shkresën nr. 6131/5 prot datë 18.10.2018 e cila është protokolluar në Bashkinë Vlorë me shkresën nr. 9060, prot., datë 22.10.2018 duke vendosur masa dënim me gjobe për **14 persona** në shumën **1,490,000 lekë** dhe rekomandim për masë disiplinore për **2 persona**. Për të cilat nga Bashkia Vlorë janë njoftuar personat sipas vendimit të APP.

Zbatuar

d.Për shpërblim dëmi janë rekomanduar 17 masa me vlerë 85,871,776 lekë, deri me datë 30.09.2018 nga prej shuma 85,852,699 lekë e rekomanduar nga KLSH paraqitet si më poshtë:

Nga verifikimi rezultoi se nga vlera e rekomanduar nga KLSH prej..... **85,871,776 lekë**

Nga të cilat:

-Nuk janë zbatuar 3 rekomandime në vlerën..... 26,286,015 lekë

-Janë në proces gjyqësor 7 rekomandime (13 subjekte) në vlerën42,779,807 lekë

-Janë nisur njoftimet për 6 rekomandime por ende nuk kanë filluar arkëtimet.... 16,751,966 lekë

Pra për masa shpërblim dëmi nga rekomandimi i KLSH prej **85,871,776 lekë**, janë zbatuar vlera prej 59,585,761 nga e cila 7 rekomandime për 13 subjekte kryesisht firmat e zbatimit të punimeve në vlerën prej **42,779,807 lekë**, janë nxjerrë Urdhrat ekzekutivë dhe janë hapur paditë gjyqësore, për 6 rekomandime në vlerën **16,751,996 lekë**, kanë dalë urdhrat ekzekutivë, ndërkohë që deri më datën e verifikimit nuk kanë dalë urdhrat ekzekutivë për **2 rekomandime për vlerën 26,286,015 lekë** të sqaruara më poshtë.

Në mënyrë të detajuar masat shpërblim dëmi rikërkojmë si më poshtë:

1.1.1. Rekomandimi: Drejtoria e Menaxhimit Financiar në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtimin nga 7 subjekte në vlerën **23,837,435 lekë**, (nga e cila ndaj subjektit "C [REDACTED]" SHPK, për 4 objekte në vlerën **10,759,833 lekë**), si vijon:

- **vlera 8,186,306 lekë**, ndaj subjektet “SH [REDACTED]” SHPK, në objektin “Rikonstruksion rruga Ura tek varrezat - Fshati Risili, L=3 km”, Vlorë, sipas kontratës së punimeve nr. 2180 prot., datë 20.03.2017.
- ndaj subjektit “**COLOMBO**” SHPK, për 4 objekte në vlerën **10,759,833 lekë**, respektivisht:
 - **vlera 835,350 lekë**, ndaj subjektit “C [REDACTED]” SHPK, në objektin “Përmirësimi i kushteve të banesave të komunitetit Egjiptian 2016”, Vlorë, sipas kontratës së punimeve 3897 prot., datë 18.05.2016.
 - **vlera 411,220 lekë**, ndaj subjekti “C [REDACTED]” SHPK, në objektin “Përmirësimi i kushteve të banesave të komunitetit Egjiptian 2017”, Vlorë, sipas kontratës së punimeve nr. 5828 prot., datë 29.06.
 - **vlera 2,173,433 lekë**, ndaj subjektit “C [REDACTED]” SHPK, në objektin “Rikualifikimi i bllokut të banimit të kufizuar nga rrugët “Tasim Jonuzi”, “Demokracia”, “Janaq Kilica”, “Rruga e Paqes”, Vlorë, sipas kontratës së punimeve nr. 749, Datë 30.01.2017.
 - **vlera 7,339,830 lekë**, ndaje subjekteve “C [REDACTED]” SHPK dhe “F [REDACTED]” SHPK, në objektin “Rikonstruksion i shkollës së mesme Ali Demi”, Vlorë, sipas kontratës së punimeve nr. 9762 prot., datë 18.11.2016.
 - **vlera 1,688,863 lekë**, ndaje subjektet “A [REDACTED]” SHPK, në objektin “Rikonstruksion i Rrugëve Xhebro Gjika, Veledin Kollozi dhe i bllokut te banimit mbas CONAD - it, faza I”, Vlorë, sipas kontratës së punimeve nr. 10951 prot., datë 27.12.2016.
 - **vlera 1,937,337 lekë**, nga e cila penalitet në vlerën 1,613,760 lekë, ndaj subjekti “C [REDACTED] R [REDACTED] 2 [REDACTED]” SHPK, në objektin “Rehabilitimi dhe riasfaltimi i disa rrugëve kryesore të qytetit të Vlorës”, sipas kontratës së punimeve nr. 10951 prot., datë 27.12.2016.
 - vlera 881,745 lekë**, ndaj subjekti “L [REDACTED] K [REDACTED]” SHPK, në objektin “Rikonstruksion i rrugës së fshatit Kërkovë”, Vlorë, sipas kontratës së punimeve nr. 837 prot., datë 06.08.2014.- **vlera 374,580 lekë**, ndajë subjekti “E [REDACTED] C [REDACTED]” SHPK, në objektin “Ndriçimi i rrugëve në qytetin e Vlorës”, sipas kontratës së punimeve nr. 4611 prot., datë 01.06.2017. datë 06.08.2014.
 - **vlera 8,771 lekë**, ndaj subjekti “A [REDACTED]” SHPK, në objektin “Rikonstruksion Godina e Kopshtit nr. 7”, sipas kontratës së punimeve 6174 prot., datë 12.07.2017

2.2. Gjetje nga auditimi: Në objektin “Sistemi Multifunksional Smart City Lungomare” Vlorë, nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të punimeve të ndërtimit të administruara në dosjen teknike rezultuan diferenca në volume pune të likuiduara por jo të kryera në fakt në përputhje me projekt – preventivin dhe specifikimet teknike të miratuara nga AK në vlerën **9,920,000 lekë** si dhe rritje fiktive e fondit limit në vlerën **5,959,800 lekë, me pasojë dëm ekonomik**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 5995 prot., datë 10.07.2017 të lidhur mes Titullarit të Autoritetit Kontraktor Bashkia Vlorë dhe OE “C [REDACTED] P [REDACTED]” SHPK si dhe me Vendimin Nr. 514, datë 15.08.2007 “Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, e konkretisht pika 2, 3 dhe 9 (Trajtuar më hollësisht në faqet 176-241, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.2.1. Rekomandimi: Drejtoria e Menaxhimit Financiar në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtimin e **vlerës 9,920,000 lekë** nga operatori ekonomik “C [REDACTED] P [REDACTED]” SHPK.

Menjëherë

2.2.2. Rekomandimi: Drejtoria e Menaxhimit Financiar në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, të ndjek të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtimin e **vlerës 5,959,800 lekë**, ndaj punonjësve dhe drejtuesit përgjegjës në procedurën me objekt: “Sistemi Multifunksional Smart City Lungomare”, Vlorë, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore si rrjedhojë e rritjes fiktive të fondit limit të vënë në dispozicion të investimit.

Menjëherë

3.3. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e kontratës së qirasë nr. 2946 Rep dhe nr. 154 Kol, datë 4 Qershor 2002 të objektit: "Parku i lojërave të qytetit të Vlorës", të lidhur midis Ministrisë së Ekonomisë, cilësuar si "Qiradhënës" dhe z. B [REDAKTUAR] B [REDAKTUAR] administrator i shoqërisë "I [REDAKTUAR]" SHPK, të cilësuar si "Qiramarrës", si dhe në zbatimin të rekomandimit të KLSH paraqitur me shkresën nr. 707/13 prot, datë 30.06.2014 të miratuar nga Kryetari i KLSH, *konstatohet se:* Me vendim të Këshilli Bashkiak nr. 60, datë 27.10.2016 është bërë miratimi i sipërfaqes së marrë nga përdorim nga shoqëria "I [REDAKTUAR]".

Sipas këtij vendimi nga matjet e kryera në terren për saktësimin e sipërfaqes funksionale të marrë me qira nga shoqëria "I [REDAKTUAR]" është miratuar ndryshimi i sipërfaqes funksionale të sipërfaqes së objektit "Parkut të Lojërave të Qytetit të Vlorës" (kontrata nr. nr. 2946 Rep dhe nr. 154 Kol, datë 4 Qershor 2002, për të cilën ka rënë dakord), prej 14960 m², ku detyrimi që i lind subjekti "I [REDAKTUAR] 1" në zbatim të VKB nr. 60, datë 27.10.2016 për sipërfaqen e marrë me qira të objekti: "Parkut të Lojërave të Qytetit të Vlorës" prej 14690 m², paraqitet në vlerën 6,983,486 lekë, si ardhur me dëm për buxhetin e Bashkisë Vlorë dhe të MZHETTS, aktualisht Ministria e Financave dhe Ekonomisë (këtu e vijim MFE), sipas përqindjeve (70% MFE dhe 30% Bashkia Vlorë).

Gjithashtu sipas pikës 3, të VKB nr. 60, datë 27.10.2016, Bashkia Vlorë duhet t'i dërgoj për kompetencë MFE për sipërfaqen e sanksionuar në përdorim nga shoqëria "L [REDAKTUAR]", veprim i cili nuk është kryer nga Bashkia Vlorë, për të bërë të mundur ndryshimin e kushteve të kontratës për pagesën e qirasë sipas sipërfaqes së re të konstatuar nga matjet faktike të kryera në terren dhe për të cilën ka rënë dakord dhe qiramarrës (*Trajtuar gjerësisht në faqen 299-310, të Projekt Raport auditit*).

3.3.1. Rekomandimi: Drejtoria Menaxhimit të Aseteve dhe Pronave në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike Bashkia Vlorë, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët për arkëtimin e vlerës 6,983,486 lekë ndaj subjektit "I [REDAKTUAR]".

3.3.2. Rekomandimi: Drejtoria Menaxhimit të Aseteve dhe Pronave në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike në Bashkinë Vlorë, të rinjoftojë MFE në zbatimin e VKB nr. 60, datë 31.10.2016 për modifikimin e kushteve të kontratës pasi sjelle efekte financiare për vlerën e qirasë mujore sipas sipërfaqes së sanksionuar me procesverbal datë 27.01.2016 prej 14690 m², për të cilën ka rënë dakord dhe subjekti "I [REDAKTUAR]".

3.3.3. Rekomandimi: Drejtoria Juridike në Bashkinë Vlorë në bashkëpunim me MFE, të marrë masa që shoqëria "I [REDAKTUAR]" të derdhë garancinë e kontratës në emër të subjektit "Bashkia Vlorë" sipas pikës 6.3 të kontratës së qirasë nr. 2946 Rep dhe nr. 154 Kol, datë 4 Qershor 2002.

Menjëherë

4.4. Gjetje nga auditimi: Në ish Komunën Shushicë dhe Bashkinë Vlorë, nuk është aplikuar saktë tarifa vjetore lekë/ha/vit për sipërfaqen pyjore dhe kullosore të dhënë me qira për ushtrimin e aktivitetit për qëllime biznesi në territor tokë inproduktive, si dhe arkëtimi i plotë i detyrimit nga shoqëria "D [REDAKTUAR]" SHPK në vlerën 6,570,350 lekë, veprime në shkëlqje të VKM nr. 391, datë 21.06.2006 "Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave", pika 2, lidhja nr. 2, pikat 5; të ndryshuar me VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 "Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave", pika 2, lidhja nr. 2, pikat 6 (*Trajtuar më hollësisht në faqet 241-259, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

4.4.1. Rekomandimi: Drejtoria e Menaxhimit Financiar në bashkëpunim me Drejtorinë e Aseteve Bashkia Vlorë, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës 6,570,350 lekë nga shoqëria "D [REDAKTUAR]" SHPK.

Menjëherë

5.5. Gjetje nga auditimi: Nga Bashkia Vlorë, ish-Komuna Novoselë, sot Njësia Administrative Novoselë, është dhënë me qira sipas kontratave respektive nr. 91, datë 30.03.2012, nr. 403, datë 01.04.2013, nr. 42, datë 27.03.2014 dhe nr. 63, datë 26.03.2015 të nënshkruara nga ish-Kryetari K [REDAKTUAR] Sh [REDAKTUAR] dhe qiramarrës N [REDAKTUAR] S [REDAKTUAR], për objektin "Thertore", me sipërfaqe prej 193.5 m² dhe vlerë qiraje mujore prej 30,000lekë. Lidhja e kontratave nuk u është referuar bazës ligjore në fuqi në kohën e nënshkrimit të saj, pasi në kundërshtim me VKM nr. 529, datë 08.06.2011, "Për

përcaktimin e kritereve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfitozoë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, ndryshuar me VKM nr. 739, datë 01.07.2009, VKM nr. 54, datë 05.02.2014, VKM nr. 735, datë 05.11.2014, VKM nr. 606, datë 31.08.2016 dhe VKM nr. 693, datë 05.10.2016, pasi sipas certifikatës së pronësisë të objektit “Thertore” të lëshuar nga ZVRPP, sipërfaqja funksionale e tij është 1200m², sipërfaqe për të cilën nuk është aplikuar tarifa prej 20% të tarifës dysHEME, ose 20/lekë/m²/muaj, me pasojë të ardhura të munguara me dëm ekonomik në vlerën prej 1,728,000 lekë (për të gjithë periudhën e vlefshmërisë), po ashtu nuk është dhënë me qira linja e përpunimit/prodhimit dhe inventarit të imët të objektit, i cili sipas regjistrimit kontabël të objektit është në vlerën mesatare 7,200,000 lekë, dhe në referim të kapitullit III, pika 5 të VKM, duhet të ishte lidhur kontratë qiraje, për pasuritë e luajtshme e cila është sa 1/10 e VAM-it, duke krijuar të ardhura me dëm ekonomik në vlerën prej 5,688,000 lekë (*Trajtuar më hollësisht në faqet 299-371, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

5.5.1. Rekomandimi: Drejtoria Juridike në bashkëpunim me Drejtorinë e Administrimit të Pronave Publike dhe Drejtoria e Menaxhimit Financiar, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për kërkimin dhe arkëtimin e vlerës **5,688,000 lekë**, shkaktuar nga ish-Kryetari i Komunës Novoselë z. K. [REDAKTUAR] Sh. [REDAKTUAR] dhe përdoruesi i pasurisë sipas kontratës N. [REDAKTUAR] S. [REDAKTUAR], si dhe të bëjë përditësimin e kontratës me subjektin, sipas referencës ligjore aktuale.

Menjëherë

6.6. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e tenderi me objekt: “Ndërtim i rrjetit të kanalizimeve, fshatrat Llakatund dhe Shushicë” të zhvilluar në ish- Komunën Shushicë, konstatohet se fondit limit prej 32,669,379 lekë është preventivuar më tepër për vlerën 1,158,300 lekë, pasi disa zëra cimet e preventivuar nuk janë sipas çmimeve të manualit teknik të miratuara në VKM nr. 407, datë 27.6.2012 “Për miratimin e manualeve teknik të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizave teknike”, i ndryshuar (*Trajtuar gjerësisht në faqen 76-176, të Raport Përfundimtar të Auditimit*).

6.6.1. Rekomandimi: Drejtoria e Menaxhimit Financiar në Bashkinë Vlorë, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët për arkëtimin e vlerës **1,158,300 lekë**, nga anëtarët e grupit të punës për hartimin e preventivit në mënyrë të barabartë: Ing. N. [REDAKTUAR] B. [REDAKTUAR] dhe ing. E. [REDAKTUAR] I. [REDAKTUAR].

Menjëherë

7.7. Gjetje nga auditimi: Në kontratën nr. 10284, datë 6.12.2016 në tenderi me objekti: “Rikonstruksion i godinës Njësia Administrative (NJA) Shushicë, viti 2016”, afati për përfundimin e punimeve është 60 ditë kalendarike, nga data e nënshkrimit të kontratës ose deri me datë 18.6.2016. Referuar dokumentacionit në dosje, subjekti me datë 06.01.2017 ka paraqitur shkresën nr. *Ekstra*, për zgjatje afati për shkak të kushteve atmosferike deri me datë 20.01.2017. Me shkresën nr. 61/1, datë 10.01.2017 të titullarit të AK është bërë miratimi i zgjatjes së afatit të punimeve deri me datë 01.02.2017. Me datë 17.03.2017 subjekti sipërmarrës i punimeve “M. [REDAKTUAR]” ka njoftuar për përfundimin e punimeve, punime të cilat nuk kanë përfunduar në afatin e caktuar në kontratën dhe shtesës së afatit me datë 01.02.2017, pra punimet kanë përfunduar jashtë afatit prej **47 ditë kalendarike**.

Ndaj subjektit me datë 21.03.2017 është likuiduar detyrimi në shumën 6,982,932 lekë, por që nuk është llogaritur penalteti për mos përfundimin në afat të punimeve sipas nenin 34 pika 34/1 të kontratës në vlerën **1,312,791 lekë**, veprime financiare me efekt negativ me dëm në buxhetin e Bashkisë Vlorë (*Trajtuar në faqen 76-176 të Projekt Raport të Auditimit*).

7.7.1. Rekomandimi: Drejtoria Menaxhimit Financiar Bashkia Vlorë në bashkëpunim me Drejtorinë e Shërbimeve Publike, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët për arkëtimin e vlerës **1,312,791 lekë** nga subjekti “M. [REDAKTUAR]”

Menjëherë

8.8. Gjetje nga auditimi: Në ish- Komunën Qendër, referuar të dhënave të kontratës nr. 837, datë 06.08.2014 të lidhur midis ish- Kryetarit të Komunës përfaqësuar nga z. F. [REDAKTUAR] B. [REDAKTUAR] dhe subjektit “L. [REDAKTUAR] K. [REDAKTUAR]”, konstatohet parregullsi në kushtet e veçanta të saj. Kështu në ofertën

e paraqitur nga subjekti dhe shpallur fitues është përfshirë vlera e projektit prej 318,247 lekë dhe vlera e mbikëqyrësit prej 249,385 lekë, gjithsej për vlerën **567,632 lekë**, e cila konsiderohet dëm ekonomik në buxhetin e ish komunës dhe në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publike”, i ndryshuar dhe ligjin nr. 8402, datë 19.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, neni 7 (në kushtet e veçanta të kontratës në nenin 3) (*Trajtuar në faqen 76-176, të Projekt Raport të Auditimit*).

8.8.1 Rekomandimi: Drejtoria Menaxhimit Financiar Bashkia Vlorë, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët për arkëtimin e vlerës **567,632 lekë** ndaj subjektit “L ■ K ■■■■■■”.

Menjëherë

9.9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt “Rikonstruksion i shkollës 9 vjeçare “Rilindja” Vlorë, të lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkisë Vlorë dhe shoqërisë “C ■■■■■■ SHPK, u konstatua se:

- Janë likuiduar tepër në vlerën **282,180 lekë** (1,415,900 x 20%), si pasojë e përfshirjes në situacionin e punimeve të TVSH-së së pajisjeve Kalorifer në kundërshtim me UKM nr. 2, datë 08.05.2003, VKM Nr. 514, datë 15.08.2007, UKM Nr. 1, datë 16.06.2011, ku përcaktohet se formati i miratuar nga Këshilli i Ministrave me udhëzimin e lartpërmendur parashikon emërtimin e zërave të punimeve, sasi, çmim, vlerë si dhe shuma e tyre, duke i shtuar TVSH-në, pastaj kësaj shume i shtohen vetëm pajisjet.

- Nga auditimi në terren për verifikimin e realizimit të zërave të punimeve si dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit teknik të zbatimit, mbikëqyrjes dhe kolaudit të punimeve të ndërtimit, të administruara në dosjen teknike të zbatimit, rezultojnë diferenca në volume zërash në **shumën 202,764 lekë**(*Trajtuar më hollësisht në faqet 176-241, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

9.9.1. Rekomandimi:Drejtoria e Menaxhimit Financiar në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtimin e **vlerës 484,944 lekë**, ndajoperatorit ekonomik “C ■■■■■■” SHPK, të përfutuar tepër për punime të pakryera dhe për përfshirjen e TVSH-së për pajisjet e stacionuara në zbatimin e kontratës me objekt “Rikonstruksion i shkollës 9 vjeçare “Rilindja”.

Menjëherë

10.10. Gjetje nga auditimi: Në ish - Komunën Qendër, u konstatua dëm ekonomik në vlerën 121,680 lekë, pasi gjatë muajit Korrik të vitit 2015, sipas fletë daljes nr. 31, datë 30.06.2015 është bërë shpërndarja e karburantit, por mungon dokumentacioni shoqërues mbi mënyrën e përdorimit të tij (fletë udhëtimet), veprime të cilat ngarkojnë me përgjegjësi ish- punonjësit z. Xh ■■■■■■ H ■■■■■■ për sasinë 80 litra me vlerë 13,520 lekë, z. Th ■■■■■■ T ■■■■■■ për sasinë 50 litra me vlerë 8,450 lekë, z. H ■■■■■■ F ■■■■■■ për sasinë 50 litra me vlerë 8,450 lekë, z. F ■■■■■■ B ■■■■■■ për sasinë 390 litra me vlerë 65,910 lekë, z. Z ■■■■■■ M ■■■■■■ për sasinë 150 litra me vlerë 25,350 lekë, në kundërshtim me UMF nr. 30 datë 27.12.2010 “Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik”.

Gjithashtu nga ish- Kryetari i Komunës z. F ■■■■■■ B ■■■■■■ për vitin 2014 janë kryer shpenzime për bonus transporti pa mbështetje ligjore në vlerën 75,000 lekë në kundërshtim me ligjin nr. 169/2013, datë 7.11.2013 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 10160, datë 15.10.2009 "Për rregullimin e shërbimit të transportit për funksionarët publikë dhe nëpunësit civilë", i ndryshuar me ligjin nr. 169/2013 miratuar më dt. 07.11.2013 (*Trajtuar gjerësisht në faqen 49-76, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

10.10.1. Rekomandimi: Drejtoria e Menaxhimit Financiar Bashkia Vlorë, të marrë masa duke ndjekur procedurat administrative për shpërblimin e dëmit në vlerën **196,680 lekë**, ndaje ish-punonjësve si vijon:

- vlera **13,520 lekë** nga z. Xh ■■■■■■ H ■■■■■■ me detyrë ish- specialist në Zyrën e Bujqësisë;
- vlera **8,450 lekë** nga z. Th ■■■■■■ T ■■■■■■ me detyrë ish- Përgjegjës i Zyrës së Taksave;
- vlera **8,450 lekë** nga z. H ■■■■■■ F ■■■■■■ me detyrë ish- Jurist;
- vlera **65,910 lekë** nga z. F ■■■■■■ B ■■■■■■ me detyrë ish- Kryetar Komune;

-vlera 25,350 lekë nga z. Z. M. me detyrë ish- specialist në Zyrën e Shërbimeve, për sa kanë tërhequr karburant nga magazina sipas fletë daljes nr. 31, datë 30.06.2015 sipas planit të shpërndarjes dhe nuk kanë paraqitur dokumente justifikues (fletë udhëtime).

-vlera 75,000 lekë nga z. F. B. për vlerën e bonusit të transporti si ish- Kryetar Komune.

Menjëherë

11.11. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e kushteve të zbatimit të kontratës nr. 5893, datë 14.07.2016, në tenderi me objekti: “Blerje pajisje (kompjuter, printer dhe fotokopje) për Bashkinë Vlorë, viti 2016”, rezulton se malli është marrë në dorëzim dhe bërë hyrje sipas FH nr. 16, datë 13.09.2016 (fatura tatimore nr. 3562, datë 31.07.2016) dhe likuiduar me urdhër shpenzimit nr. 715, datë 26.09.2016.

Nga të dhënat konstatohet se malli nuk është lëvruar sipas kushteve të kontratës me datë 24.07.2016 por është lëvruar me datë 31.07.2016 (konfirmuar nga fatura e TVSH nr. 3562, dt. 31.7.2016), pra me 7 (shtatë) ditë vonës, për të cilën nuk është llogaritur penalteti (kamat vonesat) në vlerën **95,426 lekë**, veprime financiare me efekt negativ me dëm në buxhetin e Bashkisë Vlorë (Trajtuar në faqen 76-176 të Raport Përfundimtar të Auditimit).

11.11.1. Rekomandimi: Drejtoria Menaxhimit Financiar Bashkia Vlorë në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët për arkëtimin e vlerës **95,426 lekë** nga subjekti “P. [REDAKTUAR]”.

Menjëherë

12.12. Gjetje nga auditimi: Në ish- Komunën Qendër Vlorë me datë 18.6.2014 nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave (KVO) është hartuar dhe dërguar për miratim Raporti Përmbledhës për procedurën me objekt “Pastrim i Zonave Urbane, vit 2014”, duke shpallur fitues OE “M. [REDAKTUAR]” me ofertë 2,483,100 lekë , si operator i vetëm i rregullt nga dy pjesëmarrësit. Me shkresën nr. 30, datë 17.6.2014 (prot subjekt nr. 640, datë 18.6.2014), operatori “SH. [REDAKTUAR]” është njohur me faktin se është shpallur fitues në procedurën “Pastrim i zonave urbane”, ku sipas DST është kërkuar kryerja e shërbimit për një afat një vjeçar, ku në ofertën e paraqitur nga shoqëria “SH. [REDAKTUAR]”, është pasur parasysh se shërbimi i pastrimit është deri me datë 31.12.2014. Pra oferta është deri me 31.12.2014 dhe jo me afat njëvjeçar, duke bërë kështu kërkesë për tërheqje nga konkurrimi.

Nga verifikimi në sistem dhe dosje i DST, në lidhje me zbatimin e afateve të punimeve, konstatohet se afati i shërbimit të pastrimit nuk është një vit nga data e lidhjes së kontratës, siç pretendohet nga subjekti por është deri në fund të vitit 2014. Pra argumenti i përdorur nga subjekti për tu tërhequr nga gara është i pavërtetë, veprim në kundërshtim me nenin 49, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar. KVO duhet të kërkonte sekuestrimin e garancisë së ofertës në masën 2% ose vlerën **50,000 lekë, dëm ekonomik** në buxhetin e ish- Komunës Qendër Vlorë (Trajtuar gjerësisht në faqen 76-176, të Raport Përfundimtar të Auditimit).

12.12.1 Rekomandimi: Drejtoria e Menaxhimit Financiar në Bashkinë Vlorë, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët për arkëtimin e vlerës **50,000 lekë**, nga subjekti “SH. [REDAKTUAR]”.

Menjëherë

13.13. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e strukturës organizative dhe nivelin e pagave sipas funksioneve në Bashkinë Vlorë, u konstatua se është aplikuar dhe përllogaritur gabim vlera e pagës së grupit për grupet e diplomave të arsimit universitar dhe për shtesën e pagës për vjetërsinë në punë për dy punonjës të Bashkisë, veprim në kundërshtim me VKM nr. 586, datë 17.07.2013 “Për disa ndryshime në vendimin nr. 1619, datë 02.07.2008, të KM "Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të qeverisjes vendore për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të punonjësve të organeve të qeverisjes vendore", lidhja nr. 2, dhe VKM nr. 165, datë 02.03.2016 “Për grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të

njësive të vetëqeverisjes vendore” pika 5, 6 dhe lidhja nr. 9, me pasojë dëmin ekonomik për buxhetin e bashkisë Vlorë, në **vlerën 45,217 lekë** (*Trajtuar më hollësisht në faqet 43-49, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

13.13.1. Rekomandimi: Drejtoria e Menaxhimit Financiar në bashkëpunim me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore Bashkia Vlorë, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **45,217 lekë**, përkatësisht:

-**vlera 10,306 lekë**, ndaj punonjësës z. V [REDAKTUAR] Z [REDAKTUAR] me detyrë specialit në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore

-**vlera 34,911 lekë**, ndaj punonjësës zj. A [REDAKTUAR] B [REDAKTUAR] me detyrë specialiste pagash në Qendrën Ekonomike.

Menjëherë

14.14. Gjetje nga auditimi: Bashkia Vlorë, në vitin 2016 ka lidhur 136 kontrata për zënie të përkohshëm të hapësirave publike (plazhe), për vlerën prej 28,198,750 lekë dhe sipërfaqe prej 48937 m². Lidhur me nivelin e zbatimit dhe arkëtimin të ardhurave nga qiraja rezultoi se 18 nga 136 subjekte nuk kanë shlyer pjesërisht apo plotësisht detyrimet sipas kontratës apo aktmarrëveshjeve tip, duke krijuar një efekt financiar negative si pasojë e mospërmbushjes të detyrimeve kontraktore në vlerën prej **2,675,500 lekë** shumë e cila përbën të ardhura të munguara me dëm ekonomik dhe veprime në kundërshtim me VKM nr. 369, datë 18.05.2016 “Për miratimin e rregullores për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit” dhe kontratave tip respektive, sipas tabelës bashkëlidhur (*Trajtuar më hollësisht në faqet 299-371, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

14.14.1. Rekomandimi: Drejtoria Juridike në bashkëpunim me Drejtorinë e Administrimit të Pronave Publike, Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe Drejtoria e Tatimeve e Taksave, të marrë të gjitha masat duke kryer të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për arkëtimin e detyrimeve prej **2,675,500 lekë** të lindura nga mos shlyerja dhe mospërmbushja e detyrimeve kontraktore, procedura në referim të VKM nr. 369, datë 18.05.2016 dhe kontratave respektive.

Menjëherë

Për Njësinë e Auditimit të Brendshëm Publik, Bashkia Vlorë.

Nga verifikimi rezultoi se për masa shpërblim dëmi nga rekomandimi i KLSH prej **85,871,776 lekë**, janë zbatuar vlera prej 59,585,761 nga e cila 7 rekomandime për 13 subjekte kryesisht firmat e zbatimit të punimeve në vlerën prej **42,779,807 lekë**, janë nxjerrë Urdhrat ekzekutivë dhe janë hapur paditë gjyqësore, për 6 rekomandime në vlerën **16,751,996 lekë**, kanë dalë urdhrat ekzekutivë, ndërkohë që deri më datën e verifikimit nuk kanë dalë urdhrat ekzekutivë **për 3 rekomandime për vlerën 26,286,015 lekë** të sqaruara në *Raportin Përfundimtar të Auditimit*.

Në kushtet e pamundësisë nga KLSH të verifikimit rast pas rasti të dokumentacionit të 7 procedurave të prokurimit të evidentuara në *Raportin Përfundimtar të Auditimit* dhe mbështetur në shkronjat (i) dhe (f) të nenit 15, -*Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së*, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”; sipas të cilit “ , KLSH ka të drejtë t’i propozojë njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik të kryejnë auditime brenda kompetencës të tyre” ; *nenit 25-Marrëdhëniet me Kontrollin e Lartë të Shtetit*, të ligjit nr. 114/2015 datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, dhe ISSAI 1600, **rekomandojmë:**

Njësia e Auditimit të Brendshëm në Bashkinë Vlorë, në bazë të një programi tematik auditimi të miratuar nga Titullari i Bashkisë, të verifikojë të gjithë dokumentacionin lidhur me 7 procedurat e prokurimit mbi të cilin është bërë vlerësimi i shpalljes së ofertave fituese.

Pas verifikimit dhe saktësisimit të këtyre procedurave **i lihet në kompetencë Kryetarit të Bashkisë**, të përcaktojë masat përkatëse në lidhje me vlerën e dëmit që duhet të kthejnë në buxhet personat përgjegjës.

Brenda datës 30.01.2019

Në mënyrë të detajuar 3 rekomandimet që i përkasin 7 procedurave të prokurimit të cilat nuk janë zbatuar dhe do të vlerësohen nga Njësia e Auditit të Brendshëm të Bashkisë Vlorë janë si më poshtë:

15.15. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e procedurave të prokurimeve të zhvilluar në **Bashkinë Vlorë**, u konstatua se në **4 procedura** me vlerë të fondit limit 236,832,088 lekë, janë shpallur fitues operatorët ekonomikë me mangësi në plotësimin e kriterëve të DST, miratuar nga Autoriteti Kontraktor (AK) dhe Njësia e Hartimit të Dokumenteve të Tenderit (NJHDT), dhe skualifikuar operatorë ekonomike me ofertë më të leverdishme se operatori fitues, duke mos vlerësuar kriterin kryesorë “Çmimin më të leverdishëm midis operatorëve”, veprime të cilat kanë çuar në përdorimin me efekt negative të fondeve të prokuruar me dëm në shumën **16,926,338 lekë**, në kundërshtim me neni 1- “Objekti dhe qëllimi”, pika 2, germa (c, ç, d, dh), neni 2-“Parimet e përzgjedhjes”, neni 24-“Anulimi i një procedure prokurimi”, neni 53- “Shqyrtimi i ofertave”, neni 55- “Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese”, konkretisht praktikat:

1- Tenderi me objekt: “Ruajtja e objekteve të Bashkisë dhe Institucioneve të Varësisë për vitin 2015”, me fond limit 14,931,285 lekë, ku fitues është shpallur OE “F. [REDAKTUAR]” me ofertë 14,930,987 lekë . KVO nuk ka vlerësuar drejt OE “F. [REDAKTUAR]”, pasi nuk i plotëson të gjitha kriteret e DST të miratuara nga AK, si: -Vërtetimi i energjisë elektrike nuk është në përputhje me VKM (parregullt); - Kontrata e qirasë për vendin e selisë nuk është shoqëruar me dokumente që vërtetojnë pronësinë e palës qiradhënëse; -Në verifikimin e listëpagesave të subjektit me deklaratimet e rojeve që janë të angazhuar në zbatimin e kësaj kontrate sipas deklarimeve të bërë nga vetë subjekti dhe drejtuesi teknik, konstatohet se disa prej tyre nuk janë të siguruar gjatë gjithë periudhës për të cilën është kërkuar, duke s’ padrejtësisht fitues OE “A [REDAKTUAR]-P [REDAKTUAR]” me mangësi në kriteret e vendosura DST, për të shmangur efektin negativ në përdorimin e fondeve publike me dëm në vlerën **2,821,066 lekë**.

2- Tenderi me objekt: “Ndriçimi i rrugëve në qytetin Vlorë”, me fond limit 25,000,923 lekë, ku fitues është shpallur OE “E [REDAKTUAR]” me ofertë 24,949,484 lekë . KVO nuk ka vlerësuar drejt OE “E [REDAKTUAR]” me ofertë 24,949,484 lekë , pasi nuk i plotëson të gjitha kriteret e DST të miratuara nga AK, si: -Nuk paraqet grafikun e punimeve, sipas pikës 2.2/H të DST; -Nuk është plotësuar numri prej 4 elektricistë që kërkohen sipas pikës 2.2/F të DST, duke vlerësuar padrejtësisht fitues OE “E [REDAKTUAR]” me mangësi në kriteret e vendosura DST, për të shmangur efektin negativ në përdorimin e fondeve publike me dëm në vlerën **6,430,849 lekë**.

3- Tenderi me objekt: “Rikonstruksion “Ura e Zvërnecit”, Nartë-Vlorë”, viti 2016”, me fond limit 30,670,398 lekë , ku fitues është shpallur OE “A [REDAKTUAR]” me ofertë 27,446,183 lekë . KVO nuk ka vlerësuar drejt OE “A [REDAKTUAR]”, pasi nuk i plotëson të gjitha kriteret e DST të miratuara nga AK, si: Jo për të gjitha rastet kur janë paraqitur vërtetim për likuidimin e taksave vendore, të jenë shoqëruar me faturat e arkëtimit të tyre (Bashkia Kavajë, Vlorë). Vërtetimi i lëshuar nga Bashkia Shijak (nr. 26, dt. 26.4.2016) dhe Bashkia Vlorë (nr. 212, datë 26.4.2016) nuk është përcaktuar se kujt vit i përkasin detyrimet. Për Bashkinë HAS nr. 173, datë 01.08.2016 nuk është shoqëruar me mandat pagesë. Bashkia Shkodër është paraqitur për vitin 2015 dhe jo vitin 2016 për të cilën kërkohet në DST; -Në muajin Gusht 2016, numri i punonjësve sipas vërtetimit (226 punonjës), nuk përputhet me numrin e punonjësve sipas listpagesës (174 punonjës), kriter për të cilën është skualifikuar dhe subjekti “E [REDAKTUAR]”. -Vërtetimi i lëshuar nga banka mbi gjendjen financiare nuk është brenda afati 5 ditor të kërkuar, fakt të evidentuar dhe nga vetë anëtarët e KVO, duke vlerësuar padrejtësisht fitues OE “I [REDAKTUAR]” me mangësi në kriteret e vendosura DST, për të shmangur efektin negativ në përdorimin e fondeve publike me dëm në vlerën **3,123,637 lekë**.

4- Tenderi me objekt: “Rikonstruksion i shkollës së mesme “Halim Xhelo”, me fond limit 60,644,928 lekë, ku fitues është shpallur OE “I [REDAKTUAR]” me ofertë 59,426,171 lekë . KVO nuk ka vlerësuar drejt OE “I [REDAKTUAR]”, pasi nuk i plotëson të gjitha kriteret e DST të miratuara nga AK, si: Nuk rezultojnë në listpagesës e sigurimeve shoqërore (F [REDAKTUAR] B [REDAKTUAR] dhe K [REDAKTUAR] S [REDAKTUAR] sipas kontratës datë 5.6.2017); -Për disa specialist të stafit teknik, paga sipas kontratës nuk përputhet me pagën në listpagesës dhe se nuk janë aktiv gjatë gjithë periudhës;

Nga verifikimi i bilanceve financiare të viteve 2015 dhe 2016, konstatohet se pasqyra e të ardhurave të bilancit të vitit 2015 është në vlerën 204,471,901 lekë, ndërsa nga pasqyra e të ardhurave të bilancit të vitit 2016 në ushtrimin paraardhës 2015, të ardhurat paraqiten në shumën 218,973,627 lekë, pra më pak në vlerën 14,501,726 lekë, gjë e cila tregon se bilancet nuk janë reale dhe të sakte, duke vlerësuar padrejtësisht fitues OE "I [REDAKTUAR]" me mangësi në kriteret e vendosura DST, për të shmangur efektin negativ me dëm në përdorimin e fondeve publike nga mos menaxhimi i mirë i procedurës në **vlerën 4,550,786 lekë** (Trajtuar gjerësisht në faqen 76-176, të Raport Përfundimtar të Auditimit).

15.15.1. Rekomandimi: Drejtoria e Menaxhimit Financiar në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, të ndjek të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **16,926,338 lekë**, ndaj punonjësve dhe drejtuesit përgjegjës në procedurat e mëposhtme:

1- Tenderi me objekt: "Ruajtja e objekteve të Bashkisë dhe Institucioneve të Varësisë për vitin 2015", me efekt negativ me dëm në përdorimin e fondeve publike në vlerën **2,821,066 lekë**.

2- Tenderi me objekt: "Ndriçimi i rrugëve në qytetin Vlorë", me efekt negativ me dëm në përdorimin e fondeve publike në vlerën **6,430,849 lekë**.

3- Tenderi me objekt: "Rikonstrukcion "Ura e Zvërnecit", Nartë-Vlorë", viti 2016", me efekt negativ me dëm në përdorimin e fondeve publike në vlerën **3,123,637 lekë**.

5- Tenderi me objekt: "Rikonstrukcion i shkollës së mesme "Halim Xhelo", me efekt negativ me dëm në përdorimin e fondeve publike në vlerën **4,550,786 lekë**.

Menjëherë

16.16. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e procedurave të prokurimeve të zhvilluar në ish-Komunën Shushicë, u konstatua senë **2 procedura** me vlerë të fondit limit 33,502,712 lekë, janë shpallur fitues operatorët ekonomikë me mangësi në plotësimin e kriterëve të DST, miratuar nga Autoriteti Kontraktor (AK) dhe Njësia e Hartimit të Dokumenteve të Tenderit (NJHDT), dhe skualifikuar operatorë ekonomike me ofertë më të leverdishme se operatori fitues, duke mos vlerësuar kriterin kryesorë "Çmimin më të leverdishëm midis operatorëve", veprime të cilat kanë çuar në përdorimin me efekt negative të fondeve të prokuruar me dëm në shumën **3,217,227 lekë**, në kundërshtim me neni 1- "Objekti dhe qëllimi", pika 2, germa (c, ç, d, dh), neni 2- "Parimet e përzgjedhjes", neni 24- "Anulimi i një procedure prokurimi", neni 53- "Shqyrtimi i ofertave", neni 55- "Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese", konkretisht praktikatat:

1-Tenderi me objekt: "Ndërtim i rrjetit të kanalizimeve, fshatrat Lllakatund dhe Shushicë", me fond limit 32,669,379 lekë, ku fitues është shpallur OE "B [REDAKTUAR]" me ofertë 32,333,156 lekë. KVO nuk ka vlerësuar drejt OE "B [REDAKTUAR]", pasi nuk i plotëson të gjitha kriteret e DST të miratuara nga AK, si: - Nuk paraqet vërtetim për likuidimin e taksave vendore, Bashkia Fier"; -Vërtetimi për taksën vendore të lëshuar nga ish- Komuna Libofsh për vitet 2012, 2011, për deklarimin e numrit të siguruara dhe sigurimeve shoqërore për vitet 2011-2012, nuk është respektuar afati 3 mujor nga momenti i zhvillimit të tenderit; -Nuk plotëson numrin mesatar të punonjësve prej 45 punonjës për vitin 2010, duke vlerësuar padrejtësisht fitues OE "B [REDAKTUAR]" me mangësi në plotësimin e kriterëve të DST, për të shmangur efektin negativ në përdorimin e fondeve publike me dëm në vlerën **2,962,756 lekë**.

2-Tenderi me objekt: "Rikonstrukcion i pjesshëm i rrugës Risilisë", me fond limit 833,333 lekë, ku fitues është shpallur OE "N [REDAKTUAR]" me ofertë 832,352 lekë. KVO nuk ka vlerësuar drejt OE "N [REDAKTUAR]", pasi nuk i plotëson të gjitha kriteret e DST të miratuara nga AK, si: - Vërtetimi i bankës është jashtë afatit 5 ditorë të kërkuar në DST. Për këtë fakt është skualifikuar OE "SARK" me ofertë me të ulët se OE "N [REDAKTUAR]" i kualifikuar, duke vlerësuar padrejtësisht fitues OE "N [REDAKTUAR]" me mangësi në plotësimin e kriterëve të DST, për të shmangur efektin negativ në përdorimin e fondeve publike me dëm në vlerën **254,471 lekë** (Trajtuar gjerësisht në faqen 76-176, të Raport Përfundimtar të Auditimit).

16.16.1. Rekomandimi: Drejtoria e Menaxhimit Financiar në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, të ndjek të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **3,217,227 lekë**, ndaj punonjësve dhe drejtuesit përgjegjës në procedurat e mëposhtme:

1-Tenderi me objekt: “Ndërtim i rrjetit të kanalizimeve, fshatrat Llakatund dhe Shushicë”, me efekt negativ në përdorimin e fondeve publike në vlerën **2,962,756 lekë**.

2-Tenderi me objekt: “Rikonstruksion i pjesshëm i rrugës Risilisë”, me efekt negativ në përdorimin e fondeve publike në vlerën **254,471 lekë**.

Menjëherë

17.17. Gjetje nga auditimi: Në tenderin me objekt: “Rikonstruksion i rrugëve të brendshme fshati Fitore”, me fond limit 3,333,333 lekë të zhvilluar në **ish- Komunën Novoselë**, fitues është shpallur OE “S[REDAKTUAR]” me ofertë 2,318,550 lekë. KVO ka shpallur fitues operatorin ekonomik me mangësi në plotësimin e kriteve të DST, miratuar nga Autoriteti Kontraktor (AK) dhe Njësia e Hartimit të Dokumenteve të Tenderit (NJHDT), dhe skualifikuar operatorë ekonomike me ofertë më të leverdishme se operatori fitues (INA me ofertë 2,315,900 lekë), duke mos vlerësuar kriterin kryesorë “Çmimin më të leverdishëm midis operatorëve”, veprime të cilat kanë çuar në përdorimin me efekt negative të fondeve të prokuruar me dëm në shumën **182,650 lekë**, në kundërshtim me neni 1- “Objekti dhe qëllimi”, pika 2, germa (c, ç, d, dh), neni 2-“Parimet e përzgjedhjes”, neni 24-“Anulimi i një procedure prokurimi”, neni 53- “Shqyrtimi i ofertave”, neni 55- “Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese” (*Trajtuar gjerësisht në faqen 76-176, të Raport Përfundimtar të Auditimit*).

17.17.1. Rekomandimi: Drejtoria e Menaxhimit Financiar në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, të ndjek të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtimin e **vlerës 182,650 lekë**, ndaj punonjësve dhe drejtuesit përgjegjës në procedurën me objekt “Rikonstruksion i rrugëve të brendshme fshati Fitore”.

Menjëherë

C. MASA DISIPLINORE

Mbështetur në ligjin “Për statusin e Nëpunësit Civil”, nenin 37, të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Kontratën individuale të punës, i rikërkohet Kryetarit të Bashkisë Vlorë, fillimin e procedurës për dhënien e masës disiplinore si më poshtë:

Mbështetur në nenin 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, gerrat (b, c, ç) e nenin 58 “Llojet e masave disiplinore”, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, në VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil” dhe nenin 64 shkronjën “k” të ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, **KLSH i rikërkon** Kryetarit të Bashkisë Vlorë të marë masa për të ngritur Komisionin Disiplinor, pranë Institucionit për marrjen e masës disiplinore, **“Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet” neni 58, germa (c):**

1. z. E [REDAKTUAR] P [REDAKTUAR], me detyrë inspektor i Taksave dhe Tarifave Vendore në terren

E. TË TJERA

Për të gjitha rekomandimet që konsiderohen në proces sipas rezultateve të këtij auditimi, kërkohet dhe inkurajojmë përsheptimin e plan veprimit për realizimin e plotë të tyre brenda 20 ditëve nga marrja e këtij Raporti Përfundimtar Auditimi.

Pavarësisht auditimit që ne kemi kryer për zbatimin e rekomandimeve, ju kujtojmë që në mbështetje të nenit 30, pika 2 dhe 3 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, **jeni të detyruar që brenda 20 ditëve nga data e marrjes së kërkesës**, duhet të raportoni me shkrim pranë KLSH, mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve tona dërguar me shkresat përkatëse si, dhe ju bëjmë me dije se zbatimi i rekomandimeve do të jetë pjesë e auditimit të radhës nga KLSH, në subjektin Tuaj.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore.

***Shënim 1:** Pika E e këtij vendimi vlen për të gjitha subjektet objekt të këtij auditimi të cilat nuk kanë zbatuar rekomandimet e lëna nga KLSH-ja.*

***Shënim 2:** Audituesi z.E [REDAKTUAR] C [REDAKTUAR] sipas Programit të miratuar nga Kryetari nr. 1153/1 datë 08.10.2018 është caktuar për auditim në Këshillin e Qarkut Shkodër dhe si rrjedhojë është shkëputur nga auditimi. Bashkëlidhur Aneksi Nr. 1, për paraqitjen tabelare të zbatimit rekomandimeve sipas llojeve për 21 subjektet e verifikuara për zbatimet e rekomanduara.*

***Shënim 3:** Pjesë integrale e këtij Vendim janë edhe 4 Anekset respektivisht nr. 1 deri 4 Për rekomandimet dhe realizimi sipas llojeve të masave të rekomanduara nga kryetari i KLSH në vendimet respektve.*

BUJAR LESKAJ

KRYETAR